RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim TematikPërputhshmërie)

Departamenti Administratës Publike

Shtator, 2021

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
(Auditim TematikPërputhshmërie)

DEPARTAMENTI ADMINISTRATËS PUBLIKE

Nr Përmbajtja Faqe

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....3-3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....3-11
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....11-12

II.HYRJA

1. Objektivat dhe qëllimi. 12-12
2. Identifikimi i çështjes.....12-12
3. Përgjegjësitë e audituesve..... 12-12
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 13-14
5. Kriteret e vlerësimit..... 14-15
6. Standardet e auditimit..... 15-15
7. Metodat e auditimit..... 15-15
8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit..... 15-16

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1.Informacion i përgjithshëm..... 16-16
2.Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit..... 16-90
2.1.Verifikimi dhe zbatimi i kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me procedurat e ndjekura dhe veprimtarinë e kryer gjatë procesit të ristrukturimit të administratës tatimore qendrore, si dhe në shpalljen dhe ndjekjen e vakancave të krijuara si pasojë e këtij procesi;.....16-38
2.2Verifikimi i realizimit të rolit të DAP në Komisionin e Ristrukturimit gjatë procesit të ristrukturimit të administratës tatimore, në përmbushjen e detyrave të këtij komisioni, si shqyrtimi i mundësisë së sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, transferimit një pozicion të lirë të së njëjtës kategori dhe vlerësimin e vendimmarrjen për rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil;
..... 38-71

2.3 Verifikimi i kryerjes me përpikmëri të rolit mbikëqyrës të DAP në ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore që lidhen me këtë proces..... 71-89
2.4 Të tjera që mund të dalin nga auditimi..... 89-90

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET..... 90-98

V.ANEKSE..... 98-105

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Në Departamentin e Administratës Publike, në bazë të programit të auditimit nr. 297/1, datë 26.02.2021, i ndryshuar, u zhvillua auditimi tematik me objekt ñ*Verifikimi i procedurave të ndjekura nga DAP, për çështje që lidhen me procesin e ristrukturimit të administratës tatimore qendrore si dhe problematikat e lidhura me të",* për periudhën 01.01.2019 ï 31.12.2020.

Qëllimi i auditimit ishte verifikimi i:

- Rolit dhe veprimtarisë së DAP në Komisionin e Ristrukturimit gjatë proceseve të ristrukturimit për periudhën objekt auditimi;
- Rolit të DAP në Komisionet e Posaçme, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- Rolitdhe veprimtarisë së DAP në menaxhimin e vakancave të krjuara gjatë proceseve të ristrukturimit për periudhën objekt auditimi;

Auditimi është kryer mbi ristrukturimeve e kryera në Administratën Tatimore Qëndrore (ATQ) për periudhën objekt auditimi, si më poshtë:

- Ristrukturimi i bërë me Urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019 i Kryeministrit ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendoreò;
- Ristrukturimi i bërë me Urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, të ndryshuarò
- Ristrukturimi i bërë me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, të ndryshuarò

Auditimi ka filluar më datën 01.03.2021 dhe ka mbaruar më datën 16.04.2021.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

R	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Administrata Tatimore Qendrore, në bazë të urdhrave të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr. 126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"*, gjatë periudhës shkurt 2019 - shkurt 2020, ka pësuar 3 herë ndryshime në strukturë dhe organikë, respektivisht: ristrukturimi i parë është bërë me urdhrin nr. 49, datë **27.02.2019**, ristrukturimi i dytë është bërë me urdhrin nr. 86, datë **03.05.2019**, ristrukturimi i tretë është bërë me urdhrin nr. 33, datë **12.02.2020**. Nga auditimi mbi respektimin e procedurave të ndjekura për këto ndryshime strukturore e organizative, në përputhje	16-24	**E LARTË**	Për të gjitha rastet në vijim, Departamenti i Administratës Publike nuk duhet të marrë në shqyrtim propozime për ndryshimin e strukturës, bashkëlidhur të cilave mungojnë të dhënat si: - Mendime për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara; - Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi; - Analizën sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara; - Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për

	me kërkesat e VKM nr. 893, datë 17.12.2014, ñ*Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm*ò u konstatuan se, DAP ka dhënë miratimet për këto ndryshime në mungesë të informacionit justifikues për domosdoshmërinë dhe objektivitetin e këtyre ndryshimeve dhe në mungesë të informacionit për kostot e llogaritura dhe efektet financiare që do të vinin nga këto ndryshime. Konkretisht: **1.** Gjatë procesit, hapat e ndjekura për ristrukturimin e parë, u vërejt se mungojnë: - Mendimet nga MFE për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara[1]. - Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi[2]. - Analiza sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara[3]; - Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit, referuar kriterit të parashikuar në pikën 33/d të VKM nr. 893, datë 17.12.2014[4]. **2**. Për ristrukturimin e dytë, u vërejt se mungon: - Analiza sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara në kundërshtim me pikën 33/ç të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014; **3**. Për ristrukturimin e tretë, u vërejt se mungojnë: **- P**ërshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi[5]. Në kushtet kur kemi konstatuar se, disa nga rekomandimet e DAP qëndrojnë bazuar në VKM nr.187 datë 08.03.2017 (lidhja 6/8) por, ***DPT nuk i ka marrë në konsideratë*** dhe ka vijuar me miratimin e organigramës sikundër e ka propozuar vetë, roli i DAP në këtë proces ka qenë jo reagues. Për sa më sipër, gjykojmë se nevojitej dakordësimi midis DAP dhe DPT për kategorinë e pagave të ATQ, sipas lidhjes 6/8, siç përcakton ***pika 36 e VKM nr. 893 datë 17.12.2014***, e citon se: Në rast se ka qëndrime të kundërta			sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit. Për të gjitha rastet në vijim, nëse ka qëndrime të kundërta ndërmjet DAP dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e DAP dhe tõ reflektojë ose të argumentojë mosreflektimin e tyre. Në rast se vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, DAP të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për të organizuar një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve.

[1] Sipas pikës 33/b të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[2] Sipas pikës 33/c të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[3] Sipas pikës 33/ç të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[4] Sipas pikës 33/d të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[8]Sipas pikës 33/c të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014

	ndërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike dhe, sipas rastit, të reflektojë ose të argumentojë mosreflektimin e tyre. Në rast se vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave organizon një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve.			
2	Nga auditimi u konstatua se, **komunikimet shkresore mes DAP dhe MFE-së për çështje të ristrukturimit (**referuar këtu shkresës nr. 2386/1 prot., datë 30.04.2019 dhe shkresës nr. 2495/1 prot., datë 03.05.2019),edhe pse kanë lidhje organike ndërmjet tyre **nuk ndjekin të njëjtin numër protokolli,**në kundërshtim me nenin 19, pika 1, e ñNormave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, hartuar në mbështetje të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, në pikën 1 të të cilit kërkohet që: ñ*Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të, evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit.”*	16-24	**E MESME**	Në të gjitha rastet në vijim, për dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre, njësia përgjegjëse për protokollimin e shkresave në DAP, duhet që për dokumentin e parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, të japë një numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të, të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.
3	Nga auditimi për ndjekjen e procedurave për shpalljen e vakancave nga DAP, për plotësimin e strukturës së ATQ, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò, konstatohet se, organika e punonjësve me status të nëpunësit civil të ATQ, sipas strukturës së vjetër (para janarit të vitit 2019) ka qenë me 1569 punonjës. Në fakt, deri në janar të vitit 2019, numri i punonjësve në organikë ka qenë i plotësuar me 1400 punonjës, pra me 169 punonjës më pak, ose me 169 pozicione pune vakante. Në ristrukturimin e parë, miratuar me urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit *“Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, “Për*	26-32	**E LARTË**	DAP të ushtrojë të gjitha kompetencat që i njeh ligji në rolin e administratorit të përgjithshëm të Regjistrit Qendror të Personelit (RQP), për të mbikëqyrur dhe monitoruar përmes mekanizmave të raportimit, veprimet që kryhen në RQP në përgjithësi si dhe ndërveprimin me burimet e të dhënave që përdoren në platformë; gjithashtu për të menaxhuar modulet për ndjekjen e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore (proceset e rekrutimit, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të përshkrimeve të punës, të vlerësimit të rezultateve në punë, si dhe të çështjeve gjyqësore dhe të vendimeve gjyqësore të formës së prerë) në platformën e bashkëpunimit ñadministrata.alò.

	miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", struktura dhe organika e re e miratuar, bëhet 1512 pozicione, nga 1569 që ishin përpara këtij ristrukturimi. Në ristrukturimin e dytë, miratuar me urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* struktura dhe organika e re, u bë 1512 pozicione pune, numër i njëjtë ky me pozicionet e strukturës së mëparshme, por me ndryshime në emërtesa dhe riorganizime të drejtorive dhe sektorëve. Në Dhjetor 2019,pas ristrukturimit të dytë, numri total i punonjësve në strukturën plan ishte 1512, në diferencë me strukturën fakt, prej 156 pozicione vakante, në punonjës me status nëpunësi civil, ose 13 pozicione **më** pak nga sa kishte **në** fillim **të** vitit 2019 dhe përpara ristrukturimit të parë. <u>Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të vakancave, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e DPT ka pasqyruar në sistemin HRMIS dhe publikuar në platformën administrata.al, në periudhën 04 Nëntor ï 17 Dhjetor të vitit 2019, vetëm 12 pozicione vakante, të shpallura më pas nga DAP (nga 156 vakanca që ka gjithsej),</u> duke mos përmbushur detyrat që i ngarkon Lidhja 3 e VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò. Nga ana tjetër, konstatojmë se, DAP nuk ka përmbushur detyrat që i ngarkon Lidhja 3 e VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò, ku ndër të tjera citohet: Pika 1. a) *DAP është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë së pandërprerë dhe mirëfunksionimin e Regjistrit Qendror të Personelit. b) Mbikëqyr dhe monitoron veprimet që kryhen në Regjistrin Qendror të Personelit në përgjithësi.* *RQ*P-ja dhe platforma e bashkëpunimit ñadministrata.alò shërbejnë si burim informacioni apo mjet kontrolli për DAP-in, por edhe për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për realizimin e funksioneve të tyre lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe në kushtet e mungesës së një informacioni të tillë, edhe detyrat funksionale të këtyre institucioneve në lidhje me këtë çështje, rrezikojnë të			

	cënohen. Në vijim, rezultoi se në muajin **Janar 2020**, paraqiten **137 pozicione vakante** në punonjës me status të nëpunësit civil, ndërsa numri i strukturës plan është i njëjtë me atë të muajit dhjetor 2019 (1512 punonjës, ndërsa 1341 është numri i strukturës fakt). Në ristrukturimin e tretë,miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñ*Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* struktura dhe organika e re e miratuar bëhet gjithsej 1450 pozicione, nga 1512 që ishin në strukturën e mëparshme. Ndërsa në**Dhjetor 2020,** rezultuan gjithsej **186 pozicione vakante** me status nëpunësi civil (ose 49 vakanca më shumë krahasuar me janar 2020).			
4	Për të tre ristrukturimet e kryera në ATQ në periudhën 2019-2020, MFE ka përcjellë shkresa DAP-it për mendime, propozime *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* duke i bashkëngjitur projekt-urdhrin për ndryshimin e strukturës organizative të ATQ dhe relacionin me arsyet e nevojës për këtë ndryshim. DAP-i, në të gjitha korrespondencat me MFE, ka kthyer përgjigje pasi ka shqyrtuar propozimin për ndryshimin e strukturës të ATQ dhe ka sugjeruar rishikimin e praktikës në dy pikëpamje: a) së pari sa i takon hartimit dhe propozimit të aktit, i cili duhet të përmbajë projektstukturën me skemat hierarkike organizative vertikale dhe horizontale dhe numrin e përgjithshëm të personelit të ATQ; dhe b) së dyti nga pikëpamja teknike. Në këto korrespondenca, në asnjë rast nuk rezulton të përmendet krijimi i hapësirave për gjyqfituesit, as nga DPT dhe as nga DAP, me qëllim menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të cilat rrezikojnë të përdoren për likuidimin e vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna.	16-24	**E LARTË**	Në kushtet kur,DAP ka detyrimin edhe të mbikëqyrjes së procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, sipas urdhrit nr. 5151 datë 28.10.2015 ñ*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil",* rekomadojmë që, me qëllim marrjen e masave për menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, gjatë procedurave të ristrukturimit, DAP dhe institucionet e tjera të përfshira, të vlerësojnë edhe alternativat që mundësojnë rikthimin në detyrë të nëpunësve civil gjyqfitues.

5	Nga auditimi u konstatua se: -Komisioni i Ristrukturimit ka mangësi në dokumentimin e procesit, duke shfaqur mungesë transparence në vendimmarrje, edhe pse Udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016 parashikon se i gjithë procesi duhet të jetë i dokumentuar. -Në transferimet e propozuara dhe të miratuara janë konstatuar transferime të nëpunësve nëpër sektorë e drejtori të tjera, edhe në rastet kur pozicioni i tyre i mëparshëm vazhdonte normalisht. -Komisioni nuk paraqet paraprakisht një relacion, ku të evidentohen vakancat ekzistuese në institucionin që po i nënshtrohet ristrukturimit, apo nuk ka gjurmë të ketë kërkuar informacion mbi vakanca të mundshme, me qëllimin kryesor sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese. -Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton të ketë dokumente vërtetues, që vërtetojnë se Komisioni i Ristrukturimit ka kryer verifikimin e përshkrimeve të punës, si kritere të veçanta të evidentuara dhe lista me grupe të veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në këto kritere. -Komisioni i Ristrukturimit nxjerr Vendime të njëpasnjëshme, duke anuluar akte të dala nga vetë ai Komision, duke u shprehur se janë bërë pa vlerësuar kriteret e veçanta të pozicioneve të punës. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që vendimet e marra janë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, sipas parashikimit të Udhëzimit. Komisioni i Ristrukturimit nxjerr vendime të njëpasnjëshme, duke anuluar akte të dala nga vetë ai Komision, duke u shprehur se transferimet janë kryer pa bërë sistemin e pikëzimit. -Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion vetëm Vendimi për secilin nëpunës. Vendimi nuk ka bashkëlidhur praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi, ndryshe nga sa parashikohet në Udhëzim. -Afatet e procedurës, sipas përcaktimit në Udhëzim, janë tejkaluar dhe nuk ka asnjë arsyetim për tejzgjatjen e afateve të dokumentuar përgjatë procesit.	38-65	**E LARTË**	DAP, me anë të përfaqësuesit të tij në Komisionin e Ristrukturimit, në çdo rast duhet të garantojë kryerjen e të gjitha hallkave të kontrollit përgjatë procesit të ristrukturimit, sipas parashikimeve në Ligjin 152/2013 dhe në Udhëzimin nr. 01.03.2016, si dhe të dokumentojë çdo hallkë të procesit, për të qenë transparent në vendimmarrje: - duke mos kryer transferime në njësi që nuk preken nga proceset e ristrukturimit; - duke hartuar një relacion paraprak të njësive që preken nga ristrukturimi, përshkrimet e punës, përcaktimin e vakancave që ka institucioni dhe atyre që pritet të krijohen; - duke përdorur Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit sa herë të ketë lëvizje brenda një sektori ose një drejtorie; - duke dokumentuar çdo Vendim, me praktikën mbi bazën e të cilit është marrë ai.
6	Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga 3 anëtarë, nëpunësi më i lartë civil i institucionit mëmë nga varet institucioni që po ristrukturohet, nëpunësi më i lartë civil i institucionit që po ristrukturohet dhe një përfaqësues nga DAP, i cili është dhe Kryetar i Komisionit. Përfaqësuesi i DAP në të trija rastet ka qenë në nivel Specialisti, ndërkohë që 2 anëtarët e tjerë janë nëpunësit më të lartë civil të institucioneve përkatëse. Është konstatuar që, në rastet kur, në	38-65	**E LARTË**	DAP, si institucioni që kryeson Komisionin e Ristrukturimit (Kryetari i Komisionit është përfaqësues i DAP) duhet të luajë një rol më aktiv në mbarëvajtjen e proceseve të ristrukturimit, dhe jo thjesht rol formal duke konfirmuar çdo propozim apo ndryshim të anëtarëve të tjerë. DAP duhet të garantojë zbatimin rigoroz të Ligjit 152/2013 ñPër shërbimin civilò dhe Udhëzimit 1.3.2016, në çdo proces

	mes të procesit të ristrukturimit, është zëvendësuar një nga dy anëtarët e tjerë (përkatësisht me Urdhërin nr. 62, datë 30.08.2019, ndryshohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në procesin e dytë të Ristrukturimit, gjatë vitit 2019, dhe me Urdhërin nr. 58, datë 17.08.2020 ndryshohet Sekretari i Përgjithshëm i MFE, në procesin e tretë të Ristrukturimit, gjatë vitit 2020), Komisioni i rikthehej nga fillimi të gjitha transferimeve, shpesh duke anuluar aktet e dala nga po të njëjtet Komisione Ristrukturimi. Nëse kriteret e veçanta të pozicioneve specifike do të ishin marrë parasysh, sikurse do të ishte kryer përzgjedhja me metodën e pikëzimit, që në vendimin e parë, sipas parashikimeve në Udhëzimin që rregullon procesin, ndryshimi i një anëtari në Komision, cilido qoftë ai, nuk do të kishte arsye të sillte rishikim dhe rikthim të akteve.			ristrukturimi. Duke marrë parasysh rëndësinë e institucionit që po i nënshtrohet procesit të ristrukturimit, si dhe statusin e anëtarëve të tjerë të Komisionit të Ristrukturimit, DAP duhet të konsiderojë të përfaqësohet nga nivel më i lartë drejtues për të garantuar fuqizimin e rolit të DAP në Komisionin e Ristrukturimit dhe në proceset e ristrukturimit në përgjithësi
7	Nga auditimi rezultoi se, nga **9** procese gjyqësore të nisura si pasojë e ristrukturimit të tretë: - 3 procese janë ndërprerë dhe punonjësit janë rikthyer në pozicionin e mëparshëm me vendim te Komisionit të Ristrukturimit, çfarë tregon edhe njëherë vendimmarrjen e gabuar te këtij Komisioni; - 2 procese janë finalizuar me vendim te përkohshme ku edhe këtu 2 punonjësit paditës janë rikthyer në punë; - 2 procese kanë përfunduar në shkallë të parë, në favor të nëpunësve-paditës, dhe - vetëm 2 padi rezultojnë të jenë rrëzuar (edhe këto janë në proces apelimi). Sa më sipër tregojnë për vendimmarrje të paargumentuara ligjërisht, të cilat e vendosin institucionin përpara riskut të krijimit të detyrimeve për ekzekutime të vendimeve gjyqësore Gjithashtu rezultoi se, referuar data bazës së vendimeve gjyqësore të administruara nga DAP, si pasojë e ristrukturimeve në administratën tatimore, kanë nisur 11 procese gjyqësore, për punonjës me status të nëpunësit civil, nga të cilat **2** nga ristrukturimi i parë dhe **9** nga ristrukturimi i 3-te. Nëse i referohemi te dhënave nga DPT, në fakt kanë nisur gjithsej 10 procese (nga të cilat dy janë për gjykim në shkallë të parë dhe 8 në shkallë të dytë), dhe jo 11, sikundër konfirmon DAP. Duke krahasuar të dhënat e marra nga DAP me ato nga DPT[6] mbi vendimet gjyqësore, vërejmë se ka disa mospërputhje, konkretisht në databazën e DAP nuk figurojnë 2 punonjës: Eduart	71-83	**E MESME**	- DAP të ngrejë të gjithë mekanizmat e nevojshëm, në mënyrë që të përmbushë detyrimin <u>për të monitoruar</u> plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësore, duke kërkuar nga Njësia debitorë që të përfshijë informacion **<u>mbi gjendjen juridike te pozicionit te punës</u>**, pas largimit të punonjësit sipas statusit: ñpozicioni nuk ekzistonò, ñi bashkuar me pozicione të ngjashmeò, ñndryshim kritereshò si dhe ñshkaku ligjor për të cilin është zënë vendi i punësò dhe të tjera informacione që dikton kuadri rregullator në fuqi. Kjo me qëllim analizimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të çdo rasti, në mënyrë që të shmanget krijimi i detyrimeve të prapambetura me efekte negative ne buxhet, si pasojë e vendimmarrjeve të gabuara për largime të padrejta të punonjësve nga puna. - DAP ti kërkojë DPT-së që të njoftohet për çdo rast, që nga momenti i depozitimit të kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit/përfaqësuesit ligjor/përmbaruesit, për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Gjithashtu DPT të marrë masa për përditësimin e të dhënave për vendimet gjyqësore dhe <u>brenda dy ditëve pune nga çdo përditësim, të bëjë me dije DAP.</u>

[6] Nga grupi I auditimit qe auditoi ne DPT, mbështetur mbi programin e auditimit nr. 298/1prot, date 02.03.2021

	Meni (për gjykim ne shkallë të parë) dhe Ahmet Idrizi (pushim i çështjes në shkallë të dytë); ndërsa në databazën e DPT nuk figurojnë 3 punonjës: M. A. (Pushuar gjykimi në Shkallë të Parë), A. H. (Rrëzuar padia në Shkallë të Parë) dhe A. D. (Rrëzuar padia në Shkallë të Parë). Në vijim të sa më sipër, nga verifikimi i te dhënave te DAP konstatojmë se, në databazën e vendimeve gjyqësore nuk ka informacion **mbi gjendjen juridike te pozicionit te punës**, pas largimit të nëpunësve në fjlaë, sipas kërkesave te urdhrit 5151/2015, ku në bazën e të dhënave gjyqësore të plotësuara nga njësia debitorë (DPT) duhet të shprehet gjendja juridike e pozicionit të punës pas largimit të punonjësit (***dhe jo pozicioni ku ka qene punonjësi para dhe pas ristrukturimit)*** sipas statusit: ñpozicioni nuk ekzistonò, ñi bashkuar me pozicione të ngjashmeò, ñndryshim kritereshò si dhe ñshkaku ligjor për të cilin është zënë vendi i punësò. Këto të dhëna duhet të përditësohen dhe në këtë formë duhet tõi vihen në dispozicion DAP-it brenda dy ditëve pune, nga momenti i përditësimit. DAP më pas monitoron plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësore. Nga auditimi nuk na rezultoi nëse DAP në rolin e mbikëqyrësit të zbatimit të vendimeve gjyqësore, në mënyrë periodike, të ketë kërkuar nga DPT përditësimin e të dhënave të gjyqfituesve në platformën e bashkëpunimit sipas të gjithë kritereve që kërkon Urdhri 5151, date 28.10.2015.			
8	Nga auditimi rezultoi se veprimtaria administrative e Komisionit të Posaçëm, nuk është ndjekur dhe vëzhguar nga DAP për raste që i takojnë periudhës 2019-2020, në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit 5151/2015 **"**Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civilò**,** pasi ngadata 27.08.2019 e në vazhdim, DAP nuk është njoftuar nga DPT për mbledhjet e komisionit të posaçëm, edhe pse rezultoi se këto komisione kanë vepruar duke lënë edhe akt-rekomandimet përkatëse. Pas administrimit të kërkesave për pjesëmarrje në Komisionet e Posaçme në zbatim, Kreu IV të Urdhrit nr.5151 datës 28.10.2015, DAP përzgjedh nga radhët nëpunësve të saj vëzhguesit apo mbikëqyrësit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm. Në përputhje me procedurën e mësipërme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka depozituar pranë	71-83	**E LARTË**	**:** Komisioni i posaçëm, në çdo rast, veçanërisht për rastet e proceseve gjyqësore si pasojë e ristrukturimeve-objekt i këtij auditimi, brenda dy ditëve pune nga depozitimi i kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit/përfaqësuesit ligjor të tij/të përmbaruesit gjyqësor, për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, duhet të njoftoje DAP-in, i cili ka për detyrë më pas të vëzhgoje Komisionin e posaçëm.

	DAP-it kërkesën nr. 16017 prot., datë 27.08.2019 për caktimin e përfaqësuesit të DAP në Komisionin e Posaçëm të ngritur pranë DPT-së. Në përgjigje të kësaj kërkese, DAP ka nxjerrë shkresën nr. 5003/1 prot., datë 30.08.2019, duke i njoftuar DPT-së nëpunësin e autorizuar për këtë veprimtari administrative. Në vijim të kësaj korrespondence, nga ana e DPT-së është njoftuar mbledhja e Komisionit të Posaçëm për në datën 17.09.2019, dokumentuar me procesverbalin respektiv në DPT. ***Pas kësaj mbledhjeje DPT-ja nuk ka depozituar apo njoftuar mbledhje të radhës së Komisionit të Posaçëm***. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Komisioni i Posaçëm është krijuar edhe pas datës 17.09.2019, por pa informuar DAP dhe si rrjedhojë edhe pa përfaqësuesin e DAP-it. Konkretisht, rezultojnë 6 procesverbale te mbledhjeve te Komisionit të Posaçëm pa praninë e përfaqësuesit të DAP[7] për vitin 2020, dhe 3, për vitin 2021[8]. Nisur nga sa me sipër konkludojmë se, shqyrtimi i fakteve të lindura pas marrjes së vendimeve të formës së prerë, nëpërmjet Komisionit të Posaçëm përkatës, pas datës 27.08.2019, është një proces jo i plotë, për sa kohë nuk është vëzhguar nga DAP.			

3. Konkluzioni i përgjithshëm.

Pas Auditimit të kryer në Departamentin e Administratës Publike me objekt 'Verifikimi i procedurave të ndjekura nga DAP, për çështje që lidhen me procesin e ristrukturimit të administratës tatimore qendrore si dhe problematikat e lidhura me të' për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2020, u evidentua se:

- Komisioni i Ristrukturimit ka mangësi në dokumentimin e procesit, duke shfaqur mungesë transparence në vendimmarrje, edhe pse Udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016 parashikon se i gjithë procesi duhet të jetë i dokumentuar.

-Në transferimet e propozuara dhe të miratuara janë konstatuar transferime të nëpunësve nëpër sektorë e drejtori të tjera, edhe në rastet kur pozicioni i tyre i mëparshëm ka vijuar normalisht.

-Komisioni nuk paraqet paraprakisht një relacion, ku të evidentohen vakancat ekzistuese në institucionin që po i nënshtrohet ristrukturimit, dhe/apo nuk ka gjurmë të ketë kërkuar informacion mbi vakanca të mundshme, me qëllimin kryesor sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese.

[7] Viti 2020: Procesverbalet
Nr. 12530 prot, datë 03.07.2020
Nr. 13627 prot, datë 17.07.2020
Nr. 16557 prot, datë 25.08.2020
Nr. 22334 prot, datë 19.11.2020
Nr. 23224 prot, datë 10.12.2020
Nr. 23750 prot, datë 15.12.2020

[8] Viti 2021: Procesverbale
Nr. 19513/3 prot, datë 28.01.2021
Nr. 24226/3 prot, datë 11.02.2021
Nr. 23325/4 prot, datë 09.03.2021

-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton të ketë dokumente vërtetues, që vërtetojnë se Komisioni i Ristrukturimit ka kryer verifikimin e përshkrimeve të punës, si kritere të veçanta të evidentuara dhe lista me grupe të veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në këto kritere.
-Komisioni i Ristrukturimit ka dalë me Vendime të njëpasnjëshme, duke anuluar akte të dala nga vetë ai, duke u shprehur se janë bërë pa vlerësuar kriteret e veçanta të pozicioneve të punës si dhe pa ndjekur sistemin e pikëzimit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që vendimet e marra janë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, sipas parashikimit të Udhëzimit.
-Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion vetëm Vendimi për secilin nëpunës, cili nuk ka bashkëlidhur praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi, ndryshe nga sa parashikohet në Udhëzim. Afatet e procedurës, sipas përcaktimit në Udhëzim, janë tejkaluar dhe nuk ka asnjë arsyetim për tej zgjatjen e afateve të dokumentuar përgjatë procesit.
DAP, me anë të përfaqësuesit të tij në Komisionin e Ristrukturimit, duhet të garantonte kryerjen e proceseve të ristrukturimit, sipas parashikimeve në Ligjin 152/2013 dhe në Udhëzimin nr. 01.03.2016, që rregullon specifikishit këtë proces, si dhe të dokumentonte çdo hallkë të procesit, për të qenë transparent në vendimmarrje.
-Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga 3 anëtarë, nëpunësi më i lartë civil i institucionit mëmë nga varet institucioni që po ristrukturohet, nëpunësi më i lartë civil i institucionit që po ristrukturohet dhe një përfaqësues nga DAP, i cili është dhe Kryetar i Komisionit. Përfaqësuesi i DAP në të tria rastet ka qenë në nivel Specialisti, ndërkohë që 2 anëtarët e tjerë janë nëpunësit më të lartë civil të institucioneve përkatëse.
Është konstatuar që, në rastet kur, në mes të procesit të ristrukturimit, është zëvendësuar një nga dy anëtarët e tjerë (përkatësisht me Urdhrin nr. 62, datë 30.08.2019, ndryshohet Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në procesin e dytë të Ristrukturimit, gjatë vitit 2019, dhe me Urdhrin nr. 58, datë 17.08.2020 ndryshohet Sekretari i Përgjithshëm i MFE, në procesin e tretë të Ristrukturimit, gjatë vitit 2020), Komisioni i rikthehej nga fillimi të gjitha transferimeve, shpesh duke anuluar aktet e dala nga po të njëjtet Komisione Ristrukturimi. Nëse kriteret e veçanta të pozicioneve specifike do të ishin marrë parasysh, sikurse do të ishte kryer përzgjedhja me metodën e pikëzimit, që në vendimin e parë, sipas parashikimeve në Udhëzimin që rregullon procesin, ndryshimi i një anëtari në Komision, cilido qoftë ai, nuk do të kishte arsye të sillte rishikim dhe rikthim të akteve.
-DAP duhet të luajë një rol më aktiv në mbarëvajtjen e procesit të ristrukturimit, dhe jo rol formal, duke konfirmuar çdo propozim/ ndryshim që një nga anëtarët e tjerë bën. DAP duhet të garantojë zbatimin rigoroz të Ligjit 152/2013 "Për shërbimin civil" dhe Udhëzimit 1.3.2016 në çdo proces ristrukturimi. Duke marrë parasysh rëndësinë e institucionit që po i nënshtrohet procesit të ristrukturimit, DAP duhet të konsiderojë të përfaqësohet nga nivel më i lartë drejtues dhe jo nga një specialist, për të garantuar fuqizimin e rolit të DAP në proces.
- DAP nuk ka ngritur dhe si pasojë as implemntuar mekanizmat e nevojshëm, në mënyrë që të përmbushë detyrimin <u>për të monitoruar</u> plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësore nga njësia debitore, duke pritur vetëm informacion nga njësia debitore por pa e kërkuar dhe verifikuar informacionin në mënyrë aktive, pasi kemi konstatuar mungesë informacioni të DAP për gjyqfituesit për raste kur DAP nuk ka qenë palë ndërgjyqësore.
- Gjithashtu u konstatua se shqyrtimi i fakteve të lindura pas marrjes së vendimeve të formës së prerë, nëpërmjet Komisionit të posaçëm përkatës, pas datës 27.08.2019, rezulton të ketë qenë një proces jo i plotë, për sa kohë nuk është vëzhguar nga DAP, në kundërshtim me Urdhrin nr.5151 datës 28.10.2015, Kreu IV.

II. Hyrja.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, në zbatim të Programit të Auditimitnr. 297/1, datë 26.02.2021 i ndryshuar ñ*Mbi auditimin tematik përputhshmërisë* ò me objekt ó*Verifikimi i procedurave të ndjekura nga DAP, për çështje që lidhen me procesin e ristrukturimit të administratës tatimore qendrore si dhe problematikat e lidhura me të" nga data 01.03.2021- 16.04.2021,* për periudhën 01.01.2019 ï 31.12.2020, i

miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u krye auditimi Tematik Përputhshmërie nëDepartamentin e Administratës Publike, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.V.,(*përgjegjës grupi*),
2. D. P.,auditues
3. E. B.,auditues
4. E. G., auditues

1) Titulli:
Raporti Përfundimtar i Auditimit TematikPërputhshmërie në Departamentin e Administratës Publike.
2) Marrësi:
Ky Raport i adresohet Departamentit të Administratës Publike.

METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:
Vlerësimi dhe evidentimi nëse veprimtaria e Departamentit të Administratës Publike është, në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë mbi bazën e të cilit e ushtron DAP ushtron aktivitetin, në mënyrë të tillë që të bëhet e mundur ndërmarrja e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim në mbrojte të interesave të shtetasve shqiptar.
Objektivat e këtij auditimi konsistojnë në:
Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi, në lidhje mbi procedurat, kriteret e ndjekura gjatë procesit të ristrukturimit të ndodhur në administratën tatimore qendrore, si dhe çështje te tjera që lidhen me të, verifikimi i kryerjes me përpikmëri të rolit mbikëqyrës të DAP në ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore si dhe të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm
4. Identifikimi i çështjes: Verifikimi i procedurave si dhe kriteret e ndjekura gjatë procesit të ristrukturimit të ndodhur në administratën tatimore qendrore gjatë periudhës 2019-2020 dhe çështje te tjera që lidhen me të. Vlerësimi dhe evidentimi nëse veprimtaria e Departamentit të Administratës Publike është në përputhje me ligjshmërinë mbi bazën e të cilit DAP ushtron aktivitetin, në mënyrë të tillë që të bëhet e mundur ndërmarrja e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim në mbrotje të interesave nëpunësve të Administratës Shtetërore duke respektuar ligjin nr. 152/2013 ñPër Nëpunësit Civilò i ndryshuar

5) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:
Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e detyrimeve kontraktuale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare e natyrore të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm.
Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

6) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:
Departamenti i Administratës Publike ka për qëllim sigurimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

Departamenti i Administratës Publike është institucioni publik përgjegjës për:
(I) menaxhimin dhe implementin e shërbimit civil në të gjitha institucionet e administratës qendrore;
(II) hartimin dhe implementimin e politikave në fushën e pagave dhe ndërtimit të institucioneve të administratës publike; dhe
(III) hartimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të përgjithshme të trajnimit të zbatueshme për administratën publike në tërësi.

Në DAP, **Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil** është njësia përgjegjëse për:
• Organizimin e procedurave të rekrutimit për kategorinë ekzekutive, si dhe të ulët e të mesme drejtuese.
• Organizimin e procedurave të rekrutimit dhe menaxhimin e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND) në institucionet e administratës shtetërore.
• Menaxhimin e proceseve që lidhen me emërimet, lirimet, transferimet, pezullimet, konfirmimet e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.
• Administrimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionet e administratës shtetërore.
• Administrimin e të dhënave në lidhje me emërimet, lirimet, pezullimet, transferimet, masat disiplinore dhe çdo lëvizje tjetër në institucionet e administratës shtetërore duke mbajtur rekordet përkatëse.

Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike në DAP, ka përgjegjësi për:
• Hartimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e ndërtimit të institucioneve
- standardet e krijimit dhe organizimit të institucioneve të administratës publike;
- reforma funksional strukturore e institucioneve të administratës shtetërore,
- standardet dhe ndjekjen e zbatimit të tyre në lidhje me procesin e përshkrimeve të punës,
- standardet dhe ndjekja e zbatimit të tyre në lidhje me analizën e proceseve (manuali i procedurave).

• Hartimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e pagave, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat.
• Hartimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore
- performanca;
- udhëzime, manuale për proceset e parashikuara në legjislacionin e nëpunësit civil;
- hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore për fushën e shërbimit civil dhe interpretime të ndryshme.

• Hartimin e politikave të qeverisë shqiptare në fushën e rritjes profesionale të administratës publike si energjizimi, trajnimi, motivimi, ndërveprimi i administratës publike në përgjithësi. • Përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, ndërtimit të institucioneve dhe pagave.
• Dhënien e mendimit për strukturat dhe organikat e institucioneve të pavarura, si dhe për strukturat dhe organikat e institucioneve të administratës shtetërore që miratohen nga Këshilli i Ministrave apo bordet/këshillat drejtuese të agjencive autonome

<u>7) Kriteret e vlerësimit:</u>
-Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 64, datë 22.06.2020, si edhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të AuditimitINTOSAI (ISSAI)
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC;
-ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë.;
-ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë;
-ñLibri Jeshilò i GAO-s,

-Ligji 152/2013 ñPër nëpunësin civilò i ndryshuar
- Kodi i Procedurës Civile
-VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñPër riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò
-Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò.
-Urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019 i Kryeministrit ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò
-Urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò
-Ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative
-Urdhëri 5151/2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò, etj

8)Standardet e Auditimit

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI (ISSAI).
-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) t ë IFAC.
-ISSA 4000-4899 Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë.
-ISSAI 400-499 Parimet e Auditit të Përputhshmërisë.
- ñLibri Jeshilò i GAO-s, etj;

9. Metodat e auditimit: Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:
(a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve.
1. *Kontroll aritmetik* që konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.
1. *Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.
2. *Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
3-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.
4-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike në subjektin që u auditua.
5-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.
6-*Pyetësorë* për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

10. Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për

përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, observacioneve të paraqitura nga subjekti mbi akt-konstatimet e lëna në subjekt, dhe takimit përmbyllës mbas fazës së përfundimit në terren midis niveleve drejtuese në datën 16.04.2021, u përgatit Projekt Raporti i Auditimit.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Auditimi në Departamentin e Administratës Publike, u krye në kuadër të autorizimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Departamentin e Administratës Publike për verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura, në lidhje me ristrukturimet e kryera ne Administratën Tatimore gjatë viteve 2019-2020. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Misioni i Departamenti i Administratës Publike

Departamenti i Administratës Publike ka për qëllim sigurimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve tëauditimit

2.1. Verifikimi dhe zbatimi i kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me procedurat e ndjekura dhe veprimtarinë e kryer gjatë procesit të ristrukturimit të administratës tatimore qendrore, si dhe në shpalljen dhe ndjekjen e vakancave të krijuara si pasojë e këtij procesi;

a) Mbi verifikimin dhe zbatimin e kompetencave të përgjithshme dhe të veçanta të Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me procedurat e ndjekura dhe veprimtarinë e kryer gjatë procesit të ristrukturimit të administratës tatimore qendrore.

Në bazë të nenit 16, ñStruktura e administratës tatimore qendroreò e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar; struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, pas bashkërendimit me DAP-in.

Referuar ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, pika 31 ñ*Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm*ò, procedurat e ndjekura dhe veprimtaria e kryer gjatë procesit të ristrukturimit të administratës tatimore qendrore kalon nëpër hapat e mëposhtëm:

Hapi 1

Referuar Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, pika 31 ñ*Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm*ò, ndërtimi i strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore përgatitet për Kryeministrin nga Departamenti i Administratës Publike, në bazë të propozimit të marrë nga ministri propozues. Në rastet kur, mbështetur në një ligj të veçantë,

struktura organizative miratohet nga një organ tjetër, merret në mënyrë të detyrueshme mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe i Ministrisë së Financave.
Në rastin e administratës tatimore, struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të cilit miratohen nga Kryeministri, referuar nenit 16 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, **nevojitet të merret në mënyrë të detyrueshme mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe i Ministrisë së Financave.**

Hapi 2

Pika 33 e Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, parashikon se: Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike të dhënat e mëposhtme:
a) Arsyet e hollësishme të nevojës për ndryshime;
b) Mendim për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara;
c) Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;
ç) Analizën sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara;
d) Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit.

Hapi 3

Pika 36 e Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, parashikon se: Në rast se ka qëndrime të kundërta ndërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike dhe, sipas rastit, tã reflektojë ose të argumentojë mosreflektimin e tyre. Në rast së vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave organizon një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve.

Tabela më poshtë, paraqet në mënyrë të përmbledhur informacion mbi 3 ristrukturimet e ndodhura në administratën tatimore përgjatë periudhës shkurt 2019 - shkurt 2020:

Ristrukturimet	**Datat**	**Qëllimi**
Ristrukturimi 1	17.02.2019	Në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, për riorganizimin e AKSHI-it etj.
Ristrukturimi 2	03.05.2019	Përmirësimi i aspektit funksional dhe procedural të saj, përshtatur me kontekstin aktual ligjor të sistemit tatimor, në zbatim edhe të rekomandimeve të FMN-së, KLSH-së e të tjerë.
Ristrukturimi 3	12.02.2020	Përmirësimi i aspektit funksional dhe procedural të ATQ, përshtatur me kontestin aktual dhe ligjor të sistemit tatimor. Gjithashtu përmenden rekomandimet e FMN-së dhe implementimi i projektit të fiskalizimit. (ligji nr. 87/2019 datë 18.12.2019)

Nëse i referohemi procesit të përshkruar më lart, sipas hapave respektive, për secilin prej 3 ristrukturimeve të ndodhura në ATQ, konstatojmë sa më poshtë vijon:

Ristrukturimi i parë *është miratuarme urdhrin nr. 49, datë **27.02.2019**, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore".*
Me shkresën nr. 22539 prot., datë 24.12.2018, MFE i ka dërguar DAP-it propozimin për një ndryshim të Urdhrit nr. 126, datë 02.08.2018 ñPër miratimin e strukturës organizative dhe numrit të personelit të ATQò, të Kryeministrit, duke i bashkëngjitur projekt urdhrin për ndryshimin e

strukturës organizative të ATQ dhe relacionin me arsyet e nevojës për këtë ndryshim. Qëllimi i këtij propozimi është përmirësimi i aspektit funksional dhe procedural të saj dhe bashkëpunimi institucional me Institucionet e tjera publike, përshtatur me kontestin aktual dhe ligjor të sistemit tatimor.
Nga auditimi rezultoi se MFE, në këtë shkresë i referohet një akti të shfuqizuar, konkretisht VKM nr. 474, datë 16.06.2011 "*Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike"*, e shfuqizuar me VKM nr. 893, date 17.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm"*.

Në përfundim, konstatojmë se, **hapat që duhet të ndiqeshin sipas VKM nr. 893, datë 17.12.2014**, **nuk janë respektuar plotësisht dhe me praktikën që shoqëron shkresën janë dërguar vetëm 2 dokumente:**
1.projekt urdhri për ndryshimin e strukturës organizative të ATQò ; dhe
2. relacioni që përmban arsyet e hollësishme të nevojës për këtë ndryshim.

Ndërsa rezultoi se, MFE është shprehur mbi qëllimin e ndryshimit të strukturës, në përputhje me pikën 33/a të VKM nr. 893, datë 17.12.2014, (*ku shprehet ndër të tjera se, qëllimi i ndryshimit është përmirësimi i aspektit funksional dhe procedural të ATQ dhe bashkëpunimi institucional me Institucionet Publike të tjera, përshtatur me kontestin ligjor të sistemit tatimor. Në zbatim të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e AKSHI-it", VKM-së nr. 208, datë 20.04.2018, "Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organik në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2018", Drejtoria TIK, Sektorët e IT, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës, suprimohen dhe kalojnë në përbërje të AKSHI-t),***konstatuam se në relacionin që shoqëron shkresën** nr. 22539 prot., datë 24.12.2018 **kanë munguar:**
- Mendimi nga MFE për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara[9]
(Vumëre se, MFE në relacionin që ka sjellë citon vetëm se ñ*Ky ndryshim do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit*[10]*, duke sqaruar se struktura aktuale ishte e përbërë nga 1569 punonjës, nga të cilët 1165 pozicione të nëpunësit civil dhe 404 punonjës me Kod Pune dhe* ***bëhet*** *1512 punonjës,* ***ose 57 më pak se në strukturën e mëparshme, pa sqaruar pse ka shtesë në kosto kur në fakt numri i punonjësve reduktohet***)
- Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi[11].
(Vumë re se në relacion jepet një informacion statistikor mbi numrin e punonjësve për çdo drejtori sa ishte dhe sa bëhet, pa dhënë një përshkrim të qartë për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi);
-Analiza sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara[12];
-Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit[13].
Në vijim, DAP ka kthyer përgjigje MFE, me shkresën nr. 8938/1, datë 27.12.2018 ku kërkon rishikimin e propozimit të MFE-së, pasi riorganizimi i disa drejtorive/sektorëve nuk është bërë në përputhje me rregullat e parashikuara, sepse janë propozuar drejtori me vetëm 1 sektor.
Me shkresën nr. 22539/2, datë 31.12.2018, MFE ka kthyer përgjigje ku ka dërguar relacionin e rishikuar sipas propozimeve të DAP-it (që qëndrojnë në ndryshime nga drejtori në sektorë).

[9] Sipas pikës 33/b të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[10] Sa janë parashikuar të jenë efektet shtesë?
[11] Sipas pikës 33/c të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[12] Sipas pikës 33/ç të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[13] Sipas pikës 33/d të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014

Me shkresën nr. 22539/3, datë 31.12.2018, DAP ka kthyer përgjigje MFE-së ku shprehet parimisht dakord me projekt strukturën organizative të propozuar nga MFE, pasi konstaton se janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar sugjerimet e dërguara.

Konstatojmë se, **DAP ka shqyrtuar shkresën e MFE-së dhe ka përgatitur sugjerimenë kundërshtim me pikën 34 të VKM nr. 893, datë17.12.2014, ku parashikohet se: Departamenti i Administratës Publike nuk shqyrton dhe nuk përgatit për Kryeministrin asnjë propozim, që nuk paraqitet në përputhje me pikën 33**, të këtij vendimi, dhe që nuk shoqërohet me **mendimin** e Ministrisë së Financave për efektet financiare.

Ristrukturimi i dytëështë miratuar *me urdhrin nr. 86, datë **03.05.2019** të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", duke ndjekur këtë proces:*

Me shkresën nr. 8422/1 prot, datë 24.04.2019, MFE i ka dërguar DAP-it propozim për ndryshimin e strukturës së ATQ, miratuar me urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019 ñPër disa ndryshime në urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe numrit të personelit të ATQò, duke i bashkëngjitur projekt strukturën organizative të ATQ dhe relacionin me arsyet e nevojës për ndryshimin e strukturës. Sipas MFE, efektet financiare vjetore nga ndryshimi i propozuar, do të përballohen brenda numrit dhe fondeve përkatëse, të miratuar për DPT.

Nga auditimi rezultoi se, MFE në këtë shkresë i referohet një akti të shfuqizuar, konkretisht VKM nr. 474, datë 16.06.2011 "*Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike"*, e shfuqizuar me VKM nr. 893, date 17.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm"*.

Në relacion, MFE është shprehur se, qëllimi i ndryshimit të strukturës është përmirësimi i aspektit funksional dhe procedural të saj, përshtatur me kontekstin aktual ligjor të sistemit tatimor, në zbatim edhe të rekomandimeve të FMN-së, KLSH-së e të tjerë. Nëpërmjet ristrukturimit nuk do të krijohen pozicione të reja pune, por do të bëhet një rishpërndarje e pozicioneve ekzistuese ose ri saktësim i emërtesave, detyrave dhe funksioneve. Struktura aktuale e administratës tatimore qendrore është e përbërë **nga 1512 punonjës**. Ky ristrukturim synon të mos ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit.

Konstatojmë se në relacionin që shoqëron shkresën nr. 8422/1 prot., datë 24.04.2019, **mungon:**

Analiza sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara[14]. (Vumë re se në relacion jepet një informacion statistikor mbi numrin e punonjësve për çdo drejtori sa ishte dhe sa bëhet, pa dhënë një përshkrim të qartë të detyrave dhe funksioneve të tyre)

Në vijim, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike në DAP, ka kthyer përgjigje MFE, me shkresën nr. 2386/1 prot., datë 30.04.2019, ku kërkon rishikimin e propozimit të MFE-së, duke sqaruar se:

1. Në pikëpamje të hartimit dhe propozimit të aktit:

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 16, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, përcaktohet se:

1. Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave;
2. Organigrama e administratës tatimore qendrore miratohet nga Ministri i Financave, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Në propozimin e paraqitur, përsa i përket formatimit, këto dy pika nuk janë respektuar, për arsye se projekt urdhri i përgatitur për tû miratuar nga Kryeministri duhet të përmbajë:

-projekt strukturën (skemat hierarkike organizative vertikale dhe horizontale) të të gjitha njësive përbërëse të administratës tatimore);

[14] Sipas pikës 33/ç të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014)

-numrin e përgjithshëm të personelit të ATQ.
2. Nga pikëpamja teknike sqarojnë se:
Në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Drejtoria e Analizës me 4 punonjës gjithsej, është konceptuar e organizuar si një drejtori me një sektor; po kështu, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, riorganizimi i Drejtorisë së Analizës në një drejtori me një sektor, gjë që në kuptimin e përbërjes së një strukture nuk e justifikon një hierarki të tillë, duke mosrespektuar standardet sasiore të përcaktuara në pikën nr. 23 të VKM nr. 893 datë 17.12.2014. Për rrjedhojë sugjerojnë rishikimin e praktikës.
Me shkresën nr. 3793/4 prot., datë 03.05.2019, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MFE, ka dërguar për miratim në DAP, draft strukturën e rishikuar të DPT.
Me shkresën nr. 2495/1 prot., datë 03.05.2019, DAP i kthen përgjigje MFE-së se, pas shqyrtimit të propozimit të ripunuar për strukturën organizative të ATQ, shprehet dakort pasi janë reflektuar vërejtjet e bëra me shkresën nr. 2386/1 prot., datë 30.04.2019.

Konstatojmë se, për shkresat nr. 2386/1 prot., datë 30.04.2019dhe nr. 2495/1 prot., datë 03.05.2019, në të cilat DAP-i, i kthen përgjigje MFE, edhe pse kanë lidhje organike mes njëra-tjetrës, nuk është ndjekur i njëjti numër protokolli, në kundërshtim me nenin 19, pika 1, e ñNormave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, hartuar në mbështetje të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, i cili citon:
Pika 1. ...Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të, evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit.

Ristrukturimi i dytëështë miratuar *me urdhrin nr. 33, datë **12.02.2020** të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore".*
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DAP rezultoi se, me shkresën nr.1181/2 prot., datë 05.02.2020, MFE i ka ri-dërguar njëkohësisht për miratim, Kryeministrisë dhe DAP-it, projekt strukturën e DPT-së, bashkëlidhur me relacionin shpjegues të saj, pasi është ripunuar dhe mbështetur në komentet teknike të sugjeruara nga DAP.
Qëllimi i ndryshimit të strukturës referuar kësaj shkrese, është përmirësimi i aspektit funksional dhe procedural të ATQ, përshtatur me kontestin aktual dhe ligjor të sistemit tatimor, në në kuadër të implementimit të Projektit të Fiskalizimit, si dhe rekomandimeve të lëna të FMN, sipas raportit Dhjetor 2017.
Nga auditimi vëmë re se, si pasojë e ndryshimeve që erdhën prej projektit të fiskalizimit, reflektuar në ligjin nr. 87/2019 ñPër faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimitò, të ndryshuar, u propozuan ndryshime në Drejtoritë:
Në DPT:
(i) Drejtoria e Koordinimit në Terren, me tre sektorë:
(i) Sektori i Trajtimit të Ankesave
(ii) Sektori i Verifikimit dhe Monitorimit (Taks-Forcë)
(iii) Sektori i Koordinimit
(ii) Drejtoria e Kontrollit Tatimor, është e përbërë me dy sektorë:
(iv) Sektori i Kontrollit Tatimor (1+10)
(v) Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit (1+2)
Emërtimet që propozohen të kenë sektorët janë:
(vi) Sektori i Kontrollit Tatimor (për kontrollin në vend) 1+5
(vii) Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit (sektori i kontrollit nga zyra dhe monitorimit 1+5
(viii) Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit nuk ndryshon (1+2)
Për DRT Tiranë, propozohet ndarja në dy Drejtori Kontrolli, me dy drejtorë. Drejtoria e Tatimpaguesve Biznes i madh dhe Drejtoria e Tatimpaguesve biznes i vogël me/pa TVSH.

(iii) Secila Drejtori të ketë në përbërje dy sektorë:
(ix) Sektori i Kontrollit në Vend
(x) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit

Këto drejtori me dy sektorë të shtrihet dhe në Drejtoritë Rajonale të tjera.

Ndërsa janë ndryshuar drejtori/sektorë si pasojë e ligjit nr. 87/2019, ñPër faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimitò, të ndryshuar, faktor që nuk varet nga administrata tatimore, vëmë re se janë bërë edhe ndryshime që nuk burojnë nga fiskalizimi si:

- Struktura organizative e mbledhjes së borxhit në DTM do të përbëhet nga 11 punonjës: (1+3+7)

2. Riorganizimi i Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut:
   - Drejtori i Drejtorisë (1)
   - Sektori i Analizës së Riskut është (1+6) propozohet (1+10)
   - Sektori i Hartimit të Strategjisë të Trajtimit të Risqeve (1+6)

   Në total nga 15 nëpunës bëhen 19 nëpunës.

- Drejtoria Teknike dhe Ligjore:

(xi) Sektori i Çështjeve Ligjore (1+5)
(xii) Sektori i TVSH dhe Taksave të Tjera (1+7)
(xiii) Sektori i Taksave Direkte (1+7), sektor i cili suprimohet nga Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndëristuticional, ish Sektori i Marrëveshjeve për eliminimin e Taksimit të Dyfishtë.

4. Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve dhe Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional të bashkohen;
5. Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, në varësi të shtyllës së dytë, do të kalojë në varësi të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Hartimit të Programeve;
6. Qendra e Pagesave të jetë sektor ne varësi të Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit;
7. Qendra e Thirrjeve të jetë sektor i Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve dhe jo Drejtori më vete;
8. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH të jetë nën shtyllën e Mbështetjes së Programeve;
9. Drejtoria e Auditit të Brendshëm është (1+8) propozohet (1+9);
10. Krijohet një Drejtori e re, si bashkim i dy drejtorive, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse e përbërë nga dy sektorë:

(xiv) Sektori i Shërbimeve të Brendshme (1+2+22)
(xv) Sektori i Prokurimeve (1+2)

11. Krijohet një drejtori e re, Drejtoria për Proceset e Biznesit, në varësi të shtyllës të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes të Programeve;
12. Krijohet një Sektor Komunikimi (1+2) në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në vijim, është e paqartë se, pse nga MFE përmenden përsëri si arsye për ndryshimin e strukturës, rekomandimet e FMN-së, **të vitit 2017**, të cilat në gjykimin tonë mund të ishin reflektuar që në ristrukturimin e parë (në 27/02/2019) dy vite pas rekomandimit të FMN-së.

Ndërsa ristrukturimi i parë dhe i tretë burojnë pjesërisht nga faktorë që nuk varen nga administrata tatimore (siç janë AKSHI dhe projekti i fiskalizimit), është e paqartë arsyeja e ristrukturimit të dytë, i cili buron dhe diktohet tërësisht nga vetë subjekti.

Konstatuam se në relacionin që shoqëron shkresën nr. 1181/2 prot., datë 05.02.2020 **kanë munguar:**

- Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi[15].

Edhe pse në këtë relacion, çështjet trajtohen pak më hollësisht, vumë re se, informacioni vijon të mbetet në nivel statistikor mbi numrin e punonjësve për çdo drejtori sa ishte dhe sa bëhet, pa dhënë një përshkrim të qartë për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi, detyrat apo dhe funksionet e tyre.

[8]Sipas pikës 33/c të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014)

*(Sipas relacionit, struktura e re e ATQ parashikon të ketë një **numër total punonjësish 1450, nga 1512 pozicione pune. Pra një reduktim në total me 62 pozicione pune.** Në krahasim me strukturën organizative aktuale, ku numri plan i nëpunësve civil është 1115 dhe punonjësve administrativë është 397, sipas propozimeve numri plan i nëpunësve civil do të jetë 1122, **pra me një rritje të numrit me 7 nëpunës,** si dhe numri plan i punonjësve administrativë do të jetë 328, pra me një **ulje të numrit me 69 pozicione**. Ky riorganizim prek Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, si dhe 13 Drejtoritë Rajonale Tatimore Tiranë, Fier, Shkodër, Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë, Kukës, Dibër, Lezhë, Berat, Korçë, Elbasan).*

Struktura e re e ATQ e propozuar, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1 Struktura e Administratës Tatimore Qendrore (propozim)

Struktura aktuale		Draft-struktura		Diferenca	
Numër plan		Numër plan		Numër plan	
1512		**1450**		**62**	
Nr. plan me status nëpunësi	Nr. plan me kod pune	Nr. plan me status nëpunësi	Nr. plan me kod pune	Nr. plan me status nëpunësi	Nr. plan me kod pune
1115	**397**	**1122**	**328**	**7**	**69**

Burimi: Relacioni i MFE-së, në shkresën nr.1181/2 prot, datë 05.02.2020.

Me shkresën nr. 902/1 prot., datë 10.02.2020, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike në DAP, i ka dërguar MFE dhe <u>për dijeni Kryeministrisë</u>, dakordësinë për miratimin e strukturës së re të DPT-së.
Me shkresën nr. 931/1 prot., datë 17.02.2020, Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, ka dërguar në MFE dhe DAP për miratim, organigramën e ATQ. (lidhja nr.1 ï 1/14).
Me shkresën nr. 1132/1 prot., datë 25.02.2020, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike në DAP, i kthen përgjigje DPT dhe për dijeni MFE, duke bërë komentet dhe vërejtjet për sa vijon: Konkretisht, për nëpunësit në Administratën Tatimore, struktura e pagës, vlera për secilin komponent, klasat dhe numri i tyre, si dhe shtesat mbi pagë janë përcaktuar në <u>VKM nr. 187 datë 08.03.2017, e ndryshuar. (lidhja nr. 6/8</u>).Si më poshtë:

1. *Për "Përgjegjës sektori" në njësinë mbështetëse në DPT, përcaktohet se kategoria e pagës për pozicion është III-b dhe jo III-a/1. Kategoria III-a/1, për pozicionet "Përgjegjës sektori" në DPT, është e dedikuar për njësitë teknike të përmbajtjes së institucionit. Si rrjedhim, kategoritë e pagave për emërtesat e sipërcituara duhet të ndryshojnë nga III-a/1, në III-b.*
2. *Për të gjitha pozicionet e punës që kanë një funksion inspektimi, duhet të përdoret emërtesa "Inspektor" i parë ose i dytë. Në Sektorin e Menaxhimit të Projekteve dhe Implementimit, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve, në vend të emërtesës "Inspektor I"-kategoria III-b, duhet të vendoset emërtesa "Specialist-kategoria IV-a;*
3. *Kategoria e pagës për pozicionet "Specialist" në Drejtorinë e Tatimpaguesve të mëdhenj dhe në të gjitha drejtoritë rajonale, nuk mund të jetë në asnjë rast IV-a , ajo duhet të ndryshojë në IV-b.*

Me shkresën nr. 3259/5 prot., datë 11.03.2020, Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, ka dërguar në MFE dhe për dijeni DAP-it, lidhur me draft-organigramën e ATQ, propozimin për <u>mos ndryshimin</u> e kategorive të pagave të pozicioneve të cituara nga DAP, duke i argumentuar se:

1. *Në komunikimin elektronik mes DPT dhe DAP, DAP shpreh dakortësinë me propozimet të cilat nuk përcjellin kosto të shtuar;*
2. *Për periudhën gusht 2016 – janar 2020, për ATQ janë miratuar 3 struktura organizative dhe organigrama, për të cilat edhe pse VKM nr. 187 datë 08.03.2017 ka qenë në fuqi, pa ndryshimet konkrete (lidhja 6/8), nuk janë kërkuar ndryshime në kategoritë e pagave të pozicioneve të punës;*

3. *Funksionet mbështetëse, sipas komenteve të DAP, janë jo vetëm sektorët e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, por edhe funksione të tjera ligjore, financiare etj. Megjithatë,nëdetyrat që ushtrojnë këto drejtori dhe stafi që menaxhojnë, është përtej logjikës së atashimit të një kategorie page III-b, për një drejtori që hartojnë strategji trajnimi e rekrutimi, menaxhojnë një staf prej 1500 punonjësish dhe të jetë e njëjtë me atë të një përgjegjësi zyre në sektorin e monitorimit territorial që nga përgjegjësia ka një nivel më të ulët sesa Përgjegjësi në DPT.*
4. *DRT Tiranë, në strukturën e saj ka Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse, të organizuar në 3 sektorë (financë, administratë, juridik) me 3 përgjegjës sektori me kategori page III-b. Në këtë kuptim,funksionet e Përgjegjësit të Sektorit në varësi të Zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Funksioneve Mbështetëse, e DPT nuk mund të konsiderohen dhe të trajtohen me kategori page III-b, në të njëjtin nivel me Përgjegjësit e Sektorëve në Drejtori Rajonale Tatimore, për vetë natyrën e përgjegjësitë e punës që kanë.*

Nga auditimi u konstatua se,

1**.DPT në argumentet e tyre vazhdon të shprehet gabim duke pohuar se, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme janë 14 Drejtori Rajonale, të organizuara edhe ato në Drejtori dhe Sektorë, në funksion të përcaktimit të kritereve konkrete, me një numër total me **1512 punonjës,** ndërkohë që struktura re e ATQ, e miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 është**1450 pozicione.
***2**.Konstatuam se, në lidhjen nr. 1 të strukturës organizative të DPT, së miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016", **Përgjegjësit e Sektorit në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetësejanë në varësi direktetë drejtorëve të Drejtorive të tyre dhe jo direkt në varësi të Zv.Drejtorit të Përgjithshëm** të Funksioneve Mbështetëse, sikundër pretendon DPT. Pra, hierarkia është e njëjtë, si për Drejtorinë e Përgjithshme Tatimore ashtu dhe për Drejtoritë Rajonale.*
***3**.DAP, nuk ka bërë komente dhe vërejtje për kategoritë e pagave dhe të pozicioneve, në dy ristrukturimet e mëparshme.*
***4**. DAP, nuk ka bërë komente dhe vërejtje për kategoritë e pagave dhe të pozicioneve, sipas shkresës nr. 8422/1 prot, datë 24.04.2019, të MFE, "Propozim për ndryshim të ATQ, miratuar me urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019,"Për disa ndryshime në urdhrin nr. 126 datë 02.08.2016, të Kryeministrit, dërguar DAP-it. Në të i bashkëngjiten: propozimi për ndryshimet në strukturë për DPT me lidhjet nr.1 (1/14), draft organigramën e ATQ, (pra skema që përmban pozicionet e punës për çdo njësi organizative individuale si dhe kategoritë përkatëse të pagës për çdo pozicion.*
***5.** Në kushtet kur kemi konstatuar se, disa nga rekomandimet e DAP qëndrojnë bazuar në VKM nr.187 datë 08.03.2017 (lidhja6/8) por, DPT nuk i ka marrë në konsideratë dhe ka vijuar me miratimin e organogramës sikundër e ka propozuar vetë, roli i DAP në këtë proces ka qenë jo reagues. Për sa më sipër, gjykojmë se nevojitej dakordësimi midis DAP dhe DPT për kategorinë e pagave të ATQ, sipas lidhjes 6/8, siç përcakton pika 36 e VKM nr. 893 datë 17.12.2014, e citon se: Në rast se ka qëndrime të kundërta ndërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike dhe, sipas rastit, t'i reflektojë ose të argumentojë mos reflektimin e tyre. Në rast se vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave organizon një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve.*

DAP disponon, shkresën nr. 1181/7 prot., datë 27.03.2020, e Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor në MFE, dërguar DPT ku janë bashkëngjitur urdhri nr. 79, datë 27.03.2020 i ministrit të MFE, ñPër miratimin e organigramës të ATQò me lidhjet 1-1/14, të Drejtorive Rajonale të ATQ. (Vëmë re se, miratimi i organigramës së ATQ, nuk është bërë në zbatim të lidhjes 6/8, të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017, e ndryshuar, pasi në lidhjet 1-1/14 të miratuara nga ministri i MFE, nuk janë reflektuar vërejtjet e bëra nga DAP, në lidhje me kategoritë e pagave dhe e emërtesat e tyre).

Me shkresën nr. 6743 prot., datë 16.04.2020, Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor në MFE, i dërgon DAP-it, kërkesën për rivlerësimin e pagave për disa funksione në DPT dhe bashkëngjitur saj, lidhjen 6/8 të propozuar, duke paraqitur të njëjta argumente, si në shkresën nr. 3259/5 prot., datë 11.03.2020 dhe *<u>përcaktimin e saktë të emërtesave të disa pozicioneve në Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe atë të Verifikimit dhe Koordinimit në Terren, si dhe përfshirjen në lidhjen 6/8 të emërtesave të funksioneve të Kabinetit të Drejtorit të Përgjithshëm.</u>*
Me shkresën 13043/1 prot., datë 27.07.2020, Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor në MFE, ka dërguar në DAP, projekt strukturën organizative të DPT dhe relacionin shoqërues për disa ndryshime në urdhrin nr. 33 datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, ku sipas urdhrit nr. 106, datë 25.07.2019 të Kryeministrit, i ndryshuar me urdhrin nr. 86, datë 25.06.2020 ñPër krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsionò, propozohet shtimi i këtij pozicioni në DPT, në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm, jashtë sferës së shërbimit civil dhe pakësimi i një pozicioni vakant ñInspektor i Iò, në Drejtorinë e Investigimit të Brendshëm Antikorrupsion, duke mos patur ndryshim në numrin total prej 1450 pozicione në strukturë dhe <u>brenda fondeve buxhetore aktuale</u>. Ka pakësim në numrin e nëpunësve civil, i cili ishte 1122, bëhet 1121 pozicione.

Me shkresën nr. 3333/1 prot., datë 29.07.2020, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike në DAP, shpreh dakortësinë për propozimin e strukturës së ATQ.
Me shkresën nr. 6326/1 prot., datë 02.12.2020, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Administratës Publike në DAP, i kthen përgjigje shkresës nr. 22569/1 prot., datë 26.11.2020, së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT dhe për dijeni MFE-së, në lidhje me miratimin në ndryshimin e bërë në urdhrin nr. 33 datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, e cila citon se :(*nga shqyrtimi i përmbajtjes së projekt urdhrit dhe lidhjes nr. 1, nuk synohet të miratohet organigrama e ATQ, por vetëm disa ndryshime në organigramën e DPT. Sygjerojmë: Në lidhjen nr. 1 të përmendur në pikën nr. 2 të urdhrit nr.79 datë 27.03.2020 të ministrit të MFE të bëhen këto ndryshime:*

1. *Pas pozicionit "Drejtor i Përgjithshëm, të shtohet pozicioni "Koordinator në Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion - kategoria II-b".*
2. *Në Drejtorinë e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion), shkurtohet 1 pozicion, "Inspektor i parë"*
3. *Numri i punonjësve të Drejtorisë së Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion), të bëhet gjithsej, 8 veta") .*

<u>Në këto korrespondenca nuk rezulton të përmendet krijimi i hapësirave për gjyqfituesit</u>"

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.1, datë 16.04.2021

<u>Observacionet e DAP-it</u>:
Në lidhje me Projekt Raportin "Për auditimin e ushtruar në DAP", sipas programit nr. 297/1 datë 26.02.2021, i ndryshuar, është dërguar observacioni nr. 4412/1 prot, datë 26.08.2021, nga znj. A.K, Drejtor i Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, protokolluar në KLSH me nr.297/11 datë 30.08.2021, i përmbledhur si në vijim:
1) "... Organi propozues dhe ai që e dërgon tek Kryeministri për miratim strukturën funksionale të admnistratës tatimore qendrore është ministri i Financave, pasi e ka bashkërenduar propozimin me DAP-in. Pra, në këtë rast DAP-i nuk është institucioni që përgatit dhe dërgon projekturdhrin tek Kryeministri..."
"... Si rrjedhim, bazuar në përcaktimet ligjore si më sipër, duke marrë në konsideratë:
-faktin që ligji nr. 9920/2008, i ndryshuar është ligji specifik mbi bazën e të cilit është krijuar dhe funksionon administrata tatimore qendrore e që në kuptim të hierarkisë së akteve është ligji që për administratën tatimore qendrore prevalon në lidhje me ligjet e tjera në fuqi, (aq më tepër prevalon mbi një vendim të Këshillit të Ministrave –VKM-ja nr.893/2014,), si dhe,

-faktin që në ligjin nr. 9920/2008, të ndryshuar është përcaktuar në mënyrë eksplicite dhe vazhdon të jetë në fuqi pa asnjë hapësirë interpretimi, përcaktimi që organi propozues për tek Kryeministri, i strukturës organizative të administratën tatimore qendrore, si dhe organi që duhet të realizojë procedurën e bashkërendimit me DAP-in përpara dërgimit të tij tek Kryeministri, është ministri i Financave",
pasoja llogjike është që kompetencë e DAP-it është vetëm dhënia e mendimit për propozimin e bërë nga ministri i Financave.
2) Në lidhje me konstatimin nr. 4, në faqen 17, të projekt raportit, sipas të cilit "DAP nuk ka bërë komente dhe vërejtje për kategoritë e pagave dhe të pozicioneve në dy ristrukturimet e mëparshme"...
Gjithashtu, theksojmë se grupi i audituesve nuk ka asnjë dokument zyrtar përpara vitit 2020 që vërteton që DPT apo Ministria e Financave të ketë dërguar pranë DAP zyrtarisht për mendim propozimin për organigramën e ATQ (ku pasqyrohen edhe kategoritë e pagave të pozicioneve të punës)...
3) "...Në lidhje me konstatimin që në korrespondencat për miratimin e ristrukturimeve të ATQ nuk përmendet krijimi i hapësirave për gjyqfituesit dhe qëndrimit të grupit të audituesve në lidhje me këtë, DAP-i i mbetet qëndrimit të dhënë mbi akt konstatimin nr. 1 datë 16.04.2021....

<u>Qëndrimi i grupit të audituesve të KLSH:</u>
1) -Për sa i takon pikës së parë të observimit tuaj, grupi i auditimit shprehet se, referuar pikës 37 të VKM nr. 893, datë 17.12.2014, "Departamenti i Administratës Publike i paraqet Kryeministrit projekt urdhrin për miratimin e strukturës dhe të organikës së institucionit", për institucionet publike, kur organizimi i brendshëm, kryhet në bazë të ligjit 90/2012, dhe nuk kanë një ligj të veçantë. Për sa trajtuar më sipër, observimi juaj merret në konsideratë dhe u reflektua në Raportin Përfundimtar të Auditimit.
- Në lidhje me pretendimet e DAP, për hapat e ndjekur në ristrukturimin e administratës tatimore, theksojmë se, DAP nuk ka ndjekur hapat që përcaktohen qartësisht në VKM nr. 893, datë 17.12.2014, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm". Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 16, pika 1, parashikon se : Struktura organizative dhe numri i përgjithshëm i personelit të administratës tatimore qendrore miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Financave, ***pas bashkërendimit me DAP-in.*** *Ndërkohë që miratimi më tej i rregullave të organizimit dhe të funksionimit (...) të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm rregullohen me VKM nr. 893, datë 17.12.2014, nga ana e DAP nuk na u vu në dispozicion asnjë kuadër tjetër ligjor apo rregullator në këtë fushë. Për më tepër që në korrespondencat shkresore DAP-DPT-MFE, vazhdimisht i referohen pikërisht kësaj VKM-je.*
VKM nr. 893, datë 17.12.2014, e përfshin marrëdhënien DAP-DPT në pikën 31 në paragrafin e dytë të të cilit parashikohet se: "Në rastet kur, mbështetur në një ligj të veçantë, struktura organizative miratohet nga një organ tjetër, merret në mënyrë të detyrueshme mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe i Ministrisë së Financave", e cila kjo pikë, më pas pasohet nga pika të tjera të VKM-së.
Në këto kushte, vete përjashtimin e DAP-it nga ndjekja e procedurave sipas VKM nr. 893, date 17.12.2014, e konsiderojmë të pambështetur.
Për sa trajtuar më sipër, observimi juaj nuk merret në konsideratë.
2)*Përsa i takon observimit nr. 2, grupi i auditimit ju bën me dije se, disponon shkresën nr. 8422/1 prot, datë 24.04.2019, të MFE, "Propozim për ndryshim të ATQ, miratuar me urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019,"Për disa ndryshime në urdhrin nr. 126 datë 02.08.2016, të Kryeministrit, dërguar DAP-it. Në të i bashkëngjiten: propozimi për ndryshimet në strukturë për DPT me lidhjet nr.1 (1/14), draft organigramën e ATQ, (pra skema që përmban pozicionet e punës për çdo njësi organizative individuale si dhe kategoritë përkatëse të pagës për çdo pozicion.*
Gjithashtu, në shkresën nr. 3259/5 prot., datë 11.03.2020, të Sektorit të Rekrutimit dhe Promovimit, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, citojmë argumentin : "Për periudhën gusht 2016 –

janar 2020, për ATQ janë miratuar 3 struktura organizative dhe organigrama, për të cilat edhe pse VKM nr. 187 datë 08.03.2017 ka qenë në fuqi, pa ndryshimet konkrete (lidhja 6/8), nuk janë kërkuar ndryshime në kategoritë e pagave të pozicioneve të punës". Argument mbi të cilin, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion shkresë kundërshtuese apo argumentuese nga ana e DAP-it, dërguar në ATQ. Për sa trajtuar më sipër, *observimi juaj nuk merret parasysh.*
*3) Përsa i takon observimit nr. 3, grupi i auditimit ju bën me dije se, edhe pse procesi i ndryshimit të strukturës dhe organikës së një institucioni nuk iniciohet për të krijuar hapësira për gjyqfituesit, në momentin që përgatitet relacioni paraprak për ristrukturimin e institucionit, DAP ka informacion mbi vendimet gjyqësore, vlerësojmë se shton vlerë trajtimi i gjyqfituesve në procesin e ristrukturimit, me qëllim edhe menaxhimin e burimeve njerëzore, por edhe të fondeve buxhetore.*Për sa trajtuar më sipër, *observimi juaj nuk merret parasysh.*

b) Mbi auditimin e shpalljeve të vakancave për plotësimin e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Me urdhrin nr. 1, datë 12.04.2019, titullari i institucionit znj. A.K, ka miratuar rregulloren e brendshme. Në organizimin e brendshëm (struktura dhe organika), të miratuar me urdhrin nr. 56, datë 25.03.2019, të Kryeministrit, në nenin 9 të saj, është Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil njësia përgjegjëse për:

- Organizimin e procedurave të rekrutimit për kategorinë ekzekutive, si dhe të ulët e të mesme drejtuese.
- Organizimin e procedurave të rekrutimit dhe menaxhimin e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND) në institucionet e administratës shtetërore.
- Menaxhimin e proceseve që lidhen me emërimet, lirimet, transferimet, pezullimet, konfirmimet e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.
- Administrimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionet e administratës shtetërore.
- Administrimin e të dhënave në lidhje me emërimet, lirimet, pezullimet, transferimet, masat disiplinore dhe çdo lëvizje tjetër në institucionet e administratës shtetërore duke mbajtur rekordet përkatëse.

Procesi i planifikimit dhe shpalljes së vendeve vakante në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, realizohetduke u mbështetur në nenin 18 ñPlani vjetor i pranimit në shërbimin civilò të ligjit nr.152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar dhe VKM nr. 108, datë 26/02/2014 ñPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civilò.

Për të bërë planifikimin e nevojave për rekrutim, Administrata Tatimore Qendrore duhet të bazohet në VKM nr. 108, datë 26/02/2014, ñPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civilò, pika 3, Institucioni për planifikimin vjetor të pranimit në shërbimin civil, të ketë parasysh:

a- Vendet aktualisht vakante, përfshirë edhe pozicionet për të cilat procedura e rekrutimit e organizuar gjatë vitit paraardhës, ka përfunduar pa fitues;
b- Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësve civilë përgjatë gjithë periudhës deri në fund të vitit të ardhshëm;
c- Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil;
d- Ecurinë e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara më sipër (raste të dorëheqjeve, raste të pezullimeve për afate më të gjata se tre muaj, për të cilat mund të bëhet publikimi si vend vakant etj, për të gjithë periudhën deri në fund të vitit të ardhshëm).

Njësia përgjegjëse në DAP, i bën me dije institucionit, se përcjellja e kërkesës zyrtare për plotësimin e vendit vakant pjesë e shërbimit civil, është vetëm faza e parë e procesit të rekrutimit në institucionet shtetërore. Ky proces vijon me pasqyrimin e pozicionit vakant në sistemin e HRMIS (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) për të kaluar më pas në sistemin online të rekrutimit, në platformën administrata.al.

Me shkresën nr. 8264 prot., datë 20.11.2018, DAP ka përcjellë shkresën zyrtare mbi planifikimin e nevojave për pranim për vitin 2019.

Nga auditimi u konstatua se, për një periudhë relativisht të shkurtër, ATQ ka kaluar në tre procese ristrukturimi të njëpasnjëshme. Në tabelën nr. 1 janë pasqyruar vakancat e ATQ në muajin janar të vitit 2019:

Tabela nr. 1 Vakancat e ATQ në Janar 2019

Struktura me Urdhër 126, datë 02.08.2016 nr. total 1569 punonjës				
Administrata Qendrore Tatimeve Janar 2019				
Subjekti	**Struktura Plan**	**Struktura Fakt**	**Vakancat në total**	**Vakanca nëpunës civil**
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	279	244	35	34
Drejtoria Tatimpaguesve të Mëdhenj	120	114	6	6
Drejtoria Tatimpaguesve Tiranë	367	354	13	10
Drejtoria Tatimpaguesve Fier	150	126	24	17
Drejtoria Tatimpaguesve Durrës	107	95	12	12
Drejtoria Tatimpaguesve Shkodër	130	98	32	12
Drejtoria Tatimpaguesve Elbasan	69	52	17	17
Drejtoria Tatimpaguesve Korçë	68	60	8	8
Drejtoria Tatimpaguesve Vlorë	52	44	8	8
Drejtoria Tatimpaguesve Lezhë	44	37	7	7
Drejtoria Tatimpaguesve Berat	41	36	5	5
Drejtoria Tatimpaguesve Gjirokastër	38	32	6	6
Drejtoria Tatimpaguesve Sarandë	36	32	4	4
Drejtoria Tatimpaguesve Dibër	34	27	7	6
Drejtoria Tatimpaguesve Kukës	34	17	17	17
Totali	**1569**	**1368**	**201**	**169**

Burimi: DPT, përpunuar nga grupi i audituesve.

Nga të dhënat e pasqyruara në tabelën nr. 1 u konstatua se, struktura plan me strukturën fakt e ATQ, në Janar 2019, është me nje diferencë prej 169 pozicione vakante në punonjës me status nëpunësi civil. Ky numër vakancash konstatohet përpara ristrukturimit të parë, me urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019.

Nëristrukturimin e parë, miratuar me urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit ñ*Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"*, struktura dhe organika e re u bë gjithsej **1512 pozicione**, nga **1569 që ishin përpara këtij ristrukturimi.**
Në ristrukturimin e dytë, miratuar me urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore*ò, struktura dhe organika e re u bë gjithsej **1512 pozicione pune**, numër i njëjtë ky me pozicionet e strukturës së mëparshme, por me ndryshime në emërtesa dhe riorganizime të drejtorive dhe sektorëve. Në tabelën nr. 2 janë pasqyruar vakancat e ATQ në muajin dhjetor të vitit 2019:

Tabela nr. 2 Vakancat e ATQ në Dhjetor 2019

Struktura me Urdhër 86, datë 03.05.2019 nr. total 1512 punonjës
Administrata Qendrore Tatimeve Dhjetor 2019

Subjekti	Struktura Plan	Struktura Fakt	Vakancat në total	Vakanca nëpunës civil
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	249	204	45	27
Drejtoria Tatimpaguesve të Mëdhenj	127	101	26	19
Drejtoria Tatimpaguesve Tiranë	359	323	36	26
Drejtoria Tatimpaguesve Fier	146	133	13	11
Drejtoria Tatimpaguesve Durrës	104	91	13	11
Drejtoria Tatimpaguesve Shkodër	126	108	18	7
Drejtoria Tatimpaguesve Elbasan	66	56	10	10
Drejtoria Tatimpaguesve Korçë	66	61	5	5
Drejtoria Tatimpaguesve Vlorë	50	43	7	7
Drejtoria Tatimpaguesve Lezhë	43	36	7	6
Drejtoria Tatimpaguesve Berat	40	37	3	4
Drejtoria Tatimpaguesve Gjirokastër	36	33	3	3
Drejtoria Tatimpaguesve Sarandë	34	29	5	5
Drejtoria Tatimpaguesve Dibër	33	28	5	5
Drejtoria Tatimpaguesve Kukës	33	23	10	10
Totali	**1512**	**1306**	**206**	**156**

Burimi: DPT, përpunuar nga grupi i audituesve.

Nga të dhënat e tabelës nr. 2, u *konstatua se, në Dhjetor 2019 pas ristrukturimit të dytë, me urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019, numri total i punonjësve në strukturën plan ishte 1512, në diferencë me strukturën fakt, prej 156 pozicione vakante, në punonjës me status nëpunësi civil.*



Nga auditimi u konstatua se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e DPT ka pasqyruar 12 pozicione vakante në sistemin HRMIS dhe publikuar në platformën administrata.al, në periudhën 04 Nëntor – 17 Dhjetor të vitit 2019, të shpallura më pas nga DAP.

Konstatojmë se, DPT nuk ka përmbushur detyrën që i ngarkon Lidhja 3 *"Përkufizimi i administruesve dhe përdoruesve të sistemit"* e VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*".

Konstatojmë se, DAP nuk ka përmbushur detyrën që i ngarkon Lidhja 3 e VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*", në të cilën citohet:

Pika 1. a) DAP është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë së pandërprerë dhe mirëfunksionimin e Regjistrit Qendror të Personelit. b) Mbikëqyr dhe monitoron veprimet që kryhen në Regjistrin Qendror të Personelit në përgjithësi.

*RQ*P-ja dhe platforma e bashkëpunimit ñadministrata.alò shërbejnë si burim informacioni apo mjet kontrolli për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe DAP-in, për realizimin e funksioneve të tyre lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil.

Tabela nr. 3 Shpalljet e vitit 2019 – 12 vakanca

Nr	Kodi	Lloji i diplomës	Pozicioni
1	2170 cso	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm Territorial, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - kategoria II-b	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm Territorial, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - kategoria II-b
2	2174cso	Drejtor i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve- Kategoria: III-a	Drejtor i Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve- Kategoria: III-a
3	2455nc	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë - kategoria III-a	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë - kategoria III-a
4	2456cso	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë - kategoria III-a	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë - kategoria III-a
5	2457cso	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë - kategoria III-a	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë - kategoria III-a
6	2458nc	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës - kategoria III-a	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës - kategoria III-a
7	2465nc	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan - kategoria III-a	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan - kategoria III-a
8	2466nc	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër - kategoria III-a	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër - kategoria III-a
9	2467cso	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër - III-a	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër - III-a
10	2474cso	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë - kategoria III-a	Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë - kategoria III-a
11	2511ex	Lloji i diplomës "Shkenca Ekonomike/Shkenca Juridike", niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"	Inspektor i Parë në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - kategoria III-b
12	2539nc	Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - kategoria III-a	Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve - kategoria III-a

Burimi: Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil në DAP.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar vakancat e muajit Janar 2020, ku numri i strukturës plan është i njëjtë me atë të muajit dhjetor 2019, 1512 punonjës në total, 1341 është numri i strukturës fakt. *Pozicionet vakantenë punonjës me status nëpunësi civil janë 137.*

Tabela nr. 4 Vakancat e ATQ në Janar 2020

Struktura me Urdhër 86, datë 03.05.2019 nr. total 1512 punonjës				
Administrata Qendrore Tatimeve Janar 2020				
Subjekti	**Struktura Plan**	**Struktura Fakt**	**Vakancat në total**	**Vakanca nëpunës civil**
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	249	205	44	26
Drejtoria Tatimpaguesve të Mëdhenj	127	113	14	11
Drejtoria Tatimpaguesve Tiranë	359	340	19	19
Drejtoria Tatimpaguesve Fier	146	133	13	11
Drejtoria Tatimpaguesve Durrës	104	91	13	11
Drejtoria Tatimpaguesve Shkodër	126	111	15	7
Drejtoria Tatimpaguesve Elbasan	66	57	9	9
Drejtoria Tatimpaguesve Korçë	66	61	5	5
Drejtoria Tatimpaguesve Vlorë	50	43	7	7
Drejtoria Tatimpaguesve Lezhë	43	37	6	6
Drejtoria Tatimpaguesve Berat	40	35	5	4
Drejtoria Tatimpaguesve Gjirokastër	36	33	3	3
Drejtoria Tatimpaguesve Sarandë	34	29	5	5
Drejtoria Tatimpaguesve Dibër	33	28	5	5
Drejtoria Tatimpaguesve Kukës	33	25	8	8
Totali	**1512**	**1341**	**171**	**137**

Burimi: DPT, përpunuar nga grupi i audituesve.

Nëristrukturimin e tretë, miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"*, struktura dhe organika e re u bë gjithsej 1450 pozicione, nga 1512 që ishin në strukturën e mëparshme. Në tabelën nr. 5 janë pasqyruar vakancat e ATQ në muajin dhjetor të vitit 2020.

Tabela nr. 5 Vakancat e ATQ në Dhjetor 2020

Struktura me Urdhër 33, datë 12.02.2020 nr. total 1450 punonjës				
Administrata Qendrore Tatimeve Dhjetor 2020				
Subjekti	**Struktura Plan**	**Struktura Fakt**	**Vakancat në total**	**Vakanca nëpunës civil**
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	308	234	74	69
Drejtoria Tatimpaguesve të Mëdhenj	128	119	9	9
Drejtoria Tatimpaguesve Tiranë	354	301	53	51
Drejtoria Tatimpaguesve Fier	122	107	15	15
Drejtoria Tatimpaguesve Durrës	88	79	9	8

Drejtoria Tatimpaguesve Shkodër	99	97	2	2
Drejtoria Tatimpaguesve Elbasan	58	54	4	4
Drejtoria Tatimpaguesve Korçë	58	57	1	1
Drejtoria Tatimpaguesve Vlorë	47	41	6	6
Drejtoria Tatimpaguesve Lezhë	37	33	4	4
Drejtoria Tatimpaguesve Berat	33	31	2	2
DrejtoriaTatimpaguesve Gjirokastër	30	29	1	1
Drejtoria Tatimpaguesve Sarandë	30	27	3	3
Drejtoria Tatimpaguesve Dibër	29	26	3	3
Drejtoria Tatimpaguesve Kukës	29	21	8	8
Totali	**1450**	**1256**	**194**	**186**

Burimi: DPT, përpunuar nga grupi i audituesve.

Nga të dhënat e tabelës nr. 5, u *konstatua se, në Dhjetor 2020 pas ristrukturimit të tretë, me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, numri total i punonjësve në strukturën plan ishte 1450, në diferencë me strukturën fakt, prej 186 pozicione vakante, në punonjës me status nëpunësi civil.*

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, ñPër nëpunësin civilò, të ndryshuar, dhe të nenit nr. 4 të ligjit nr. 10325, datë 23.09.2010, ñPër bazat e të dhënave shtetëroreò, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 833, datë 28.10.2020, *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò, ku DAP-i krijon dhe administron Regjistrin Qendror të Personelit (sistemin HRMIS) dhe platformën e bashkëpunimit ñadministrata.alò.

Nga auditimi u konstatua se, në fund të vitit 2020, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e DPT ka pasqyruar 156 pozicione vakante në sistemin HRMIS dhe publikuar në platformën administrata.al, të shpallura më pas nga DAP.
Konstatojmë se, DAP nuk ka përmbushur detyrën që i ngarkon VKM nr. 833 datë 28.10.2020, *"Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò, Kreu IV, Detyrimet e institucioneve në lidhje me RQP-në dhe platformën e bashkëpunimit ñadministrata.alò i cili citon:

Kreu IV/4: DAP-i menaxhon modulet për ndjekjen e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore në platformën e bashkëpunimit "administrata.al", të përcaktuara në shkronjën "a", të pikës 12, të kreut III, të këtij vendimi.
Kreu III/12
a) proceset e rekrutimit, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të përshkrimeve të punës, të vlerësimit të rezultateve në punë, si dhe të çështjeve gjyqësore dhe të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Tabela nr. 6 Shpalljet e vitit 2020 – 156 vakanca (tabela në Aneksi nr.2)
Grafiku: Shpalljet kundrejt vakancave, Dhjetor 2019, Dhjetor 2020



Burimi: Për shpalljet- DAP; për vakancat - DPT (grafiku i përgatitur nga grupi i auditimit të KLSH)

Në lidhje me shpalljen e pozicioneve vakante pranë Administratës Tatimore Qendrore, DAP përveç planifikimit vjetor, i cili përcillet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bazë të VKM nr. 108, datë 26.02.2014, ñPër planin vjetor të pranimit në shërbimin civilò, administron edhe shkresën zyrtare të Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës nr. 2970 prot., datë 23.10.2020. Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 33, datë 12.02.2020, ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, kjo drejtori ka në përbërje të saj 29 pozicione pune dhe aktualisht numri i kësaj strukture është 21 punonjës. Kërkesa e shpalljeve të 8 pozicioneve vakante nga DRT Kukës, ka ardhur si pasojë e largimit të punonjësve që nga viti 2013 e në vijim, duke sjellë moskryerjen në kohë e detyrave funksionale të saj. Kërkesat për pozicionet vakante në këtë Drejtori janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 7 Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës – pozicionet vakante.

Nr	Emërtimi në Strukturë	Pozicione vakante	U. i KM nr. 33 dt.12.02.2020	Fakt	Diferenca	Nr. i shpalljes nga DAP
1	Drejtoria e Kontrollit Tatimor	Drejtori i Kontrollit	9	6	3	3318/3538
		Përgjegjës Sektori				3545
		Inspektor i Parë				3550
2	Sektori i Funksioneve Mbështetëse	Përgjegjës Sektori	8	7	1	Sistemuar një gjyqfitues
3	Sektori i Shërbimit për Tatimpaguesit	Përgjegjës Shërbimi	7	4	3	3551
		Specialist i zyrës së asistencës & shërbimit të tatimpaguesve				3227
		Specialist i zyrës së rregjistrimit				Nuk është shpallur
4	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	Inspektor i dytë në kontabilitet	3	2	1	2605
	Shuma		**27**	**19**	**8**	

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i audituesve.

*Nga auditimi u konstatua se, edhe pse vakancat në DRT Kukës, kanë filluar që në vitin 2013, shpalljet nga DAP, janë bërë nga viti 2015 e në vazhdim.*Vendet vakante në këtë drejtori zënë27.6% të totalit, duke mbartur riskun e mos përmbushjes së objektivave institucionale, pasi struktura organizative është korniza me anë të së cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë. Ky risk konstatohet kryesisht në pozicione drejtuese.

Konstatojmë se:

1. *DAP, në rolin e Administratorit të RPQ-së, mban përgjegjësi, për mos mbikëqyrje dhe monitorim të veprimeve, të njësisë përgjegjëse në institucion, në lidhje me hedhjen e të dhënave në sistem.*
2. *Shpalljen me vonesë, të vakancave, të DRT Kukës.*

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.3, datë 16.04.2021

Observacionet e DAP:
Në lidhje me ProjektRaportin "Për auditimin e ushtruar në DAP", sipas programit nr. 297/1 datë 26.02.2021, i ndryshuar, është dërguar observacioni nr. 4412/1 prot, datë 26.08.2021, nga znj. A.K, Drejtor i Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, protokolluar në KLSH me nr.297/11 datë 30.08.2021, i përmbledhur si në vijim:
1)....Vendimi nr. 833 datë 28.10.2020, i Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", ka hyrë në fuqi më datë 02.11.2020 me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 190, datë 02.11.2020. Nga ky moment ligjor, parashikimet e dispozitave të këtij akti normativ janë të detyrueshme më+r t'u zbatuar nga subjektet e përfshira në procedurat administrative të parashikuara.
2) ...Procesi i planifikimit vjetor të pranimit në shërbimin civil është një institut i rregulluar hollësisht në aktet ligjore dhe nënligjore të shërbimit civil.....
3) Gjithashtu, ..."Mos organizimi dhe mos menaxhimi i mirë i proceseve të rekrutimit dhe të shpalljeve të pozicioneve vakante ka sjellë cënim të performancës së institucionit në tërësi.... Në këto kushte, nuk evidentohet raporti shkak-pasojë midis vendeve vakante në vitet 2019-2020 në administratën tatimore qendrore dhe cënimit të performancës institucionale.

Qëndrimi i grupit të audituesve të KLSH:
1) Në lidhje me pikën 1 të observimit tuaj, grupi i auditimit ju bën më dije se, detyrimi që nuk ka përmbushur DAP, në administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit të ATQ, ia ngarkon VKM nr. 833 datë 28.10.2020, hyrë në fuqi më datë 02.11.2020, për periudhën e mbetur nga programi i auditimit, nentor – dhjetor 2020, por dhe para miratimit të këtij Vendimi, DAP duhet të ndiqte të gjithë procedurat që i ngarkon VKM nr. 117, datë 05.03.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", i reflektuar edhe në raportin përfundimtar, të cilat kanë të bëjnë me regjistrin HRMIS. Për sa më sipër observimi juaj merret parasysh pjesërisht duke korrigjuar bazën ligjore, por konstatimi vijon te mbetet i njëjtë.
2) Në lidhje me procesin e planifikimit vjetor të pranimit në shërbimin civil e kemi shprehur gjerësisht në material, se realizohetduke u mbështetur në nenin 18 "Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil" të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe VKM nr. 108, datë 26/02/2014 "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil".
3) Në lidhje me observimin nr. 3, gjatë auditimit grupi konstatoi se në shkresën së Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës nr. 2970 prot., datë 23.10.2020, vendet vakante në këtë Drejtori, zënë27.6% të totalit,duke sjellë moskryerjen në kohë të detyrave funksionale të saj. Pra, nga auditimi ne parashikojmë risqe të cënimit të performancës së institucionit (pasi nuk vlerësojmë dot nga ky auditim performancën e një subjekti tjetër, por padiskutim që mund të flasim për risqe, në kushtet kur struktura në vetvete bëhet për t'i shërbyer objektivave....përveçse nëse është planifikuar gabim apo keq). Për sa më sipër, observimi juaj nuk merret parasysh.

Titulli i Gjetjes:1 Cënimi i hapave ligjore përgjatë procedurave të 3 ristrukturimeve.

Situata: Nga auditimi i procedurave të ndjekura, përgjatë **ristrukturimit të parë,** *me urdhrin nr. 49, datë **27.02.2019**, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* konstatuam se:
- hapat që duhet të ndiqeshin sipas VKM nr. 893, datë 17.12.2014, **nuk janë respektuar plotësisht** dhe me praktikën që shoqëron shkresën nr. 22539 prot., datë 24.12.2018 janë dërguar vetëm 2 dokumenta që janë:projekt urdhri për ndryshimin e strukturës organizative të ATQ dhe relacioni që përmban arsyet e nevojës për këtë ndryshim, **ndërsa kanë munguar** dokumentat si:

1. Mendimi nga MFE për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara[16]. Vumëre se, MFE në relacionin që ka sjellë citon vetëm se ñ*Ky ndryshim do të ketë efekte shtesë në buxhetin e shtetit*[17]*, duke sqaruar se struktura aktuale ishte e përbërë nga 1569 punonjës, nga të cilët 1165 pozicione të nëpunësit civil dhe 404 punonjës me Kod Pune dhe* ***bëhet*** *1512 punonjës,* ***ose 57 më pak se në strukturën e mëparshme, pa sqaruar pse ka shtesë në kosto kur në fakt numri i punonjësve reduktohet,*** *pa parashikuar vlerën e tyre;*

2. Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi[18]. Vumë re se në relacion jepet një informacion statistikor mbi numrin e punonjësve për çdo drejtori sa ishte dhe sa bëhet, pa dhënë një përshkrim të qartë për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;

3. Analiza sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara[19];

4. Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit, referuar kriterit të parashikuar në pikën 33/d të VKM nr. 893, datë 17.12.2014[20].

- **DAP ka shqyrtuar shkresën e MFE-së dhe ka përgatitur sugjerime pa mendimin e MFE mbi efektet konkrete financiare që sjell ky ristrukturim,** në kundërshtim me pikën 34 të VKM nr. 893, datë 17.12.2014, ku parashikohet se, *Departamenti i Administratës Publike nuk shqyrton dhe nuk përgatit për Kryeministrin asnjë propozim, që nuk paraqitet në përputhje me pikën 33, të këtij vendimi, dhe që nuk shoqërohet me mendimin e Ministrisë së Financave për efektet financiare*, (*për më tepër që MFE është në rolin edhe të propozuesit edhe të ministrisë që duhet të japë mendimin, mendim i cili nuk është dhënë*).

Ndërsa rezultoi se, MFE është shprehur mbi qëllimin e ndryshimit të strukturës, në përputhje me pikën 33/a të VKM nr. 893, datë 17.12.2014, ku shprehet ndër të tjera se: *"qëllimi i ndryshimit është përmirësimi i aspektit funksional dhe procedural të ATQ dhe bashkëpunimi institucional me Institucionet Publike të tjera, përshtatur me kontestin ligjor të sistemit tatimor. Në vijim, në zbatim të VKM-së nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e AKSHI-it", VKM-së nr. 208, datë 20.04.2018, "Për rishpërndarjen e numrit të punonjësve organik në njësitë e qeverisjes qendrore për vitin 2018", Drejtoria TIK, Sektorët e IT, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës, suprimohen dhe kalojnë në përbërje të AKSHI-t."*

- Gjithashtu rezultoi se,edhe nënë relacionin që shoqëron shkresën nr. 8422/1 prot., datë 24.04.2019 (referuar urdhrit nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit ï **ristrukturimi i dytë**), **ka munguar analiza sasiore për burimet e nevojshme** për kryerjen e funksioneve të caktuara në kundërshtim me pikën 33/ç të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014. Vumë re se në relacion jepet një informacion statistikor mbi numrin e punonjësve për çdo drejtori sa ishte dhe sa bëhet, pa dhënë një përshkrim të qartë të detyrave dhe funksioneve të tyre.

- Në relacionin që shoqëron shkresën nr. 1181/2 prot., datë 05.02.2020 (referuar *urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit-**ristrukturimi i***

[16] Sipas pikës 33/b të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[17] Sa janë parashikuar të jenë efektet shtesë?
[18] Sipas pikës 33/c të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[19] Sipas pikës 33/ç të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[20] Sipas pikës 33/d të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014

tretë)**kanë munguar** përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi[21]. Edhe pse në këtë relacion, çështjet trajtohen pak më hollësisht se në relacionet paraardhëse, vumë re se, informacioni vijon të mbetet në nivel statistikor mbi numrin e punonjësve për çdo drejtori sa ishte dhe sa bëhet, pa dhënë një përshkrim të qartë për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi, detyrat apo dhe funksionet e tyre. Sipas relacionit, struktura e re e ATQ parashikon të ketë një numër total punonjësish 1450, nga 1512 pozicione pune. Pra një reduktim në total me 62 ***pozicione pune plan.*** *Në krahasim me strukturën organizative aktuale, ku numri plan i nëpunësve civil është 1115 dhe punonjësve administrativë me kod pune është 397, sipas propozimeve numri plan i nëpunësve civil bëhet 1122,* ***pra me një rritje të numrit me 7 nëpunës,*** *si dhe numri plan i punonjësve administrativë do të jetë 328, pra me një* ***ulje të numrit me 69 pozicione****. Ky riorganizim prek Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, si dhe 13 Drejtoritë Rajonale Tatimore Tiranë, Fier, Shkodër, Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë, Kukës, Dibër, Lezhë, Berat, Korçë, Elbasan*.

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DAP rezultoi se, me shkresën nr.1181/2 prot., datë 05.02.2020, MFE i ka ri-dërguar për miratim, Kryeministrisë dhe njëkohësisht DAP-it, projekt-strukturën e DPT-së, bashkëlidhur me relacionin shpjegues të saj, pasi është ripunuar dhe mbështetur në komentet teknike të sugjeruara nga DAP.

Në kushtet kur kemi konstatuar se, disa nga rekomandimet e DAP qëndrojnë bazuar në VKM nr.187 datë 08.03.2017 (lidhja6/8) por, ***DPT nuk i ka marrë në konsideratë*** dhe ka vijuar me miratimin e organogramës sikundër e ka propozuar vetë, roli i DAP në këtë proces ka qenë jo reagues. Për sa më sipër, gjykojmë se nevojitej dakordësimi midis DAP dhe DPT për kategorinë e pagave të ATQ, sipas lidhjes 6/8, siç përcakton ***pika 36 e VKM nr. 893 datë 17.12.2014***, e citon se: Në rast se ka qëndrime të kundërta ndërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike dhe, sipas rastit, tëi reflektojë ose të argumentojë mos reflektimin e tyre. Në rast se vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave organizon një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve.

Kriteri: Ligji 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;

Ligji 90/2012, ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò, të ndryshuar.

VKM nr. 893, datë 17.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëmò.

Ndikimi/Efekti: Strukturat përgjegjëse në DAP, kanë patur një rol jo shumë aktiv në proceset e ristrukturimit të ATQ.

Shkaku: Shqyrtimi nga ana e DAP-it, të propozimeve për ndryshimin e strukturës së ATQ, janë kryer pa ju paraqitur nga DPT, të gjitha informacionet e nevojshme.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Për të gjitha rastet në vijim, Departamenti i Administratës Publike nuk duhet

[8]Sipas pikës 33/c të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014)

të marrë në shqyrtim propozime për ndryshimin e strukturës, bashkëlidhur të cilave mungojnë të dhënat si:
- Mendime për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara;
- Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;
- Analizën sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara;
- Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit.

Për të gjitha rastet në vijim, nëse ka qëndrime të kundërta ndërmjet DAP dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e DAP dhe tôi reflektojë ose të argumentojë mos reflektimin e tyre. Në rast se vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave duhet të organizojë një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve.

Titulli i Gjetjes:2 Shkelje e normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në komunikimet për çështje që lidhen me ristrukturimin në ATQ.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, **komunikimet shkresore mes DAP dhe MFE-së për çështje të ristrukturimit (**referuar këtu shkresës nr. 2386/1 prot., datë 30.04.2019 dhe shkresës nr. 2495/1 prot., datë 03.05.2019),edhe pse me lidhje organike ndërmjet tyre **nuk ndjekin të njëjtin numër protokolli,**në kundërshtim me nenin 19, pika 1, e ñNormave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, hartuar në mbështetje të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, në pikën 1 të të cilit kërkohet që: ñ*Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të, evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit.”*

Kriteri: Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò.
Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Ndikimi/Efekti: Shkresat korrespondente hyrëse dhe dalëse në institucion, e bëjnë të paqartë lidhjen kronologjike të çështjeve që trajtojnë.

Shkaku: Mungesë përgjegjësie e strukturave përkatëse.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandimi: Në të gjitha rastet në vijim, për dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre, njësia përgjegjëse për protokollimin e shkresave në DAP, duhet që për dokumentin e parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, tôi japë një numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të, të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

Titulli i Gjetjes:3 Plotësimi i strukturës dhe shpalljet e vakancave.

Situata: Nga auditimi rezultoi se,struktura plan me strukturën fakt e ATQ, **në**

Janar 2019 (pra, para se Administrata Tatimore Qendrore, t'i nënshtrohej procesit të ristrukturimit), paraqitet me **169 pozicione vakante** në punonjës me status nëpunësi civil.

Pas ristrukturimit të parë, me urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, struktura dhe organika e re e miratuar, numëron gjithsej 1512 pozicione, nga 1569 që ishin përpara këtij ristrukturimi.

Pas ristrukturimit të dytë, me urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, struktura dhe organika e re e miratuar, numëron gjithsej 1512 pozicione pune, numër i njëjtë ky me pozicionet e strukturës së mëparshme, por me ndryshime në emërtesa dhe riorganizime të drejtorive dhe sektorëve;

N*ë Dhjetor 2019,* pas ristrukturimit të dytë, numri total i punonjësve në strukturën plan ishte 1512, në diferencë me strukturën fakt, prej 156 pozicione vakante, në punonjës me status nëpunësi civil, ose 13 pozicione me pak nga sa kishte ne fillim te vitit 2019 dhe përpara ristrukturimit të parë. Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të vakancave, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e DPT ka pasqyruar në sistemin HRMIS dhe publikuar në platformën administrata.al, në periudhën 04 Nëntor ï 17 Dhjetor të vitit 2019, vetëm 12 pozicione vakante, të shpallura më pas nga DAP (nga 156 vakanca që ka gjithsej), duke mos përmbushur detyrën që i ngarkon Lidhja 3 e VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò.

Nga ana tjetër, konstatojmë se, DAP nuk ka përmbushur detyrën që i ngarkon Lidhja 3 e VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò, në të cilën citohet: Pika 1. a) *DAP është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë së pandërprerë dhe mirëfunksionimin e Regjistrit Qendror të Personelit. b) Mbikëqyr dhe monitoron veprimet që kryhen në Regjistrin Qendror të Personelit në përgjithësi.*

*RQ*P-ja dhe platforma e bashkëpunimit ñadministrata.alò shërbejnë si burim informacioni apo mjet kontrolli për DAP-in, por edhe për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për realizimin e funksioneve të tyre lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe në kushtet e mungesës së një informacioni të tillë, edhe detyrat funksionale të këtyre institucioneve ne lidhje me këtë çështje, rrezikojnë të cënohen.

Në vijim, rezultoi se në muajin **Janar 2020**, paraqiten **137 pozicione vakante** në punonjës me status të nëpunësit civil, ndërsa numri i strukturës plan është i njëjtë me atë të muajit dhjetor 2019 (1512 punonjës, ndërsa 1341 është numri i strukturës fakt).

Pas **ristrukturimit të tretë,** me urdhër nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò, struktura dhe organika e re e miratuar numëron gjithsej 1450 pozicione, nga 1512 që ishin në strukturën e mëparshme.

Ndërsa në**Dhjetor 2020** pas ristrukturimit të tretë, me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020, rezultuan gjithsej **186 pozicione vakante** me status nëpunësi

civil (ose 49 vakanca më shumë krahasuar me janarin 2020).

Kriteri: Ligji nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar;
VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, ñPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit;
VKM nr. 833 datë 28.10.2020, ñPër rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò;
Urdhri nr.126 datë 02.08.2016 ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò;
Urdhri nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016;
Urdhri nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016;
Urdhri nr. 33, datë 12.02.2020, të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016.

Ndikimi/Efekti: Mos organizimi dhe mos menaxhimi i mirë, i proceseve të rekrutimit dhe të shpalljeve të pozicioneve vakante, rrezikon të cënojë performancën e institucionit në tërësi si dhe në përmbushjen e objektivave të tij.

Shkaku: Mungesë veprimesh nga ana e Drejtorisë së Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: DAP të ushtrojë të gjitha kompetencat që i njeh ligji në rolin e administratorit të përgjithshëm të Regjistrit Qendror të Personelit (RQP), për të mbikëqyrur dhe monitoruar përmes mekanizmave të raportimit, veprimet që kryhen në RQP në përgjithësi si dhe ndërveprimin me burimet e të dhënave që përdoren në platformë; gjithashtu për të menaxhuar modulet për ndjekjen e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore (proceset e rekrutimit, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të përshkrimeve të punës, të vlerësimit të rezultateve në punë, si dhe të çështjeve gjyqësore dhe të vendimeve gjyqësore të formës së prerë) në platformën e bashkëpunimit ñadministrata.alò.

Titulli i Gjetjes:4 Mos krijimi i hapësirave për gjyqfituesit.

Situata: Për të tre ristrukturimet e kryera në ATQ në periudhën 2019-2020, MFE ka përcjellë shkresa DAP-it për mendime, propozime *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* duke i bashkëngjitur projekt-urdhrin për ndryshimin e strukturës organizative të ATQ dhe relacionin me arsyet e nevojës për këtë ndryshim. Në asnjë prej këtyre informacioneve, **nuk** gjetëm informacion mbi vakancat e krijuara si pasojë e ristrukturimeve. DAP-i, në të gjitha korrespondencat me MFE, ka kthyer përgjigje pasi ka shqyrtuar propozimin për ndryshimin e strukturës të ATQ. Ajo ka sugjeruar rishikimin e praktikës në dy pikëpamje: a) së pari sa i takon hartimit dhe propozimit të aktit, i cili duhet të përmbajë projektstukturën me skemat hierarkike organizative vertikale dhe horizontale dhe numrin e përgjithshëm të personelit të ATQ; dhe b) së dyti nga pikëpamja teknike. Në këto korrespondenca**nuk** rezulton të përmendet krijimi i hapësirave për sistemimin dhe kthimin në punë për gjyqfituesit, as nga DPT dhe as nga DAP me qëllim menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të përdorura për likuidimin e vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna.

Kriteri:	Urdhri nr. 5151 datë 28.10.2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò.
Ndikimi/Efekti:	Risqe për keq menaxhimin e fondeve buxhetore.
Shkaku:	Mungesa e analizës së situatës së gjyqfituesve me impakt në ristrukturim.
Rëndësia:	I lartë
Rekomandimi:	Në kushtet kur,DAP ka detyrimin edhe të mbikëqyrjes së procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, sipas urdhrit nr. 5151 datë 28.10.2015 ñ*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil",* rekomandojmë që, me qëllim marrjen e masave për menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, gjatë procedurave të ristrukturimit, DAP dhe institucionet e tjera të përfshira, të vlerësojnë edhe alternativat që mundësojnë rikthimin në detyrë të nëpunësve civil gjyqfitues.

2.2. VERIFIKIMI I REALIZIMIT TË ROLIT TË DAP NË KOMISIONIN E RISTRUKTURIMIT GJATË PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT TË ADMINISTRATËS TATIMORE.

Në zbatim të pikës 2 të programit të auditimit 297/1, datë 26.02.2021, mbi rolin e Departamentit të Administratës Publike në procesin e ristrukturimit të Administratës Qendrore Tatimore, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet procesi i ristrukturimit në institucionet e Administratës Shtetërore, pjesë e shërbimit civil, është si më poshtë:

1. Ligji nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar;
2. Vendimi nr. 125, datë 17.2.2016 i Këshillit të Ministrave, ñPër transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilëò;
3. Udhëzimi nr. 1 i Departamentit të Administratës Publike, datë 01.03.2016 ñPër krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimitò, i ndryshuar,
4. Ligji nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò
5. Akte të tjera ligjore dhe nënligjore sipas shqyrtimit të rasteve specifike.

Ristrukturim quhet një ndryshim thelbësor i brendshëm i institucionit, një proces riorganizimi, për arsye se:

- ŏ *ka patur ndryshime të misionit të institucionit;*
- ŏ *janë shtuar apo pakësuar vendet e punës dhe funksionet e institucionit;*
- ŏ *kanë ndryshuar kriteret e vendit të punës;*
- ŏ *kur kërkohet një rishpërndarje e ndryshme e burimeve të shtuara apo pakësuara për kryerjen e funksioneve.*

Në rastin e mbylljes apo ristrukturimit do të konsiderohen ndryshime të vendit të punës rastet në të cilat, për efekt të ristrukturimit të ndodhur në institucion:

a) *janë shkurtuar vende pune;*
b) *janë ristrukturuar vende pune;*
c) *kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës.*

Krijimi dhe funksionimi i komisionit të ristrukturimit

Me hyrjen në fuqi të fuqi të Aktit që ka miratuar mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, njësia e burimeve njerëzore duhet të njoftojë nëpunësit civilë për fillimin e procedurës të ristrukturimit, dhe për nevojën e përditësimit të dosjes personale.

Nëpunësi më i lartë civil i institucionit që preket nga ristrukturimi, jo më vonë se *dy ditë* pas hyrjes në fuqi të Aktit që ka miratuar mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit.
Njësia përgjegjëse (DAP), *brenda 2 ditëve* nga marrja e kërkesës krijon Komisionin e Ristrukturimit prej tre anëtarësh, të përbërë sipas rasteve të parashikuara në pikën 2, në Udhëzimin nr.1 të Departamentit të Administratës Publike, datë 01.03.2016 ñPër krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimitò, i ndryshuar.
Një nga anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit është përfaqësues i njësisë përgjegjëse (DAP), i cili është nëpunës civil, pjesë e Drejtorisë së Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil në këtë institucion. Pranë kësaj drejtorie ka nëpunës të dedikuar për menaxhimin e kësaj procedure administrative. Me miratimin e Urdhrit të DAP për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit për një institucion pjesë të shërbimit civil, ky organ kolegjial duhet të përmbushë detyrat si mëposhtë vijon:

1. Komisioni fillon shqyrtimin administrativ për mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, brenda 2 ditëve nga data e nxjerrjes së aktit të krijimit të Komisionit nga njësia përgjegjëse (DAP).

Nëpunësi më i lartë civil i institucionit ka për detyrë tëi paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo nëpunës që i nënshtrohet procesit të transferimit, që përfshin:

a) Përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuara, si dhe ndryshimin e kritereve specifike; b) Dosjen personale të nëpunësve në pritje për transferim;
b) Vërtetimin e vendbanimit të nëpunësit, të certifikuar nga organet kompetente.

2. Komisioni i Ristrukturimit për të dalë me një vendim përfundimtar vepron si më poshtë:

Së pari: Krahason strukturën dhe organikën e re me strukturën dhe organikën ekzistuese të institucionit për të evidentuar njësitë organizative ose pozicionet që preken nga ristrukturimi, ato që suprimohen dhe ato që krijohen rishtazi;
Së dyti:<u>Verifikon përshkrimet e punës të pozicioneve të ristrukturuara duke evidentuar ndryshimin e kriteret e veçanta për secilin pozicion;</u>
Së treti:<u>Verifikon dosjet personale të nëpunësve që preken nga ristrukturimi</u>, duke evidentuar arsimin, përvojën, vlerësimet në punë, trajnimet. Shqyrtimi i të dhënave të nëpunësve civilë bëhet në Regjistrin Qendror të Personelit (HRMIS), për këtë arsye <u>kërkohet paraprakisht përditësimi i të dhënave nga njësia e burimeve njerëzore e institucionit</u>. Në rastin e institucioneve që kanë drejtori rajonale, verifikon vërtetimin e vendbanimit, për të identifikuar nëpunësit me largësi vendbanimi me më shumë se 45km nga vendi i punës. Gjithashtu Komisioni duhet të marrë në konsideratë gjatë procesit të transferimit dhe nëpunësit me probleme shëndetësore të vërtetuar me raportin mjekësor.
Së katërti: Komisioni i Ristrukturimit pasi ka marrë në shqyrtim dhe ka vlerësuar të gjithë informacionin e sipërcituar mbi pozicionet dhe nëpunësit civil që preken nga ristrukturimi, merr vendim për transferimin e nëpunësve civilë në pozicionet e lira ekzistuese, brenda së njëjtës kategori, ku plotësojnë kriteret e veçanta, dhe në pamundësi të sistemimit të tyre brenda institucionit, shqyrton mundësinë e sistemimit në një pozicion të lirë në një institucion tjetër të shërbimit civil, sipas precedencës së parashikuar në nenin 50 të ligjit nr.152/2013 ñPër Nëpunësin Civilò, konkretisht nëpunësi civil transferohet:

a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar;
b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkrirë apo bashkuar, në një nga
c) institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi;
d) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar;
e) në një institucion tjetër të shërbimit civil.

Në pamundësi sistemimi të nëpunësit civil në në një pozicion vakant ku plotëson kriteret e veçanta, Komisioni vendos përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil.

3. Komisioni i Ristrukturimit merr vendimin për transferimin e nëpunësve apo përfundimin e marrëdhënies së tyre në shërbimin civil, **bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit**.

Kjo metodologji përdoret për të vlerësuar dhe krahasuar ata nëpunës që plotësojnë kriteret përkundrejt pozicionit për të cilin po gjykohet. Kjo metodë mundëson vlerësimin me pikë të kritereve kyç në procesin e ristrukturimit, të cilat janë arsimimi dhe përvoja në pozicionin aktual, pozicione të ngjashme dhe në tërësi në shërbimin civil, kualifikimet, trajnimet, vlerësimin në punë, masat disiplinore etj.

4. Pas këtij procesi Komisioni, *brenda 15 ditësh* nga momenti i krijimit të tij:

a) i propozon njësisë përgjegjëse (DAP), transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira sipas procedurave më sipër;
b) i dërgon njësisë së burimeve njerëzore të institucionit vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit sipas procedurave më sipër.

Komisioni i Ristrukturimit, duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira, **me arsyetimin/relacionin mbi këto transferime**. Hartimi i vendimit të komisionit të ristrukturimit mbi përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësit civil/nëpunësve civilë bëhet në rastet kur nuk evidentohen pozicione vakante të së njëjtës kategori, ku ata plotësojnë kriteret.

Duke qënë se procesi i ristrukturimit të institucioneve shtetërore në shërbimin civil është një procedurë administrative, Komisioni, ndër të tjera respekton parashikimet përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Roli i njësisë përgjegjëse (DAP) gjatë procesit të ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore

Njësia përgjegjëse (DAP), brenda 10 ditëve nga data e marrjes së propozimit nga Komisioni i Ristrukturimit, pasi e shqyrton, merr vendimin për:

a) Transferimin e nëpunësit/ve civil;
b) Kthimin e akteve Komisionit, në rastet kur vërtetohen parregullsi ligjore të dukshme, të cilat kanë ndikuar direkt në vendimmarrje. Komisioni shqyrton dhe ridërgon propozimet në DAP, brenda 5 ditëve nga kthimi i dokumentacionit.

Njësia përgjegjëse DAP përgatit dhe dërgon raportit përmbledhës së transferimeve për shkak të ristrukturimit, institucionit që ristrukturohet, si dhe përgatit aktet individuale të transferimit të nëpunësve civilë.

Të drejtat dhe detyrimet e nëpunësit civil gjatë procesit të ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore

a) Nëpunësi civil duhet të përditësojë të dhënat në dosjen e tij personale, duke depozituar ndër të tjera dokumentet, objekt vlerësimi nga komisioni, si p.sh. Trajnimet, diploma universitare të përfituara rishtazi, etj.;
b) Nëpunësi civil ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse (DAP), brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, vetëm në rast se:
    i. Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;
    ii. Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km larg nga vendbanimi i nëpunësit civil.
c) Nëpunësi ka të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi mbi vendimmarrjen e organeve kompetente.

Njësia përgjegjëse (DAP) verifikon shkaqet e refuzimit dhe mund të revokojë vendimin, nëse vërteton njërin prej dy rasteve të sipërcituara, duke i rikthyer aktet për rivlerësim Komisionit të Ristrukturimit. Komisioni brenda 5 ditëve nga marrja e akteve për rivlerësim, duhet tëi propozojë njësisë përgjegjëse (DAP) transferimin e ankuesit në një pozicion pune të përshtatshëm për kushtet e gjendjes shëndetësore apo të vendbanimit.

Të drejtat e garantuara nga ligji për shërbimin civil për nëpunësin e liruar për shkak të ristrukturimit/mbylljes të institucionit

Nëpunësit civil që lirohet nga shërbimi civil në respektim të neneve 50 dhe 66 të ligjit nr. 152/2013 ñpër Nëpunësin Civilò i ndryshuar, në përfundim të procesit të ristrukturimit kanë të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, sipas rasteve të mëposhtme:

a) deri në një vit eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 1 muaji;
b) nga 1 - 3 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 3 muajve;
c) nga 3 - 6 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 6 muajve;
ç) nga 6 - 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 9 muajve;
d) mbi 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 12 muajve.

Përveç të drejtave me karakter financiar të sipërcituara që ligji në fuqi parashikon për ata persona që gëzojnë këtë status të posaçëm, kuadri normativ sanksionon edhe të drejta juridike të lidhura me këtë marrëdhënie punësimi të natyrës administrative. Konkretisht, nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, kanë të drejtë që, brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:

a) të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;
b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil.

Pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, njësia e burimeve njerëzore pranë institucionit vijon me regjistrimin në HRMIS të nëpunësve civilë në pozicionet ku janë transferuar për shkak të ristrukturimit, me strukturën e re dhe regjistrimin e vendeve vakante të krijuara për shkak të ristrukturimit.

Struktura e Administratës Tatimore Qendrore është miratuar me Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore". Në Administratën Tatimore Qendrore, brenda periudhës objekt auditimi, janë zhvilluar 3 procese ristrukturimi, konkretisht:

- **Ristrukturimi i bërë me Urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019 i Kryeministrit "Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore";**

Struktura dhe organika e re e miratuar, numëron gjithsej 1512 pozicione, nga 1569 që ishin.

Nga krahasimi i strukturës dhe organikës së vjetër me strukturën dhe organikën e re të institucionit, rezultojnë ndryshimet e mëposhtme:

- Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit nuk ekziston më në strukturën e re. Funksionet e kësaj drejtorie do tâ kalojnë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI);
- Drejtoria e Analizës dhe IT apo Sektori i Analizës dhe IT (në varësi të rajonit), ndryshon emërtesë duke përjashtuar pozicionet e funksioneve të IT;
- Me strukturën e re, Drejtoria e Analizës dhe IT apo Sektorin i Analizës dhe IT (në varësi të rajonit) riemërohen, Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave;
- Përjashtimisht, Drejtoria e Analizës dhe IT në Drejtorinë Rajonale Tatimore në tiranë riemërohet Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave dhe Sektori i Kontabilitetit të të Ardhurave;
- Në strukturën dhe organikën e re të institucionit nuk parashikohet asnjë pozicion i dedikuar për teknologjinë e informacionit. Në zbatim të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, ñPër riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, funksionet e menaxhimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit do të kryhen nga njësitë organizative në përbërje të AKSHI-t.

Institucioni	Ishte (UKM nr. 126, datë 02.08.2016)	Bëhet (UKM nr. 49, datë 27.02.2019)	Lëvizja në nr. pozicionesh në strukturë

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	279	254	-25
Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	120	117	-3
Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	367	362	-5
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier	150	147	-3
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	130	127	-3
Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	107	104	-3
Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë	52	50	-3
Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër	38	36	-2
Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë	36	34	-2
Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës	34	33	-1
Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër	34	33	-1
Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë	44	43	-1
Drejtoria Rajonale Tatimore Berat	41	40	-1
Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë	68	66	-2
Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	69	66	-2
TOTALI	**1569**	**1512**	**-57**

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Me shkresën nr. 4535/1 prot., datë 4.3.2019 me lëndë ñKërkesë për krijimin e Komisionit të Ristrukturimitò të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, z. Xhavit Çurri, zv. Drejtor i Përgjithshëm, kërkon nga Departamenti i Administratës Publike krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, në zbatim të Urdhrit nr. 49, datë 27.02.2019 të Kryeministrit.

Me shkresën nr. 1412/2 prot., datë 11.03.2019 me lëndë ñKthim përgjigjeò drejtuar DPT, për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zj. Albana Koçiu, Drejtor i DAP, i dërgon Urdhrin nr. 20, datë 11.3.2019 ñPër krijimin e komisionit të ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendroreò. Në këtë urdhër, është përcaktuar Komisioni i Ristrukturimit, me përbërje, si më poshtë:

1. Z. E. K. ï Kryetar, Specialist në Sektorin e Inspektimit, në Drejtorinë e Politikave të Rritjes Profesionale, Integritetit dhe Inspektimit, në Departamentin e Administratës Publike;
2. Zj. G. P. ï Anëtar, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
3. Z. Xh. Ç. ï Anëtar, Zv. Drejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve.

Referuar Urdhrit nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, në rastet e ristrukturimit të institucioneve qendrore në varësi të Kryeministrit apo ministrave të linjës, Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga:

- Nëpunësi më i lartë civil i institucionit mëmë nga varet institucioni që po ristrukturohet;
- Nëpunësi më i lartë civil i institucionit që po ristrukturohet;
- Një përfaqësues nga DAP.

Zgjedhja e z. Xh. Ç., me pozicion zv. Drejtor i Përgjithshëm i Hartimit të Programeve, duke mos qenë nëpunësi më i lartë civil i institucionit që po ristrukturohet, është në kundërshtim me Urdhrin. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Departamenti i Administratës Publike, nuk rezulton asnjë argumentim pse në komision nuk është caktuar Drejtori i Përgjithshëm i DPT, si nëpunësi më i lartë civil i institucionit që po ristrukturohet.

Me observacionin nr. 297/5 prot, datë 26.04.2021, sqarohet se në momentin e krijimit të Komisionit të Ristrukturimit, z.Xh. Ç., zv. Drejtor i Përgjithshëm, është caktuar në mungesë dhe me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm.

Komisioni i Ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore, me Vendimin nr. 7525 prot., datë 09.04.2019, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit, vendos tôi propozojë DAP-it, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, transferimin e përhershëm të 41 nëpunësve civilë, brenda administratës tatimore, në pozicione vakante.

Në propozimin e KR, përveç ri pozicionimit direkt të nëpunësve civilë në pozicione pune sipas strukturës së re, të cilët kanë të njëjtin përshkrim pune të njëjtë ose të ngjashëm me atë ku janë aktualisht nëpunësit, ose lëvizjeve në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, për transferimin e nëpunësve në strukturat e AKSHI-t, vihen re disa transferime ku ka ndryshime në pozicion, drejtori/ sektorë ose nivel page, si më poshtë:

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli pagës
1.	AV	Specialist	Sektori i Analizës, IT, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës, Drejtoria e Analizës dhe IT, DRT Tiranë	IV-b	Insp.II	Sektori i Analizës dhe Statistikës, Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit, DRT Tiranë	IV-a

2.	RJ	Insp.II	Sektori i Kontabilitetit të të Ardhurave, Drejtoria e Analizës dhe IT, DRT Tiranë	IV-a	Specialist	Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	IV-a
3.	ES	Specialist	Sektori i IT, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës, Drejtoria e Analizës dhe IT, DRT Fier	IV-b	Insp.II	Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria e Mbledhjes me Forcë, DRT Fier	IV-a
4.	AF	Specialist	Zyra e IT, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës, Sektori i Analizës dhe IT, DRT Elbasan	IV-b	Insp.II	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, DRT Elbasan	IV-a
5.	ATH	Specialist	Zyra e IT, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës, Sektori i Analizës dhe IT, DRT Sarandë	IV-b	Insp.II	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, DRT Sarandë	IV-a
6.	RM	Specialist	Zyra e IT, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës, Sektori i Analizës dhe IT, DRT Korçë	IV-b	Insp.II	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, DRT Korçë	IV-a

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga grupi i auditimit janë konstatuar transferime të nëpunësve civilë duke pësuar ndryshime në sektorë/ drejtori, pozicion pune e nivel page. Ka patur transferime të punonjësve nga sektori/ zyra e IT në sektorë të tjerë, duke kaluar nga pozicioni i punës specialist, në Inspektorë të dytë, çka ka rezultuar në rritje në nivel page dhe qëndrim brenda shërbimit civil, ndërkohë që për 43 nëpunës nga i njëjti sektor/ zyrë, pjesë e Administratës Tatimore, shkrirja e sektorit të IT bëri që të transferohen pranë AKSHI-t, duke përfunduar marrëdhëniet e punës në shërbim civil. Në Vendim nuk ka asnjë praktikë bashkëlidhur, për të dokumentuar ku u bazua Komisioni për të përzgjedhur nëpunësit që do të transferoheshin në vakanca brenda institucionit, në vend të nëpunësve të tjerë nga i njëjti sektor/ zyrë.

Në Vendim, thuhet se Komisioni i Ristrukturimit e mori vendimin pasi mori në shqyrtim përshkrimet e punës dhe kriteret e veçanta të stafit aktual, si dhe përshkrimet e punës dhe kriteret e veçanta për pozicionet e ristrukturuara.

Me shkresën nr. 2099/1 prot., datë 15.04.2019, Drejtori i DAP i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Vendimin mbi transferimin e përhershëm të nëpunësve.

Me shkresën nr. 1726 prot., datë 21.03.2019, Drejtor i DAP, njofton AKSHI-n për nëpunësit që kanë ushtruar detyrat e tyre në njësinë e menaxhimit TIK në Administratën Tatimore Qendrore (22 nëpunës), dhe i kërkon fillimin e procedurave për vijimin e marrëdhënies së punës pranë AKSHI-t.

Me shkresën nr. 1774 prot., datë 25.03.2019, Drejtori i DAP, njofton AKSHI-n për nëpunësit që kanë ushtruar detyrat e tyre në njësinë e menaxhimit TIK në Drejtoritë Rajonale Tatimore (21 nëpunës), dhe i kërkon fillimin e procedurave për vijimin e marrëdhënies së punës pranë AKSHI-t.

Në Vendimet individuale të KR për përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil, Komisioni shprehet se: ñ*Në strukturën dhe organikën e re të Administratës Tatimore Qendrore nuk parashikohet asnjë pozicion i dedikuar për teknologjinë e informacionit*ò.

Për këto Vendime të marra nga ana e KR, ka patur 4 ankime nga nëpunës, të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil, si dhe ka 2 procese gjyqësore.

Sa më sipër:
Referuar Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil":
Sipas nenit 50, pika 1,
ñ*Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori*ò.

Në transferimet e propozuara dhe të miratuara janë konstatuar transferime të nëpunësve nëpër sektorë e drejtori të tjera, edhe në rastet kur pozicioni i tyre i mëparshëm vazhdonte normalisht.

Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, indryshuar:
Sipas pikës 4, ñ*Komisioni i Ristrukturimit ka për detyrë:*

a) *Të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese;*
b) *T'i propozojë njësisë përgjegjëse (DAP) transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike...;*
c) *Të vlerësojë dhe të marrë vendim për rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil...".*

Komisioni nuk paraqet një relacion, ku të evidentohen vakancat ekzistuese në institucionin DPT, apo nuk ka gjurmë të ketë kërkuar nga DAP informacion mbi vakanca të mundshme, me qëllimin kryesor sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese.

Sipas pikës 6, ñ*Nëpunësi më i lartë civil i institucionit ka për detyrë t'i paraqesë Komisionit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për çdo nëpunës që i nënshtrohet procesit të transferimit, që përfshin:*

a) *Përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuara, si dhe ndryshimin e kritereve specifike...*;

Në Vendimin (propozimin) e KR për transferimin e nëpunësve ose Vendimet individuale për përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil, Komisioni shprehet se: ñ*Në strukturën dhe organikën e re të Administratës Tatimore Qendrore nuk parashikohet asnjë pozicion i dedikuar për teknologjinë e informacionit.*ò Në vendim nuk përmenden përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuara ose kriteret specifike. KR niset nga emërtimi i drejtorisë/ sektorit, për të thënë se, pas ristrukturimit, nuk parashikohet asnjë pozicion i dedikuar për teknologjinë e informacionit, edhe pse mes personave të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil me këtë arsyetim, kishte dhe ekonomistë e inxhinierë (referuar ankesave të vëna në dispozicion. Drejtoria e Analizës dhe IT apo Sektori i Analizës dhe IT (në varësi të rajonit), që pas ristrukturimit u riemërua Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, kishte në përbërje të saj jo vetëm nëpunës të specializuar në teknologjinë e informacionit. Ky argumentim nga ana e KR nuk mjafton, pasi kishte 41 nëpunës nga po e njëjta Drejtori/ Sektor, për të cilët u bë i mundur transferimi, ndër të cilët 5 nëpunës nga Sektori (ose Zyra, në varësi të rajonit) i IT, Pajisjeve Fiskale dhe Statistikës, që u transferuan në sektorë të tjerë, duke ndërruar pozicion nga Specialist, në Inspektor dhe duke u rritur në nivel page, në këtë mënyrë duke ruajtur marrëdhënien e punës në shërbim civil.

Sipas pikës 8,
ñ*Hapi 2*
Verifikimi i përshkrimeve të punës për të:

- *Evidentuar kriteret e veçanta për secilin pozicion;*
- *Përgatitur listat me grupet e veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në kriteret e veçanta.*ò

Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion vërtetues për verifikimin e përshkrimeve të punës, si kritere të veçanta të evidentuara dhe lista me grupe të veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në këto kritere.

ñ*Hapi 4*
Krahasimi dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur në hapat e mësipërm (informacionit për nëpunësit civilë dhe informacionit për pozicionet e punës) për të vendosur mbi:

- *Transferimin e përhershëm (sistemim në strukturën e re);*
- *Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit/ mbylljes së institucionit.*ò

Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion vërtetues për kryerjen e këtij krahasimi dhe vlerësimi të informacionit, që ka sjellë në vendimet mbi transferimin ose përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve.

Sipas pikës 10, ñ*Komisioni merr vendim për transferimin e nëpunësve apo përfundimin e marrëdhënies së tyre në shërbimin civil, bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit...*ò

Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion vërtetues që vendimet e marra janë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, sipas parashikimit të Udhëzimit.

Sipas pikës 17, ñ*Komisioni i Ristrukturimit duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi*ò.
Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion vetëm Vendimi për secilin nëpunës. Vendimi nuk ka bashkëlidhur praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Akt-Konstatimit, mbi procesin e Ristrukturimit të mësipërm, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 297/5 prot., datë 26.04.2021, nga z. E. K., përfaqësuesi i DAP në KR, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- *Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë, në pozicionet e reja të krijuara, sipas strukturës së re të institucionit, të cilat kanë përshkrim pune të njëjtë ose të ngjashëm me atë të pozicioneve të mëparshme, ku plotësojnë kriteret e veçanta të arsimit dhe përvojës dhe janë brenda së njëjtës kategori, me përjashtim të nëpunësve të njësive, ku në përbërje kryejnë edhe funksione të teknologjisë së informacionit e të komunikimit (NJTIK).*
- *Kategoria e pagës "ekzekutive", përfshin nivelet e pagës III-b, IV-a, IV-b, IV-c.*
- *Sistemimi i 5 nëpunësve nga NJTIK, në pozicionet e reja të krijuara është bërë pasi plotësonin kriteret e veçanta, të përcaktuara në përshkrimin e punës.*
- *Sqarim mbi proceset gjyqësore.*

Qendrimi i grupit të auditimit:

- *Grupi i auditimit është shprehur se pas kërkesës së dokumentacionit, nuk i është vënë në dispozicion dokumentacion vërtetues për kryerjen e një studimi paraprak të vakancave, përshkrimeve të punës. Observacioni nuk sjell asnjë dokumentacion të ri që të ndryshojë qendrimin e grupit të auditimit.*
- *Nuk është e qartë pse në observacion shpjegohet nocioni i "kategorisë së pagës", pasi grupi i auditimit vazhdimisht i është referuar si "niveli i pagës", edhe nëpër tabela. Kjo, në asnjë rast, nuk është cituar te shkeljet e sipërpërmendura, por për të konstatuar që, në disa raste, KR ka propozuar transferimet e nëpunësve nga NJTIK në Sektorë/ Drejtori të tjera, duke ndryshuar pozicion e nivel page.*
- *Të gjitha sa janë cituar në observacion janë trajtuar nga grupi i auditimit. Procesi, për t'u quajtur i rregullt, duhet të jetë i dokumentuar. Observacioni nuk sjell asnjë dokumentacion të ri që të ndryshojë qëndrimin e grupit të auditimit.*
- *Nuk është e qartë pse në observacion jepen sqarime mbi proceset gjyqësore. Grupi i auditimit i ka cituar stilistikisht proceset gjyqësore dhe nuk ka mbajtur qëndrim për sa i përket atyre.*

- **Ristrukturimi i bërë me Urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit "Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", të ndryshuar";**

Struktura dhe organika e re e miratuar, numëron gjithsëj 1512 pozicione pune, numër i njëjtë ky me pozicionet e strukturës së mëparshme. Pavarësisht ruajtjes së numrit të pozicioneve vërehen ndryshime në emërtesa dhe riorganizime të drejtorive dhe sektorëve.
Ndryshimet në numër pozicionesh në strukturën e re ishin, si më poshtë:

Institucioni	Ishte (UKM nr. 49, datë 27.02.2019)	Bëhet (UKM nr. 86, datë 03.05.2019)	Lëvizja në nr. pozicionesh në strukturë
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	254	249	-5
Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	117	127	+10
Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	362	359	-3
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier	147	146	-1
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	127	126	-1
Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	104	104	-
Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë	50	50	-
Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër	36	36	-
Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë	34	34	-

Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës	33	33	-
Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër	33	33	-
Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë	43	43	-
Drejtoria Rajonale Tatimore Berat	40	40	-
Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë	66	66	-
Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	66	66	-
TOTALI	**1512**	**1512**	**-**

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Me shkresën nr. 9243 prot., datë 07.05.2019, z. E. D., Drejtor i Përgjithshëm i DPT, i kërkon DAP-it nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit për vijimin e procedurave ligjore.

Me Urdhrin nr. 32, datë 10.05.2019, nr. 2585/1 prot., datë 10.05.2019, zj. A. K. krijon Komisionin e Ristrukturimit, me përbërje si më poshtë:

- A. N. ï Kryetar, specialist në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil;
- A. K. ï Anëtar, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- E. D. ï Anëtar, Drejtor i Përgjithshëm i DPT.

Me Vendimin nr. 11348 prot., datë 06.06.2019, KR i propozon DAP-it transferimin e 150 nëpunësve, pas ndryshimeve të ardhura si pasojë e ristrukturimit.

Përveç transferimeve të nëpunësve vetëm prej ndryshimeve në emërtesa dhe riorganizime të drejtorive dhe sektorëve, vihen re disa lëvizje që kanë rezultuar në ndryshim të pozicioneve, drejtorive/ sektorëve ose nivelit të pagës për disa nëpunës, si më poshtë:

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	EP	Përgjegjës sektori	Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, DPT	III-a/1	Përgjegjës sektori	Sektori i Çështjeve Jotatimore, Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT	III-a/1
2.	LL	Insp.I	Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, DPT	III-b	Insp.I	Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	III-b
3.	AN	Drejtor	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse, DTM	III-a/1	Drejtor	Drejtoria e Rimbursimit të TVSH, DPT	III-a
4.	IV	Insp.II	Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.II	Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DPT	IV-a
5.	RM	Insp.II	Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.II	Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DPT	IV-a
6.	PE	Përgjegjës sektori	Sektori i Asistencës dhe Shërbimit, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	III-b	Përgjegjës sektori	Sektori i Regjistrimit, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	III-b
7.	IL	Përgjegjës sektori	Sektori i Regjistrimit, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	III-b	Përgjegjës sektori	Sektori i Asistencës dhe Shërbimit, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	III-b
8.	MT	Specialist	Zyra e Financës, Sektori i Funksioneve Mbështetëse, DRT Kukës	IV-b	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, DRT Kukës	IV-a
9.	ASH	Insp.II	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, DTM	IV-a	Insp.I	Sektori i Analizës së Riskut, DTM	III-b
10.	AK	Insp.II	Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Sektori i Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	III-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në propozimin që KR i dërgon DAP, citohet: ñ*KR, pasi u njoh dhe vlerësoi nevojat institucionalë për përmbushjen e objektivave, planeve vjetorë të drejtorive përkatëse, realizimit të volumit të punës, riorganizimet e strukturës dhe organigramës sipas shpjegimeve më lart, etj., ka transferuar nëpunësit E.P, L.L, A.N, I.V, R.M, P.E, I.L dhe M.T nga pozicionet aktuale në pozicione të tjera ku plotësojnë kriteret dhe kanë të gjitha formimet, kualifikimet dhe përvojën për*

*të realizuar detyrat dhe dhënë kontributin e tyre në zbatim të funksioneve dhe detyrave të këtyre pozicioneve. Po ashtu janë transferuar në pozicione të ndryshëm nga aktualët nëpunësit ASH dhe AK në kuadër të rishpërndarjes së nevojave institucionale duke zbatuar metodologjinë e pikëzimit*ò.

Me shkresën nr. 11348/1 prot., datë 08.07.2019, KR ka sjellë shkresën me lëndë ñKorrigjim i gabimeve materiale në propozimin e KR nr. 11348 prot., datë 06.06.2019ò, ku vendos korrigjimin e gabimit material me përmbajtjen si vijon: ñTransferimi i përhershëm i AN nga pozicioni Drejtor Drejtorie, në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeveò, siç citohet në shkresë ñ*për shkak të pasaktësisë së konstatuar në propozim*ò. Bashkëlidhur nuk ka asnjë praktikë shoqëruese, ku KR është bazuar për të marrë Vendimin e sipërcituar.

Me shkresën nr. 3726/1 prot., datë 10.07.2019, zj. Albana Koçiu, Drejtor i DAP i përcjell Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Vendimin mbi transferimin e 149 nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore.

Me datë 10.07.2019, nëpunësve u dërgohen aktet individuale të transferimit (149 akte).

Me Urdhrin nr. 62, datë 30.08.2019 ñPër një ndryshim në Urdhrin nr. 32, datë 10.05.2019 ñPër krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Qendroreò, Drejtori i DAP urdhëron ndryshimin e Komisionit të Ristrukturimit, si më poshtë:

- Zj. D. I., anëtar, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve zëvendëson z. E. D., anëtar.

MP, me shkresën nr. 14548/214 prot., datë 14.08.2019, drejtuar DPT dhe DAP, me lëndë ñShprehje mendimiò, deklaron se refuzon transferimin, për shkak se vendbanimi është në Gjirokastër dhe, pas ristrukturimit, është transferuar në Tiranë, që është më shumë se 45km larg, bashkëlidhur një vërtetim banimi me nr. 6/1 prot., datë 06.08.2019.

AB, me shkresën nr. 14548/205 prot., datë 08.08.2019, pretendon se struktura e pozicionit që ka mbajtur nuk ka ndryshuar, dhe KR duke patar parasysh përvojën e punës dhe plotësimin e kritereve propozon korrigjimin e aktit dhe transferimin në pozicionin që ka mbajtur, duke reflektuar vetëm ndryshimet e emërtesës.

Me shkresën nr. 17024 prot., datë 12.09.2019, KR i dërgon DAP-it propozimin për anulimin e aktit të MP dhe korrigjimin e aktit të AB.

Me shkresën nr. 16286/2 prot., datë 19.09.2019, KR i dërgon DAP-it propozimin për anulimin e aktit të transferimit të EP, LL, IV, RM, PE, IL, MT, AK, FP, DB.

KR konstaton se nuk është përmbushur kushti i pikës 1 i Udhëzimit, përsa i takon ndryshimeve thelbësore të pozicioneve që kanë mbajtur nëpunësit më lart. Sa i përket FP dhe DB, Komisioni konstaton nevojën institucionale tâ transferojë si Inspektorë të parë, në Sektorin e Kontrollit Tatimor, Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë, në përputhje me plotësimin e kritereve sipas përshkrimeve të punës.

Në këtë shkresë, Komisioni i Ristrukturimit i referohet vetes si ñKomisioni i Ri i Ristrukturimit, i ngritur me Urdhrin nr. 62, datë 30.08.2019ò. Urdhri në fjalë, ishte ndryshim i Urdhrit nr. 32, datë 10.05.2019 dhe ndryshoi vetëm njërin prej anëtarëve, Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve. Sipas Udhëzimit nr.1 të Departamentit të Administratës Publike, datë 01.03.2016 ñPër krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimitò, Komisioni i Ristrukturimit krijohet me hyrjen në fuqi të fuqi të Aktit që ka miratuar mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, në këtë rast Urdhri nr. 86, datë 03.05.2019 i Kryeministrit.

Në datën 20.09.2019, Drejtori i DAP miraton transferimin e MP dhe AB, pas propozimit të KR nr. 17024 prot., datë 12.09.2019.

Në datën 23.09.2019, Drejtori i DAP miraton transferimin e AK, MT, IL, PE, RM, IV, LL, EP, pas propozimit të KR nr. 16286/2 prot., datë 19.09.2019.

Në datën 30.10.2019, Drejtori i DAP miraton transferimin e FP dhe DB, pas propozimit të KR nr. 16286/2 prot., datë 19.09.2019.

Sa më sipër:

Referuar Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”:

Sipas nenit 50, pika 1,
ñ*Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori*ò.
Në transferimet e propozuara dhe të miratuara janë konstatuar transferime të nëpunësve nëpër sektorë e drejtori të tjera, edhe në rastet kur pozicioni i tyre i mëparshëm vazhdonte normalisht.
Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, indryshuar:
Sipas pikës 8,
ñ*Hapi 2*
Verifikimi i përshkrimeve të punës për të:

- *Evidentuar kriteret e veçanta për secilin pozicion;*
- *Përgatitur listat me grupet e veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në kriteret e veçanta.*ò

Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion vërtetues që Komisioni i Ristrukturimit ka kryer verifikimin e përshkrimeve të punës, si kritere të veçanta të evidentuara dhe lista me grupe të veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në këto kritere.
Sipas pikës 10, ñ*Komisioni merr vendim për transferimin e nëpunësve apo përfundimin e marrëdhënies së tyre në shërbimin civil, bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit*...ò
Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion vërtetues që vendimet e marra janë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, sipas parashikimit të Udhëzimit.
Sipas pikës 17, ñ*Komisioni i Ristrukturimit duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi*ò.
Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion vetëm Vendimi për secilin nëpunës. Vendimi nuk ka bashkëlidhur praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi.

Sa i përket afateve të procesit të ristrukturimit, sipas parashikimit në Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, ky proces ka përfunduar në datën 30.10.2019, pra më shumë se 5 muaj pas hyrjes në fuqi të aktit.
Gjatë kësaj periudhe, Komisioni i Ristrukturimit, ka dalë me 4 Vendime drejtuar DAP, duke kundërshtuar veten në disa raste, si më poshtë:

1. Vendimi nr. 11348 prot., datë 06.06.2019;
2. Shkresa nr. 11348/1 prot., datë 08.07.2019, ñKorrigjim i gabimeve materiale në propozimin e KR nr. 11348 prot., datë 06.06.2019ò;

Komisioni i Ristrukturimit, në shkresën e mësipërme, propozon korrigjimin e gabimit material, sa i përket transferimit të një nëpunësi, duke u shprehur se kjo ka ardhur ñ*për shkak të pasaktësisë së konstatuar në propozim*ò. Nuk thuhet se për çfarë pasaktësie bëhet fjalë, apo çfarë gabimi material është konkretisht. Sikurse dhe në Vendimin nr. 11348 prot., datë 06.06.2019, as kjo shkresë nuk ka asnjë argumentim ose praktikë bashkëlidhur.

3. Shkresa nr. 17024 prot., datë 12.09.2019, ñPropozimin për anulim të aktit të MP dhe korrigjimin e aktit të AB dhe nxjerrjen e akteve të reja, në kuadër të ristrukturimitò;

Komisioni i Ristrukturimit, me Vendimin nr. 11348 prot., datë 06.06.2019, e ka transferuar AB, pavarësisht se struktura e pozicionit që ka mbajtur në strukturën e mëparshme nuk ka ndryshuar dhe pozicioni i mëparshëm i nëpunësit ka ndryshuar vetëm emërtesën. Pas kërkesës së nëpunësit, KR propozon ta rikthejë në pozicionin e mëparshëm.

4. Shkresa nr. 16286/2 prot., datë 19.09.2019, ñPropozim për anulim të aktit të EP, LL, IV, RM, PE, IL, MT, AK, FP, DBò.

Në këtë shkresë, KR konstaton se në Vendimin nr. 11348 prot., datë 06.06.2019, vetë KR nuk ka përmbushur kushtin e pikës 1 të Udhëzimit nr. 1, date 01.03.2016, për sa i takon ndryshimeve thelbësore të pozicioneve që kanë mbajtur nëpunësit e sipërpërmendur. Ndërkohë, pika 1 e Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, citon: ñ*Jo më vonë se dy ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, nëpunësi më i lartë civil në institucionin në të cilin është/janë nëpunësi/t i/të emëruar në pritje për transferim, i kërkon njësisë përgjegjëse*

*(DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit*ò. Nuk është e qartë pse është referuar kjo pikë e Udhëzimit për të argumentuar anulimin e akteve.
Gjithashtu, janë transferuar dy nëpunës, për nevoja të punës, siç shprehet KR ñ*me qëllim përmbushjen e objektivave të njësisë, nëpërmjet sigurimit të burimeve njerëzore të nevojshme*ò.
KR e mbyll këtë shkresë duke thënë se ñPasi mori në shqyrtim të gjitha ndryshimet e strukturës dhe organigramës (duke iu referuar Vendimit nr. 11348 prot., datë 06.06.2019), KR konstaton zbatim të ligjshmërisë në kryerjen e transferimeve për shkak të ristrukturimit për pjesën tjetër të nëpunësve civilëò. Komisioni i Ristrukturimit lë të kuptohet që ka bërë një kontroll të zbatimit të ligjshmërisë të transferimeve sipas Vendimit të Drejtorit të DAP, edhe pse kjo nuk është kompetencë e KR me asnjë bazë ligjore.
DAP nuk ka kryer siç duhet rolin e saj në procesin e ristrukturimit, duke mos argumentuar Vendimet, shpeshherë duke i anuluar ato, në mungesë transparence e llogaridhënie, pa u bazuar në kriter dhe në shkelje të afateve të parashikuara.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Akt-Konstatimit, mbi procesin e Ristrukturimit të mësipërm, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 298/6 prot., datë 30.04.2021, nga zj. A. N., përfaqësuesi i DAP në KR, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- *Sa i përket afatit, duke qenë se në Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" nuk parashikohet afat për mbylljen e procesit, për pasojë zbatohet neni 91, pika 2 i K.Pr.A, i cili parashikon se "Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afat për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.";*
- *Përsa i përket vënies në dispozicion të dokumentacionit shoqërues pjesë e vendimmarrjes së KR, sqarojmë se ai ruhet në respektim të parashikimeve të nenit 20 të Norma teknико-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, ku parashikohet se dokumentet me karakter të thjeshtë, të cilat nuk evidencohen dhe nuk dorëzohen në sekretari ruhen në sektorët përkatës derisa kanë vlerë operative, pra këto dokumente shoqëruese humbasin vlerën operative të ruajtjes.*
- *Komisioni i Ristrukturimit ka përdorur Metodologjinë e Pikëzimit në një rast që përmendet në observacionin e ardhur. Për këto të dhëna, KR është konsultuar me sistemin HRMIS, i cili ruan të gjithë informacionin në lidhje me arsimin dhe përvojën e punës së nëpunësve civilë të DPT. Duke qenë një regjistër të dhënash i digjitalizuar, atëherë përbën praktikën mbi të cilën është marrë vendimi.*
- *Arsyetim mbi shqyrtimin e ankesave, korrigjimin e gabimeve materiale dhe anulimin e akteve të nëpunësve, gjendja shëndetësore dhe largësia mbi 45 km nga vendbanimi.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

- *Afatet e Kodit të Procedurës Administrative, të cituara në observacion, janë afate të përgjithshme, në mungesë të afateve të përcaktuara për një procedure të caktuar. Qëllimi i akteve nënligjore është specifikimi/ detajimi i procedurave konkrete. Ne i referohemi Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, në kushtet kur, vetë institucioni juaj, ka hartuar një akt nënligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon procesin e ristrukturimit, ndër të tjera duke përcaktuar afate specifike për çdo fazë të procesit. Pavarësisht sa më sipër, vlen për t'u përmendur fakti se, afatet janë tejkaluar, jo vetëm referuar Udhëzimit që rregullon procesin e Ristrukturimit, por edhe referuar nenit 91 të K.Pr.A, të përmendur në observacion.*
- *Siç është cituar edhe në Akt-Konstatim, në 2 prej Vendimeve të KR të vitit 2020, (përkatësisht Vendimi nr. 10945/4 prot., datë 25.09.2020 dhe Vendimi nr. 10945/5 prot., datë 16.12.2020) gjendet bashkëlidhur një relacion i KR me arsyetimin e secilit prej transferimeve të dala nga këto Vendime. Në relacion përshkruhet procesi, gjenden përshkrimet e punës së pozicioneve ku do të transferoheshin nëpunësit, janë të specifikuara kriteret e veçanta të arsimit dhe përvojës, si dhe në disa raste është përdorur dhe dokumentuar procesi i pikëzimit. Këto dy Vendime, të dokumentuara në mënyrë të rregullt, kanë anuluar një numër aktesh transferimi të dala nga po*

i njëjti Komision Ristrukturimi, në të cilin përfaqësuesi i DAP nuk ndryshon. Sa i përket humbjes së vlerës operative të ruajtjes së këtyre dokumenteve shoqëruese, baza ligjore e cituar nuk është relevante. Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, parashikon qartë se Vendimi i transferimit të çdo nëpunësi duhet të ketë bashkëlidhur praktikën mbi bazën e së cilës është marrë ky Vendim. Observacioni nuk sjell asnjë dokumentacion të ri që të ndryshojë qëndrimin e grupit të auditimit.

- *Rastet kur Vendimet që kthejnë aktet e transferimit kanë ardhur si pasojë e ankesave për largësi mbi 45 km, ose probleme shëndetësore, sipas parashikimeve në Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, nuk janë konsideruar shkelje nga grupi i auditimit. Përkundrazi, marrja në konsideratë e tyre është detyrim i KR. Komisioni i Ristrukturimit ka detyrim të arsyetojë dhe të dokumentojë çdo Vendim transferimi që merr. Observacioni nuk merret parasysh, pasi nuk sjell asnjë dokumentacion të ri që të ndryshojë qëndrimin e grupit të auditimit.*

- **Ristrukturimi i bërë me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit "Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", të ndryshuar";**

Në kuadër të implementimit të Projektit të Fiskalizimit, si dhe të rekomandimeve të FMN të lëna gjatë 3 misioneve të fundit në Shqipëri dhe gjithashtu për mirëfunksionim dhe eficiencë të Administratës Tatimore Qendrore, janë konstatuar të nevojshme ndryshime strukturore, në funksion të përmirësimit funksional dhe organizativ. Në kuadër të digjitalizimit/ informatizimit të procesit të faturimit, ose siç mund ta quajmë ndryshe fiskalizimi, detyrat organizative dhe funksionale të administratës tatimore orientohen drejt kontrollit inteligjent.

Struktura dhe organika e re e miratuar numëron gjithsej 1450 pozicione, nga 1512 që ishin në strukturën e mëparshme. Ky riorganizim prek Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, si dhe 13 Drejtoritë Rajonale Tatimore (Tiranë, Fier, Shkodër, Elbasan, Durrës, Vlorë, Gjirokastër, Sarandë, Kukës, Dibër, Lezhë, Berat, Korçë), si më poshtë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Nr.	Ishte	Bëhet
1.	Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve (1+5) në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm	Sektor i veçantë në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve (ndryshon përshkrimi i punës)
2.	Drejtoria e Menaxhimit të Riskut, 15 nëpunës	19 nëpunës, Drejtor Drejtorie (1), Sektori i Analizës së Riskut (1+10), Sektori i Hartimit të Strategjive të Trajtimit të Risqeve (1+6)
3.	Qendra e Thirrjeve (1+2+14) në varësi të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Funksioneve Operacionale	Sektori i Thirrjeve (call center) në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve në DPT (1 përgjegjës + 14 specialistë) në varësi të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Hartimit të Programeve
4.	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (1+2+4)	(1+4+20)
5.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore (1+2+5)	(1+2+8) Sektori i Rekrutimit dhe Promovimit (+2), Sektori i Trajnimit dhe Vlerësimit (+1)
6.	Drejtoria e Administratës dhe Prokurimeve (1+2+4+18)	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (1+3+31), Sektori i Shërbimeve të Brendshme (1+2+22), Sektori i Prokurimeve (1+2)
7.	Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Kordinimit Ndërinstitucional (1+2+10), Sektori i Kordinimit të Projekteve (1+3), Sektori i Marrëveshjeve për Eleminimin e Taksimit të Dyfishtë (1+7)	Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Menaxhimit të Projekteve, Sektori i Menaxhimit të Projekteve dhe Implementimit (1+4) dhe Sektori për Marrëdhëniet me Jashtë (1+2) SMETD kalon në përbërje të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike si funksion
8.	Drejtoria Teknike dhe Ligjore (1+3+15)	(1+3+19) Sektori i Çështjeve Ligjore (1+5), Sektori i TVSH dhe Taksave të tjera (1+7) dhe Sektori i Taksave Direkte (1+7)
9.	Qendra e Pagesës (1+8) suprimohet dhe kalon në varësi të Drejtorisë së Analizës dhe Kontabilitetit, e cila ndryshon emërtim. Sektori i Statistikës dhe Analizës (1+2), Sektori i Kontabilitetit (1+3) Në shtyllën Mbështetja e Programeve.	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, Sektori i Statistikës dhe Analizës (1+4), Sektori i Kontabilitetit dhe Pagesës (1+7) Në shtyllën Hartimi i Programeve.
10.		Drejtoria e Rimbursimit të TVSH në shtyllën Mbështetja e Programeve
11.	Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në varësi të Zv. Drejtorit të Mbështetjes së Programeve (1+5)

12.	Drejtoria e Kontrollit Tatimor (1), Sektori i Kontrollit Tatimor (1+10) dhe Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit (1+2)	Sektori i Kontrollit Tatimor, Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit, Sektori i Cilësisë dhe Standardizimit të Procedurave
13.		Drejtoria për Proceset e Biznesit në varësi të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm Sektori i Analizës dhe Implementimit të Proceseve të Biznesit (1+4), Sektori i Shkëmbimit të Informacionit (1+6)
14.		Sektor Komunikimi (1+2) në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm
15.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore	Sektori i Monitorimit dhe Analizës (1+3) Sektori i Monitorimit të Zbatimit të Masave Shtrënguese (1+3) Sektori i Përcaktimit të Standardeve për Procedurat Ligjore të Mbledhjes me Forcë (1+2)
16.	Drejtoria e Auditit të Brendshëm	Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurimit të Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit (1+2) Sektori i Auditimit Financiar dhe të Ardhurave (1+4)
17.		Drejtoria e Kontrollit të Autorizuar (1+9)
18.	Drejtoria e Investigimit të Brendshëm	Drejtoria e Investigimit të Brendshëm (Antikorrupsion)

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

2. Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtoria e Kontrollit Tatimor (1+6+71) Sektori i Kontrollit në Vend sipas drejtorive (4+56) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+10) Sektori i Transferimit të Çmimit (1+4)
2.		Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në DTM (1+3+11) Sektori i Monitorimit (1+2) Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese (1+3) Sektori i Procedurave Ligjore të mbledhjes me forcë (1+2)
3.	Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	Drejtoria e Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave Sektori i Analizës së Riskut (1+4)
4.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

3. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		DRT Tiranë ndahet në 2 drejtori kontrolli: Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+42) Sektori i Kontrollit Tatimor në Vend (1+19) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+23)
2.	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (1+2+36)	Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve (1+2+32)
3.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Qendror Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese (1+22) Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese (1+24) Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë (1+31)
4.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
5.	Sektori i Analizës	Sektori i Statistikës dhe Analizës

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

4. Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+42) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+19) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+23)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Qendror Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

5. Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

Nr.	Ishte	Bëhet

1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+29) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+12) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+17)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Verior Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese (1+6) Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese (1+3) Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë (1+2)
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
4.	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (1+2+12)	(1+2+9)

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

6. Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+27) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+12) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+15)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Qendror Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

7. Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+16) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+7) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+9)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Jugor Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

8. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+8) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+3) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+5)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Jugor Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
4.	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (1+5+1)	(1+4+1)

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

9. Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+8) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+3) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+5)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Jugor Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

10. Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+6) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+3)

		Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+3)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Verior Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

11. Drejtoria Rajonale Tatimore Fier

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+40) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+18) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+22)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Jugor Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese (1+6) Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese (1+6) Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë (1+10)
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
4.	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve (1+2+12) Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve (1+10)	DSHT (1+2+8) Sektori i ASHT (1+6)

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

12. Drejtoria Tatimore Rajonale Lezhë

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+9) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+4) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+5)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Verior Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

13. Drejtoria Rajonale Tatimore Berat

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+10) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+4) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+6)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Jugor Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

14. Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë

Nr.	Ishte	Bëhet
1.		Drejtorita e Kontrollit Tatimor (1+2+26) Sektorët e Kontrollit në Vend (1+11) Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit (1+15)
2.	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Jugor Sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese Sektori i zbatimit në terren të masave shtrënguese Sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë
3.	Zyra e Administratës, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Përkatësisht, lëvizja në numër pozicionesh ishtë si më poshtë:

Institucioni	Lëvizja në nr. pozicionesh në strukturë
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	+59

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	+1
Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	-5
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier	-24
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	-27
Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	-16
Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë	-3
Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër	-6
Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë	-4
Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës	-4
Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër	-4
Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë	-6
Drejtoria Rajonale Tatimore Berat	-7
Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë	-8
Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	-8
TOTALI	**-62**

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Me shkresën nr. 3259/1 prot., datë 17.02.2020, zj. D. I., Drejtor i Përgjithshëm i DPT, i kërkon DAP-it nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe vijimin e procedurave të mëtejshme ligjore.

Me Urdhrin nr. 24, datë 24.02.2020, nr. 1133/1 prot., datë 24.02.2020, zj. A. K., Drejtor i DAP, ngre Komisionin e Ristrukturimit, të përbërë nga:

- O. M. ï Kryetar, specialist në Sektorin e Procedurave të Rekrutimit, Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, DAP;
- A. K. ï Anëtar, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- D. I. ï Anëtar, Drejtor i Përgjithshëm i DPT.

Me Urdhrin nr. 47, datë 15.06.2020, nr. 1133/3 prot., datë 15.06.2020, Drejtori i DAP, ndryshon Kryetarin e KR, si më poshtë:

- F. V. ï Kryetar, specialist në Sektorin e Sekretariatit Teknik për TND-në dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Procedurave të Rekrutimit në Shërbimin Civil, DAP.

Me Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020, Komisioni i Ristrukturimit i propozon Departamentit të Administratës Publike transferimin e nëpunësve civilë, si më poshtë:

Institucioni	**Nr. i nëpunësve për të cilët propozohet transferim në Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020**
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	74
Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj	87
Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë	183
Drejtoria Rajonale Tatimore Fier	62
Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër	46
Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës	46
Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë	22
Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër	14
Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë	14
Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës	9
Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër	9
Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë	14
Drejtoria Rajonale Tatimore Berat	15
Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë	36
Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan	32

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Përvec transferimeve të përhershme që konsistojnë në transferimin e nëpunësve në Sektorë, vetëm si pasojë e riemërimit ose riorganizimit të Sektorit/ Drejtorisë, vihen re transferime të paargumentuara në Sektorë/ Drejtori, pozicion ose nivel page të ndryshëm, si më poshtë:

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës

1.	MA	Insp.II	Sektori i Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Auditit të Brendshëm, DPT	III-b
2.	SHK	Drejtor	Qendra e Pagesave, DPT	III-a	Drejtor	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, DPT	III-a
3.	OO	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Kordinimit Ndërinstitucional	III-a/1	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DPT	III-a/1
4.	EP	Specialist	Qendra e Pagesave, DPT	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DPT	III-b
5.	BD	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DTM	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DPT	III-b
6.	BZ	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Lezhë	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DPT	III-b
7.	KD	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DPT	IV-a
8.	ID	Specialist	Qendra e Pagesave, DPT	IV-a	Specialist	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, DPT	IV-a
9.	AB	Insp.I	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DPT	III-b	Specialist	Drejtoria e Kontabilitetit dhe Statistikës, DPT	IV-a
10.	SS	Insp.I	Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPT	III-b	Specialist	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, DPT	IV-a
11.	JB	Insp.I	Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPT	III-b	Specialist	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, DPT	IV-a
12.	AH	Specialist	Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT	IV-a	Insp.I	Drejtoria Teknike dhe Ligjore, DPT	III-b
13.	AS	Specialist	Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT	IV-a	Insp.I	Drejtoria Teknike dhe Ligjore, DPT	III-b
14.	DK	Specialist	Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT	IV-a	Insp.I	Drejtoria Teknike dhe Ligjore, DPT	III-b
15.	ED	Specialist	Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT	IV-a	Insp.I	Drejtoria Teknike dhe Ligjore, DPT	III-b
16.	BT	Specialist	Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT	IV-a	Insp.I	Drejtoria Teknike dhe Ligjore, DPT	III-b
17.	AÇ	Specialist	Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Kordinimit Ndërinstitucional, DPT	IV-a	Insp.I	Drejtoria Teknike dhe Ligjore, DPT	III-b
18.	NB	Specialist	Drejtoria Ligjore dhe Teknike, DPT	IV-a	Insp.I	Drejtoria Teknike dhe Ligjore, DPT	III-b
19.	RM	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Drejtoria për Proceset e Biznesit	III-b
20.	IV	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Drejtoria për Proceset e Biznesit	III-b
21.	AN	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, DPT	III-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstaton se ka patur lëvizje nëpunësish brenda për brenda institucionit, duke ndërruar Drejtori/ Sektorë, pozicion, si dhe nivel page, sikurse ka patur nëpunës nga të njëjtat Drejtori/ Sektorë, pozicione e kategori page që kanë mbetur pa ndryshuar. Gjithashtu, vihet re se në DPT janë transferuar nëpunës nga DTM, DRT Tiranë ose DRT Lezhë, në disa raste duke u ngritur dhe në nivel page. Nëpunës të tjerë nga DRT në fjalë janë transferuar në Drejtorinë specifike në Rajonin Qendror ose Verior, pa ndryshuar nivel page. Nuk jepet asnjë shpjegim pse janë përzgjedhur këta nëpunës për këtë transferim. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	XHT	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	III-b	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DTM	III-b
2.	IL	Përgjegjës sëktori	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	III-b	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Mbledhjes së	III-b

						Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DTM	
3.	HM	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b
4.	FL	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b
5.	MM	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Durrës	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b
6.	FS	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b
7.	MXH	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b
8.	TF	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	III-b	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b
9.	AM	Përgjegjës sektori	Qendra e Thirrjeve, DPT	III-a/1	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Analizës, Riskut dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, DTM	III-b
10.	MXH	Specialist	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse, DTM	IV-b	Specialist	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, DTM	IV-a
11.	NM	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Tiranë	IV-a	Specialist	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, DTM	IV-a

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstaton se ka patur lëvizje nëpunësish brenda për brenda institucionit, duke ndërruar u rritur në nivel page. Gjithashtu, vihet re se në DTM janë transferuar nëpunës nga DPT ose DRT Tiranë, në disa raste duke ndryshuar pozicion dhe duke u ngritur në nivel page. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	ED	Përgjegjës Sektori	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	III-b	Përgjegjës Sektori	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	III-b
2.	EI	Specialist	Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Kordinimit Ndërinstitucional, DRT Tiranë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
3.	ST	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Lezhë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
4.	EGJ	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Lezhë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
5.	THLL	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Korçë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
6.	AM	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Korçë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
7.	VP	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Durrës	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
8.	GH	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Fier	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
9.	JD	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Durrës	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
10.	VH	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a
11.	EK	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Durrës	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RQ), DRT Tiranë	IV-a

12.	BLL	Insp.I	Drejtoria e Auditit të Brendshëm, DRT Tiranë	III-b	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, DRT Tiranë	III-b
13.	KK	Insp.I	Drejtoria e Auditit të Brendshëm, DRT Tiranë	III-b	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, DRT Tiranë	III-b
14.	BL	Insp.I	Drejtoria e Auditit të Brendshëm, DRT Tiranë	III-b	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, DRT Tiranë	III-b
15.	MK	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Tiranë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, DRT Tiranë	IV-a
16.	SZH	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, DRT Tiranë	III-b	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, DRT Tiranë	III-b
17.	MG	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, DRT Tiranë	III-b
18.	NQ	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, DRT Tiranë	III-b
19.	GK	Specialist	Qendra e Thirrjeve, DPT	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Vogël, DRT Tiranë	IV-a
20.	GG	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	III-b	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, DRT Tiranë	IV-a
21.	YGJ	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Tiranë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, DRT Tiranë	IV-a
22.	AL	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DTM	III-b	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, DRT Tiranë	III-b
23.	DÇ	Specialist	Qendra e Thirrjeve, DPT	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, DRT Tiranë	IV-a
24.	PK	Specialist	Qendra e Thirrjeve, DPT	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor për Biznesin e Madh, DRT Tiranë	IV-a
25.	AC	Drejtor	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	III-a/1	Drejtor	Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	III-a/1
26.	VP	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Tiranë	III-b	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	III-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në DRT Tiranë ka qendrën edhe Rajoni Qendror, i përbërë nga DRT Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë. Grupi i auditimit konstaton që në Rajonin Qendror janë transferuar edhe nga DRT Lezhë, edhe pse duhej të transferoheshin në Rajonin Verior. Konstatohet se ka transferime të nëpunësve me pozicion Specialist në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve, në Inspektor në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, Rajoni Qendror, ndërkohë që, nëpunës që ishin me pozicion Inspektor në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, transferohen në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Fier

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	AI	Specialist	Sektori i Funksioneve Mbështetëse, DRT Gjirokastër	IV-c	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
2.	RK	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Gjirokastër	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
3.	MD	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Berat	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
4.	MM	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Berat	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
5.	PZ	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Berat	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
6.	AM	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Sarandë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a

7.	FM	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Vlorë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
8.	AK	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Vlorë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
9.	AD	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Sarandë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
10.	EÇ	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Berat	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
11.	EM	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Vlorë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
12.	LXH	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Vlorë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	IV-a
13.	EM	Specialist	Sektori i Asistencës dhe Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Fier	IV-a	Insp.II	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, DRT Fier	IV-a
14.	EM	Përgjegjës sektori	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Gjirokastër	III-b	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, (RJ) DRT Fier	III-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në DRT Fier ka qendrën Rajoni Jugor, i përbërë nga DRT Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastër dhe Sarandë. Grupi i auditimit konstaton transferime me ndryshim pozicioni (nga specialist në Inspektor), si dhe ndryshim të nivelit të pagës në një rast. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	HJ	Drejtor	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Shkodër	III-a/1	Drejtor	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Shkodër	III-a/1
2.	TH	Drejtor	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Shkodër	III-a/1	Drejtor	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RV), DRT Shkodër	III-a/1
3.	EÇ	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Shkodër	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RV), DRT Shkodër	IV-a
4.	LLN	Përgjegjës sektori	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Lezhë	III-b	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RV), DRT Shkodër	III-b
5.	JK	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Lezhë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (RV), DRT Shkodër	IV-a
6.	MH	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Shkodër	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Shkodër	IV-a
7.	SS	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Shkodër	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Shkodër	IV-a
8.	NH	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Shkodër	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Shkodër	IV-a
9.	DHD (pp)	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Shkodër	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Shkodër	IV-a

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në DRT Shkodër ka qendrën Rajoni Verior, i përbërë nga DRT Shkodër, Lezhë, Kukës dhe Dibër. Grupi i auditimit konstaton transferim brenda për brenda institucionit, ku në procesin e ristrukturimit, ku HJ, drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara transferohet drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, ndërsa TH, drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, transferohet drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara (Rajoni Qendror). Konstatohen transferime në pozicione të ndryshme (nga specialist në inspektor) dhe në Drejtori brenda për brenda institucionit. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	FS	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Durrës	III-b	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve	III-b
2.	SL	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Durrës	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve	IV-a

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Konstatohen transferime brenda për brenda institucionit, nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Durrës (që me ristrukturim i kaloi Rajonit Qendror), në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve. Nëpunës të tjerë nga e njëjta drejtori, u bashkuan në Rajonin Qendror, pa ndryshuar pozicion. Përzgjedhja e nëpunësve që u transferuan të Rajoni Qendror dhe atyre që u transferuan në drejtori/ sektorë të tjerë nuk është e argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	BS	Drejtor	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Fier	III-a/1	Drejtor	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Vlorë	III-a/1
2.	FSH	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Vlorë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Vlorë	IV-a
3.	LK	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Vlorë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Vlorë	IV-a
4.	KK	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Vlorë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Vlorë	IV-a
5.	AQ	Përgjegjës sektori	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Vlorë	III-b	Përgjegjës sektori	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	III-b
6.	IR	Specialist	Sektori i Funksioneve Mbështetëse	IV-c	Specialist	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	IV-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstaton transferime brenda për brenda institucionit, duke ndryshuar drejtori/ sektor, ose pozicion. Pozicioni i specialistit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse ndryshon nivelin e pagës. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	MR	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Gjirokastër	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Gjirokastër	IV-a
2.	IB	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Gjirokastër	IV-a	Specialist	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	IV-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstaton transferim në drejtori/sektor brenda për brenda institucionit, nga Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Gjirokastër (që pas ristrukturimit u bashkua në Rajonin Jugor me qendër në DRT Fier), në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Gjirokastër. Nëpunës të tjerë nga e njëjta strukturë u transferuan në Rajonin Qendror. Përzgjedhja e nëpunësve që u transferuan në Rajonin Jugor dhe nëpunësit që u transferua në drejtori tjetër nuk është e argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	AT	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Sarandë	IV-a	Specialist	Sektori i Shërbimit të Taksapaguesve, DRT Sarandë	IV-b
2.	AT	Specialist	Sektori i Funksioneve Mbështetëse, DRT Sarandë	IV-c	Specialist	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, DRT Sarandë	IV-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstaton transferim në drejtori/sektor brenda për brenda institucionit, nga Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Sarandë (që pas ristrukturimit u bashkua në Rajonin Jugor me qendër në DRT Fier), në Sektorin e Shërbimit të Taksapaguesve (nga Inspektor në Specialist, pa ndryshim në nivelin e pagës). Nëpunës të tjerë nga e njëjta strukturë u transferuan në Rajonin Qendror. Pozicioni i specialistit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse ndryshon nivelin e pagës. Përzgjedhja e nëpunësve që u transferuan në Rajonin Jugor dhe nëpunësit që u transferua në drejtori tjetër nuk është e argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	MH	Përgjegjës sektori	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Kukës	III-b	Përgjegjës sektori	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, DRT Kukës	III-b
2.	MD	Specialist	Sektori i Funksioneve Mbështetëse, DRT Kukës	IV-c	Specialist	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, DRT Kukës	IV-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Pozicioni i specialistit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse ndryshon nivelin e pagës.

Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	AS	Specialist	Sektori i Funksioneve Mbështetëse, DRT Dibër	IV-c	Specialist	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, DRT Dibër	IV-b
2.	LD	Specialist	Sektori i Funksioneve Mbështetëse, DRT Dibër	IV-c	Specialist	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, DRT Dibër	IV-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Pozicioni i specialistit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse ndryshon nivelin e pagës.

Drejtoria Rajonale Tatimore Berat

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	GB	Specialist	Sektori i Funksioneve Mbështetëse, DRT Berat	IV-c	Specialist	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, DRT Berat	IV-b
2.	SHA	Insp.II	Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara	IV-a	Insp.II	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	IV-a

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstaton transferim në drejtori/sektor brenda për brenda institucionit, nga Sektori i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Berat (që pas ristrukturimit u bashkua në Rajonin Jugor me qendër në DRT Fier), në Sektorin e Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave, pa ndryshim në nivelin e pagës. Nëpunës të tjerë nga e njëjta strukturë u transferuan në Rajonin Qendror. Përzgjedhja e nëpunësve që u transferuan në Rajonin Jugor dhe nëpunësit që u transferua në drejtori tjetër nuk është e argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit. Pozicioni i specialistit të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse ndryshon nivelin e pagës.

Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	PB	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Korçë	III-b	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve	III-b
2.	RM	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Korçë	IV-a	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve	IV-a
3.	SB	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Korçë	IV-a	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve	IV-a
4.	IÇ	Drejtor	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Korçë	III-a/1	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Korçë	III-b
5.	OT	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Korçë	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Korçë	IV-a
6.	GK	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të	IV-a	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Korçë	IV-a

			Papaguara, DRT Korçë				

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstaton transferim në drejtori/sektor brenda për brenda institucionit, nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Korçë (që pas ristrukturimit u bashkua në Rajonin Qendror me qendër në DRT Tiranë), në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve ose Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Korçë, pa ndryshim në nivelin e pagës. Nëpunës të tjerë nga e njëjta strukturë u transferuan në Rajonin Qendror. Përzgjedhja e nëpunësve që u transferuan në Rajonin Jugor dhe nëpunësve që u transferuan në drejtori të tjera nuk është e argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan

Nr.	Nëpunësi (inicialet)	Ishte			Bëhet		
		Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës	Pozicioni	Sektori/ Drejtoria	Niveli i pagës
1.	AM	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Elbasan	IV-a	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Elbasan	IV-a
2.	LÇ	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	III-b	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Elbasan	IV-a
3.	DT	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Elbasan	III-b	Përgjegjës sektori	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	III-b
4.	RB	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	III-b
5.	SB	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	III-b
6.	AD	Insp.II	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	III-b
7.	NS	Insp.II	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Elbasan	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	III-b
8.	BV	Specialist	Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, DRT Elbasan	IV-a	Insp.I	Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan	III-b

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Grupi i auditimit konstaton ndryshim në pozicion dhe në niveli e pagës të disa nëpunësve, edhe pse janë në të njëjtën strukturë drejtori/ sektor që ishin para ristrukturimit, duke kaluar nga Inspektor i dytë në Inspektor i parë, duke u rritur në nivel page. Gjithashtu, konstatohen lëvizje në pozicion nga Specialist në Inspektor, me rritje në nivel të pagës. Konstatohet një transferim nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, DRT Elbasan (që pas ristrukturimit u bashkua në Rajonin Qendror me qendër në DRT Tiranë), në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, DRT Elbasan, me rritje në nivel page. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Me shkresën nr. 2830/1 prot., datë 15.07.2020, zj. K., Drejtor i DAP, i dërgon DPT-së Vendimin për transferimet e përhershme të nëpunësve, pas propozimit të Komisionit të Ristrukturimit.
Në vijimësi, pranë DAP janë administruar një numër prej 73 ankesash, në lidhje me aktet e transferimit, të marra në Vendimin nr. 2380/1 prot., datë 15.07.2020.
Me Urdhrin nr. 58, datë 17.08.2020, nr. 1133/5 prot., datë 17.08.2020, Drejtori i DAP, ndryshon anëtarin e KR, si më poshtë:

- O. M., Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në vend të anëtarit A. K.

Me shkresën nr. 3915 prot., datë 26.08.2020, Drejtori i DAP u drejtohet DPT dhe MFE, në lidhje me rishqyrtimin e Vendimit nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020 për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit.
Në shkresë citohet pika 18, kreu II, i Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar: ñ*Njësia përgjegjëse (DAP) brenda 10 ditëve nga data e marrjes së propozimit nga KR, pasi shqyrton aktet, merr vendimin për transferimin e nëpunësit civil ose kthimin e akteve Komisionit në rastet kur vërteton parregullsi ligjore të dukshme, të cilat kanë ndikuar në vendimmarrje*ò.
Janë konstatuar 2 transferime në kundërshtim me pikën 3 të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, pasi nuk janë marrë në konsideratë kërkesat specifike për vendin e punës, përkatësisht:

	Nëpunësi	Pozicioni përpara transferimit	Pozicioni pas transferimit	Kriteri i kërkuar	Arsimi

1.	GJ	Insp. I, Sektori i Kontr. Tatimor, Drejtoria e Kontr. Tatimor, DRT Shkodër	Insp. I, Sektori i Kontr. Nga Zyra & Monitorimit, Drejtoria e Kontr. Tatimor, DRT Shkodër	Master Profesional në Shkenca ekonomike/ juridike	Diplomë 4-vjeçare në Agronomi e Përgjithshme
2.	AK	Insp. II, Sektori i Menaxhimit dhe Analizës së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, DRT Durrës	Insp. II, Sektori i Zbatimit të Masave në Terren, Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Qendror, DRT Tiranë	Bachelor në Shkenca ekonomike/ juridike	Diplomë 4-vjeçare në Agronomi e Përgjithshme

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i auditimit

Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga ana e DAP, rezultojnë 3 procesverbale të zhvillimit të seancave dëgjimore online, në platformën ñCisco Ëebex Meetingsò, përkatësisht të datave 05.08.2020, 11.08.2020, 02.09.2020.

Me Vendimin nr. 10945/4 prot., datë 25.09.2020, KR shprehet se: ñ...*pas ankesave të nëpunësve civilë për rishikimin e Vendimit nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020, Komisioni zhvilloi seanca dëgjimore me secilin prej nëpunësve, dëgjoi arsyet e refuzimit të transferimit dhe argumentat e secilit prej tyre, mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar lidhur me procesin:*
Ankesat e nëpunësve dhe dokumentacionin shtesë të përcjellë bashkëlidhur;
Strukturën dhe organikën ekzistuese të ATQ;
Strukturën dhe organikën e re të ATQ;
Të dhënat e nëpunësve civilë, vendet e të cilëve preken nga ristrukturimi;
Dosjet personale;
Kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara si pasojë e ristrukturimit;
*Vlerësimin me pikë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit.*ò

KR vendos tëi propozojë DAP anulimin e 32 akteve të transferimit, si dhe tëi propozojë 36 akte transferimi të tjera.

Bashkëlidhur propozimit të KR, është një relacion arsyetues për Vendimin e marrë.

Nga relacioni evidentohen:

- Së pari, 7 nëpunës civilë refuzojnë transferimin për shkaqe shëndetësore. Pas zhvillimit të seancës dëgjimore dhe pas marrjes në shqyrtim të fakteve të reja, konstatohet se nëpunësit plotësojnë kushtin e parashikuar se nëpunësi mund të refuzojë transferimin kur gjendja e tij shëndetësore e bën transferimin të pamundur.
- Së dyti, 10 nëpunës civilë refuzojnë transferimet për arsye se vendbanimet e tyre janë mbi 45 km nga vendi ku transferohen. KR konstaton se përmbushet kushti i parashikuar që nëpunësi mund të refuzojë transferimin nëse vendi ku transferohet është më larg se 45 km.

Dy pikat e mësipërme, mbështeten në pikën 20 dhe 21 të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar (edhe pse jashtë afateve të përcaktuara, kjo për shkak edhe të vështirësive gjatë pandemisë), ku citohet:

ñ**Pika 20** ï *Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse (DAP) brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, vetëm në rast se:*

a) Gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;
b) Vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km larg nga vendbanimi i nëpunësit civil.

Pika 21 ï *Njësia përgjegjëse (DAP) verifikon shkaqet e refuzimit dhe mund të revokojë vendimin, nëse vërteton një prej dy rasteve të sipërcituara, duke i rikthyer aktet për rivlerësim KR-së. Komisioni, brenda 5 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve për rivlerësim, duhet t'i propozojë njësisë përgjegjëse (DAP) transferimin e ankuesit në një pozicion pune të përshtatshëm për kushtet e gjendjes shëndetësore apo të vendbanimit.*ò

- Së treti:
  - Pas ankesës së marrë nga 3 nëpunës (KK, BL, BLL) të transferuar nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm, është zhvilluar seancë dëgjimore me të gjithë (8) nëpunësit e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe u rishikua vlerësimi me pikë për bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit. Referuar sistemit të pikëzimit, anulohet akti i transferimit për 3 nëpunësit ankues, dhe transferohen nga Drejtoria 2 nëpunës të tjerë (ES, MA).
  - Pas ankesës së marrë nga 2 nëpunës (MD, PZ) të transferuar në DRT Fier (Rajoni Jugor), nga DRT Berat, ndërkohë që kolegu SHA u sistemua në pozicionin e vetëm vakant brenda DRT Berat. Pas seancës dëgjimore dhe rishikimit të vlerësimit me pikë, KR propozon

anulimin e akteve të transferimit, transferimin e MD në pozicionin vakant në DRT Berat dhe transferimin e PZ dhe SHA në pozicione të lira apo të reja të krijuara si pasojë e ristrukturimit.

Nga kjo rezulton që KR nuk e ka kryer përzgjedhjen sipas sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e nëpunësve brenda së njëjtës njësie që do të nënshtroheshin transferimit, para se të dilte në Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020 dhe Drejtori i DAP duhet të verifikonte përpara përcjelljes së Vendimin nr. 2830/1 prot., të datës 15.07.2020.

- Së katërti, në vijim të ankesave të 9 nëpunësve, KR mori në shqyrtim strukturën dhe riorganizimin strukturor, së bashku me kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara si pasojë e ristrukturimit.
- Së fundi, në vijim të shkresës nr. 3915 prot., datë 26.08.2020, të DAP, mbi rishqyrtimin e transferimit të nëpunësve AK dhe GJ, të cilët nuk përmbushin kriterin e arsimit në pozicionin e transferuar, KR vlerësoi mundësitë e transferimit të përhershëm të nëpunësve në pozicionet e lira, ku plotësojnë kriteret.

Sa i përket kësaj pike, KR ka patur detyrimin që të verifikonte këto kritere para se të dilte në Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020 dhe Drejtori i DAP duhet të verifikonte përpara përcjelljes së Vendimin nr. 2830/1 prot., të datës 15.07.2020.

Me shkresën nr. 2830/755 prot., datë 07.10.2020, Drejtori i DAP i përcjell DPT-së Vendimin për transferimin e përhershëm të 36 nëpunësve, sipas propozimit të KR.

Mbi këtë Vendim, janë administruar në DAP 3 ankesa (EM, SHA, MA). Në ankesat e sipërcituara, MA shprehet se sistemi i pikëzimit nuk është matur siç duhet, ndërsa SHA refuzon transferimin, pasi është mbi 45 km larg nga vendbanimi.

Me Vendimin nr. 10945/5 prot., datë 16.12.2020, KR propozon transferimin e përhershëm të 4 nëpunësve, bashkëlidhur me arsyetimin:

- Ri kryhet sistemi i pikëzimit në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, nga ku rezulton se nëpunësi (ankues) MA ka më shumë pikë se nëpunësi BLL, prandaj MA rikthehet në pozicionin e mëparshëm, dhe BLL transferohet në një drejtori tjetër, pa ndryshim kategorie page;
- Nëpunësi SHA (ankues) është transferuar mbi 45 km nga vendbanimi;
- Rishqyrtohet mundësia për transferimin e OO.

Me Vendimin nr. 24874/1 prot., datë 31.12.2020, pas shqyrtimit të ankesës së RK, që refuzonte transferimin, pasi gjendej në kushtet ku pozicioni i ri ndodhej më shumë se 45 km larg vendbanimit të tij, KR vendosi përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin, si dhe shteroi mundësitë për transferimin e RK në një pozicion tjetër brenda shërbimit civil.

Me Vendimin nr. 10945/6 prot., datë 08.03.2021, KR vendos transferimin e nëpunësit EM, pa ndryshim në kategori page.

Me shkresën nr. 2830/804 prot., datë 12.03.2021, Drejtori i DAP i dërgon DPT vendimin për transferimin e nëpunësit EM, sipas propozimit nga KR. Kjo shkresë është akti i fundit i dalë, si pasojë e Ristrukturimit të bërë me Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit, pra proces i zgjatur për më shumë se 1 vit.

Gjatë këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit ka dalë me 5 vendime, si më poshtë:

1. Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020;
2. Vendimin nr. 10945/4 prot., datë 25.09.2020;
3. Vendimin nr. 10945/5 prot., datë 16.12.2020;
4. Vendimin nr. 24874/1 prot., datë 31.12.2020;
5. Vendimin nr. 10945/6 prot., datë 08.03.2021.

Disa nga vendimet, në veçanti vendimi i parë i datës 01.07.2020, që ka patur edhe numrin më të madh të transferimeve, është bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, pasi janë transferuar nëpunës, pozicionet e të cilëve nuk janë prekur nga ristrukturimi, janë kryer transferime pa patur parasysh kriteret e pozicioneve të punës, si dhe pa kryer sistemin e pikëzimit.

Për Vendimet e transferimit të marra gjatë procesit të ristrukturimit të vitit 2020, ka 9 procese gjyqësore në zhvillim.

Sa më sipër:
Referuar Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil":
Sipas nenit 50, pika 1,
ñ*Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori*ò.
Në transferimet e propozuara dhe të miratuara janë konstatuar transferime të nëpunësve nëpër sektorë e drejtori të tjera, edhe në rastet kur pozicioni i tyre i mëparshëm vazhdonte normalisht.
Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, indryshuar:
Sipas pikës 8,
ñ*Hapi 2*
Verifikimi i përshkrimeve të punës për të:

- *Evidentuar kriteret e veçanta për secilin pozicion;*
- *Përgatitur listat me grupet e veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në kriteret e veçanta.*ò

Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion vërtetues që Komisioni i Ristrukturimit ka bërë verifikimin e përshkrimeve të punës, si kritere të veçanta të evidentuara dhe lista me grupe të veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në këto kritere, në Vendimin e parë. Pas ankesave të shumta, Komisioni ka dalë në Vendime të tjera, ndër të cilat ka patur raste që ka kthyer transferimet e nëpunësve, pasi në pozicionet e transferuara nuk përmbushnin kriteret. Nga kjo lihet të kuptohet që, në Vendimin e parë të datës 01.07.2020, nuk janë evidentuar kriteret e veçanta për secilin pozicion.
Sipas pikës 10, ñ*Komisioni merr vendim për transferimin e nëpunësve apo përfundimin e marrëdhënies së tyre në shërbimin civil, bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit*...ò
Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion vërtetues që vendimet e marra janë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, sipas parashikimit të Udhëzimit, në Vendimin e parë, të datës 01.07.2020, që ky Komision ka nxjerrë, që ka rezultuar në një numër të madh ankesash. Në vijimësi, Komisioni ka kryer matjen nëpërmjet sistemit të pikëzimit, dhe ka nxjerrë Vendime të tjera, duke rrëzuar Vendimin e parë.
Sipas pikës 17, ñ*Komisioni i Ristrukturimit duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi*ò.
Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion vetëm Vendimi për secilin nëpunës, sa i përket Vendimit të parë, të datës 01.07.2020. Komisioni i Ristrukturimit nuk e ka shoqëruar Vendimin me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi. Nga ai Vendim kanë vijuar një numër i madh ankesash për transferime të pabazuara në kritere, çka ka bërë që Komisioni të dalë me 4 vendime të tjera në vijimësi, duke zgjatur në këtë mënyrë procesin e ristrukturimit dhe duke mos mundësuar funksionimin normal të institucionit, që po i nënshtrohej ristrukturimit.

Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 297/8 prot., datë 26.04.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:

- *Konstatimi i grupit të auditimit mbi afatet e tejkaluara nuk qëndron, pasi neni 91, pika 2, K.Pr.A, parashikon se: "Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë"; Kuadri ligjor në fuqi legjitimon KR që, në varësi të ecurisë së procesit të ristrukturimit, të vendosë zgjatjen e afatin të procedurës së ristrukturimit.*
- *Lidhur me rolin e njësisë përgjegjëse (DAP) gjatë procesit të ristrukturimit të institucioneve, referuar dispozitave ligjore, DAP ka përmbushur me rigorozitet detyrat ligjore të parashikuara në legjislacionin e shërbimit civil në kuadër të procesit të ristrukturimit.*
- *Komisioni u gjend përballë kushteve jonormale për mbledhjen e anëtarëve për shkak të COVID-19. Pas ndryshimit të SP të MFE, iu dha koha e mjaftueshme anëtarit të ri për shqyrtimin e ankesave. Referuar nenit 67 të K.Pr.A "1. Organi publik që është kompetent për*

marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm më të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve. 2. Vendimet e ndërmjetme mund të merren me nismën e organit publik ose me kërkesën e palëve të interesuara. 3. Vendimi për marrjen e masave të ndërmjetme duhet të jetë i arsyetuar, me afat të përcaktuar dhe u njoftohet palëve." dhe nenin 77 "1. Organi publik heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes. 2. Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin, qëllimin dhe shtrirjen e hetimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes".

- *KR, i gjendur para fakteve të reja, rishikoi vlerësimin me pikë, bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit. Përsa i përket vënies në dispozicion të dokumentacionit shoqërues pjesë e vendimmarrjes së KR, sqarojmë se ai ruhet në respektim të parashikimeve të nenit 20 të Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, ku parashikohet se dokumentet me karakter të thjeshtë, të cilat nuk evidencohen dhe nuk dorëzohen në sekretari ruhen në sektorët përkatës derisa kanë vlerë operative, pra këto dokumenta shoqëruese humbasin vlerën operative të ruajtjes.*

Qëndrimi i grupit të auditimit:

- *Afatet e Kodit të Procedurës Administrative, të cituara në observacion, janë afate të përgjithshme, në mungesë të afateve të përcaktuara për një procedure të caktuar. Qëllimi i akteve nënligjore është specifikimi/ detajimi i procedurave konkrete. Ne i referohemi Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, në kushtet kur, vetë institucioni juaj, ka hartuar një akt nënligjor, në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon procesin e ristrukturimit, ndër të tjera duke përcaktuar afate specifike për çdo fazë të procesit. Pavarësisht sa më sipër, vlen për t'u përmendur fakti se, afatet janë tejkaluar, jo vetëm referuar Udhëzimit që rregullon procesin e Ristrukturimit, por edhe referuar nenit 91 të K.Pr.A, të përmendur në observacion.*
- *Observacioni nuk sjell asnjë dokumentacion të ri që të ndryshojë qëndrimin e grupit të auditimit.*
- *Baza ligjore e cituar nuk është relevante. Nuk plotësohen kriteret e cituara në K.Pr.A për Vendimin e ndërmjetëm, dhe Vendimi nuk cilësohet në asnjë moment si Vendim i ndërmjetëm, por si Vendim i dalë si rezultat i shqyrtimit të dokumentacionit të çdo nëpunësi. Ndryshimi i një anëtari të KR, nuk është arsye për rishikimin e transferimeve, pasi faktet e reja që dolën ishin vetëm deklaratat e largësisë mbi 45 km dhe pamundësisë për shkaqe shëndetësore, ndërkohë që KR rishikoi dhe ktheu akte, ku shprehej se nuk plotësoheshin kriteret e pozicioneve të punës ku nëpunësit ishin transferuar, ose për arsye të ngjashme, shkaqe që duhet të ishin të mjaftueshme për të mos i kryer këto transferime që në Vendimin e parë.*
- *Siç është cituar edhe në Akt-Konstatim, në 2 prej Vendimeve të KR të vitit 2020, (përkatësisht Vendimi nr. 10945/4 prot., datë 25.09.2020 dhe Vendimi nr. 10945/5 prot., datë 16.12.2020) gjendet bashkëlidhur një relacion i KR me arsyetimin e secilit prej transferimeve të dala nga këto Vendime. Në relacion përshkruhet procesi, gjenden përshkrimet e punës së pozicioneve ku do të transferoheshin nëpunësit, janë të specifikuara kriteret e veçanta të arsimit dhe përvojës, si dhe në disa raste është përdorur dhe dokumentuar procesi i pikëzimit. Këto dy Vendime, të dokumentuara në mënyrë të rregullt, kanë anuluar një numër aktesh transferimi të dala nga po i njëjti Komision Ristrukturimi, në të cilin përfaqësuesi i DAP nuk ndryshon. Sa i përket humbjes së vlerës operative të ruajtjes së këtyre dokumenteve shoqëruese, baza ligjore e cituar nuk është relevante. Udhëzimi nr. 1, datë 01.03.2016, parashikon qartë se Vendimi i transferimit të çdo nëpunësi duhet të ketë bashkëlidhur praktikën mbi bazën e së cilës është marrë ky Vendim. Observacioni nuk sjell asnjë dokumentacion të ri që të ndryshojë qëndrimin e grupit të auditimit.*

Për sa është trajtuar në këtë çështje të Raportit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 297/11 prot., datë 30.08.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:

Subjekti paraqet interpretimet e tij, të njëjta në thelb me observacionet e ardhura për Akt-Konstatimet, të trajtuara më sipër përgjatë materialit, duke dhënë argumente për transferimet e nëpunësve, procedurave të ndjekura dhe dokumentimit të tyre.
Subjekti paraqet interpretimet e tij mbi bazën ligjore që rregullon procesin, duke kërkuar ndryshimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të lëna mbi tre proceset e ristrukturimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:
Në observacion nuk paraqitet asnjë dokumentacion plotësues ose bazë ligjore që nuk është marrë parasysh nga grupi i auditimit në nxjerrjen e konkluzioneve mbi proceset e ristrukturimit. Sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.

Konkluzione:
Nga auditimi mbi punën e Komisionit të Ristrukturimit dhe dokumentimin e tij, u konstatuan disa mangësi, si vijon:
-Komisioni i Ristrukturimit ka paraqitur mangësi në dokumentimin e procesit, duke shfaqur mungesë transparence në vendimmarrje, edhe pse Udhëzimi nr. 1, datë 1.3.2016 "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit" parashikon se i gjithë procesi duhet të jetë i dokumentuar.
-Në transferimet e propozuara dhe të miratuara janë konstatuar transferime të nëpunësve nëpër sektorë e drejtori të tjera, edhe në rastet kur pozicioni i tyre i mëparshëm ka vijuar punën normalisht.
-Komisioni nuk paraqet paraprakisht një relacion, ku të evidentohen vakancat ekzistuese në institucionin që po i nënshtrohet ristrukturimit, apo nuk ka gjurmë të ketë kërkuar informacion mbi vakanca të mundshme, me qëllimin kryesor sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese.
-Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton të ketë dokumente vërtetues, që vërtetojnë se Komisioni i Ristrukturimit ka kryer verifikimin e përshkrimeve të punës, si kritere të veçanta të evidentuara dhe lista me grupe të veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në këto kritere.
-Komisioni i Ristrukturimit ka nxjerrë vendime të njëpasnjëshme, duke anuluar akte të dala nga vetë ai Komision, e duke u shprehur se janë bërë pa vlerësuar kriteret e veçanta të pozicioneve të punës si dhe duke u shprehur se transferimet janë kryer pa bërë sistemin e pikëzimit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk rezulton që vendimet e marra të jenë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, sipas parashikimit të Udhëzimit.
-Grupit të auditimit, në cdo rast i është vënë në dispozicion vetëm vendimi respketiv për secilin nëpunës, i cili nuk ka bashkëlidhur praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi, ndryshe nga sa parashikohet në Udhëzim, cfarë e bën të pamundur verifikimin e argumentave të përdorura.
-Afatet e procedurës, sipas përcaktimit në Udhëzim, janë tejkaluar dhe nuk ka asnjë arsyetim për tej zgjatjen e afateve të dokumentuar përgjatë procesit.

Titulli i gjetjes:	Mangësi të konstatuara në punën e Komisionit të Ristrukturimit dhe dokumentimin e saj
Situata:	**Në Ristrukturimin e Parë**: Komisioni i Ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore, me Vendimin nr. 7525 prot., datë 09.04.2019, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit, i ka propozuar DAP-it, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, transferimin e përhershëm të 43 nëpunësve civilë, brenda administratës tatimore, në pozicione vakante. Në propozimin e KR, përveç ri pozicionimit direkt të nëpunësve civilë në pozicione pune sipas strukturës së re, të cilët kanë të njëjtin përshkrim pune të njëjtë ose të ngjashëm me atë ku janë aktualisht nëpunësit, ose lëvizjeve në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, për transferimin e nëpunësve në strukturat e AKSHI-t, vihen re disa transferime ku ka

ndryshime në pozicion, drejtori/ sektorë ose nivel page.
Nga grupi i auditimit janë konstatuar **6** raste të transferimeve të nëpunësve civilë, duke pësuar ndryshime në sektorë/ drejtori, pozicion pune e nivel page, ku konkretisht janë **5** nëpunës të transferuar nga sektori/zyra e IT-së në sektorë të tjerë, duke kaluar nga pozicioni i punës specialist, në Inspektorë, çka ka rezultuar në rritje të nivelit të pagës për punonjësit dhe qëndrim brenda shërbimit civil. Ndërkohë nga i njëjti sektor/ zyrë, pjesë e Administratës Tatimore, shkrirja e sektorit të IT bëri që 43 nëpunës të transferohen pranë AKSHI-t, duke përfunduar marrëdhëniet e punës në shërbim civil. **Në Vendim nuk ka asnjë praktikë bashkëlidhur, për të dokumentuar ku u bazua Komisioni për të përzgjedhur brenda të njëjtit sektor/ zyrë, nëpunësit që do të transferoheshin brenda institucionit, dhe atyre që u transferuan te AKSHI, të cilëve iu ndërpre marrëdhënia e punës në shërbim civil,** edhe psenë Vendim citohet se Komisioni i Ristrukturimit e mori vendimin pasi mori në shqyrtim përshkrimet e punës dhe kriteret e veçanta të stafit aktual, si dhe përshkrimet e punës dhe kriteret e veçanta për pozicionet e ristrukturuara. Për këto Vendime të marra nga ana e KR, ka patur 4 ankime nga nëpunës, të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil, si dhe ka 2 procese gjyqësore.
Në Ristrukturimin e Dytë: Me Urdhrin nr. 32, datë 10.05.2019, nr. 2585/1 prot., datë **10.05.2019**, Drejtori i DAP ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit.
Me Vendimin nr. 11348 prot., datë 06.06.2019, KR i propozon DAP-it transferimin e 150 nëpunësve, pas ndryshimeve të ardhura si pasojë e ristrukturimit. Përveç transferimeve të nëpunësve vetëm prej ndryshimeve në emërtesa dhe riorganizime të drejtorive dhe sektorëve, vihen re disa lëvizje që kanë rezultuar në ndryshim të pozicioneve, drejtorive/ sektorëve ose nivelit të pagës për disa nëpunës.
Me shkresën nr. 11348/1 prot., datë **08.07.2019**, KR ka sjellë shkresën me lëndë ñKorrigjim i gabimeve materiale në propozimin e KR nr. 11348 prot., datë 06.06.2019ò, ku vendos korrigjimin e gabimit material, duke cituar ñ*për shkak të pasaktësisë së konstatuar në propozim*ò. Bashkëlidhur nuk ka asnjë praktikë shoqëruese, ku KR është bazuar për të marrë Vendimin e sipërcituar.
Me Urdhrin nr. 62, datë **30.08.2019**, Drejtori i DAP urdhëron ndryshimin e Komisionit të Ristrukturimit, pas ndryshimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.
Me shkresën nr. 17024 prot., datë **12.09.2019**, KR i dërgon DAP-it propozimin për anulimin e 1 akti dhe korrigjimin e 1 akti tjetër.
Me shkresën nr. 16286/2 prot., datë **19.09.2019**, KR i dërgon DAP-it propozimin për anulimin e aktit të transferimit të 10 nëpunësve. KR konstaton se nuk është përmbushur kushti i pikës 1 i Udhëzimit, përsa i takon ndryshimeve thelbësore të pozicioneve që kanë mbajtur nëpunësit më lart.
Në këtë shkresë, Komisioni i Ristrukturimit i referohet vetes si ñ*Komisioni i Ri i Ristrukturimit, i ngritur me Urdhrin nr. 62, datë 30.08.2019*ò. Urdhri në fjalë, ishte ndryshim i Urdhrit nr. 32, datë 10.05.2019 dhe ndryshoi vetëm njërin prej anëtarëve, Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve. Sipas Udhëzimit nr.1, të Departamentit të Administratës Publike, datë 01.03.2016 ñPër krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimitò, Komisioni i Ristrukturimit krijohet me hyrjen në fuqi, të Aktit që ka miratuar mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, në këtë rast Urdhri nr. 86, datë 03.05.2019 i Kryeministrit.

Në Ristrukturimin e Tretë: Me Urdhrin nr. 24, datë 24.02.2020, nr. 1133/1 prot., datë 24.02.2020, i ndryshuar, Drejtori i DAP, ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit.

Me Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020, Komisioni i Ristrukturimit i propozon Departamentit të Administratës Publike transferimin e nëpunësve civilë, ku vihen re edhe transferime të paargumentuara në sektorë/ drejtori, pozicion ose nivel page të ndryshuar. Gjithashtu, vihet re se në DPT janë transferuar nëpunës nga DTM, DRT Tiranë ose DRT Lezhë, në disa raste duke u ngritur dhe në nivel page. Nëpunës të tjerë nga DRT në fjalë janë transferuar në Drejtorinë specifike në Rajonin Qendror ose Verior, pa ndryshuar nivel page. Nuk jepet asnjë shpjegim pse janë përzgjedhur këta nëpunës për këtë transferim. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.

Në vijimësi, pranë DAP janë administruar një numër prej **73 ankesash, në lidhje me aktet e transferimit**, të marra në Vendimin nr. 2380/1 prot., datë 15.07.2020.

Me Urdhrin nr. 58, datë 17.08.2020, nr. 1133/5 prot., datë 17.08.2020, Drejtori i DAP, ndryshon anëtarin e KR, pas ndryshimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE.

Pas kësaj, me Vendimin nr. 10945/4 prot., datë 25.09.2020, **KR vendos t'i propozojë DAPanulimin** e 32 akteve të transferimit, si dhe tâ propozojë **36 akte transferimi të tjera**. Bashkëlidhur propozimit të KR, është nje relacion arsyetues për vendimin e marrë.

Nga kjo rezulton që KR nuk e ka kryer përzgjedhjen sipas sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e nëpunësve brenda së njëjtës njësie që do tâ nënshtroheshin transferimit, para se të dilte në Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020. Në fakt, KR ka patur detyrimin që tâ verifikonte këto kritere para se të dilte në Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020 dhe Drejtori i DAP duhet tâ verifikonte përpara përcjelljes së Vendimin nr. 2830/1 prot., të datës 15.07.2020.

Me Vendimin nr. 10945/5 prot., datë 16.12.2020, KR propozon transferimin e përhershëm të 4 nëpunësve.

Me Vendimin nr. 24874/1 prot., datë 31.12.2020, pas shqyrtimit të ankesës së punonjësit R.K, që refuzonte transferimin, pasi gjendej në kushtet ku pozicioni i ri ndodhej më shumë se 45 km larg vendbanimit të tij, KR vendosi përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin, si dhe shteroi mundësitë për transferimin e RK në një pozicion tjetër brenda shërbimit civil.

Me Vendimin nr. 10945/6 prot., datë 08.03.2021, KR vendos transferimin e nëpunësit EM, pa ndryshim në kategori page.

Gjatë këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit ka dalë me 5 vendime të njëpasnjëshme, si më poshtë:

6. Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020;
7. Vendimin nr. 10945/4 prot., datë 25.09.2020;
8. Vendimin nr. 10945/5 prot., datë 16.12.2020;
9. Vendimin nr. 24874/1 prot., datë 31.12.2020;
10. Vendimin nr. 10945/6 prot., datë 08.03.2021.

Disa nga vendimet përgjatë këtij procesi ristrukturimi, në veçanti vendimi i parë i datës 01.07.2020, që ka patur edhe numrin më të madh të transferimeve, është bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, **pasi (a) janë transferuar nëpunës, pozicionet e të cilëve nuk janë prekur nga ristrukturimi**, **(b) janë kryer transferime pa patur parasysh kriteret e pozicioneve**

të punës, si dhe **(c) pa kryer sistemin e pikëzimit.**

Për vendimet e transferimit të marra gjatë procesit të ristrukturimit të vitit 2020, ka 9 procese gjyqësore në zhvillim, të cilat mbartin riskun e krijimit të detyrimeve si pasojë e vendimeve gjyqëore me impakt në buxhetin e shtetit.

Në përfundim rezultoi se, për të tre proceset e ristrukturimit, subjekt i këtij auditimi, grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion vetëm vendimet për secilin nëpunës, të cilëve nuk i është bashkëlidhur praktika mbi bazën e së cilës është marrë edhe vendimi, në kundërshtim me **pikën 17**, te udhëzimit ku parashikohet se: ñ*Komisioni i Ristrukturimit duhet ta shoqërojë vendimin e propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi*ò, me konkretisht:.

- Nga auditimi rezultoi se, në transferimet e propozuara dhe të miratuara janë konstatuar transferime të nëpunësve nëpër sektorë e drejtori të tjera, edhe në rastet kur pozicioni i tyre i mëparshëm ka vijuar normalisht, në kundërshtim me nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò.
- Komisioni nuk ka paraqitur një relacion, ku të evidentohen vakancat ekzistuese në institucionin DPT, apo nuk ka gjurmë të ketë kërkuar nga DAP informacion mbi vakanca të mundshme, me qëllimin kryesor sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, në kundërshtim me pikën 4, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar
- Në Vendimin (propozimin) e KR për **transferimin e nëpunësve** ose Vendimet individuale **për përfundimin e marrëdhënieve të punës** në shërbimin civil, Komisioni përdor si argument faktin se: ñ*Në strukturën dhe organikën e re të Administratës Tatimore Qendrore nuk parashikohet asnjë pozicion i dedikuar për teknologjinë e informacionit.*ò; Në fakt, rezultoi se në vendim **nuk** përmenden përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuara ose kriteret specifike, në kundërshtim me piken 6, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar dhe KR niset vetëm nga emërtimi i drejtorisë/ sektorit, për të konkluduar se, pas ristrukturimit, nuk parashikohet asnjë pozicion i dedikuar për teknologjinë e informacionit, edhe pse mes personave të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil me këtë arsyetim, ka pasur ekonomistë e inxhinierë, me role specifike brenda Drejtorisë së Analizës dhe IT apo Sektorit të Analizës dhe IT (në varësi të rajonit), që pas ristrukturimit u riemëruan Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, dhe që kishte në përbërje të saj jo vetëm nëpunës të specializuar në teknologjinë e informacionit.
- Grupit të auditimit nuki është vënë në dispozicion:
  - asnjë dokumentacion vërtetues për verifikimin e përshkrimeve të punës, si kritere të veçanta të evidentuara dhe lista me grupe të veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në këto kritere, sikundër dikton pika 8, hapi 1 (përveç dy rasteve gjatë Ristrukturimit të tretë);
  - asnjë dokumentacion vërtetues që vendimet e marra janë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, sipas parashikimit të Udhëzimit (përveç dy rasteve gjatë Ristrukturimit të Tretë);
  - asnjë dokumentacion vërtetues për kryerjen e krahasimit dhe

vlerësimit të informacionit të mësipërm, mbi të cilat KR është mbështetur për marrjen e vendimeve mbi transferimin ose përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve.

Kriteri:	Ligji 152/2013 ñPër nëpunësin civilò; Udhëzimi nr. 1 i Departamentit të Administratës Publike, datë 01.03.2016 ñPër krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimitò.
Ndikimi/Efekti	Sa trajtuar më sipër, ka sjellë mungesë transparence dhe tej zgjatje të proceseve, duke shtrirë në kohë një situatë jo të qëndrueshme në institucionin që po ristrukturohej dhe duke cënuar veprimtarinë normale të tij
Rëndësia	E lartë
Situata:	**Titulli i gjetjes:** Mos garantimi i rolit aktiv të DAP, në Komisionin e Ristrukturimit Nga auditimi rezultoi se, sa i përket afateve të procesit të ristrukturimit, sipas parashikimit në Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, ky proces ka përfunduar në datën 30.10.2019, pra më shumë se 5 muaj pas hyrjes në fuqi të aktit. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni i Ristrukturimit, ka dalë me 4 Vendime drejtuar DAP, duke kundërshtuar veten në disa raste, si më poshtë: • Vendimi nr. 11348 prot., datë 06.06.2019; kjo shkresë nuk ka asnjë argumentim ose praktikë bashkëlidhur • Shkresa nr. 11348/1 prot., datë 08.07.2019, ñKorigjim i gabimeve materiale në propozimin e KR nr. 11348 prot., datë 06.06.2019ò; Komisioni i Ristrukturimit, në shkresën e mësipërme, propozon korrigjimin e gabimit material, sa i përket transferimit të një nëpunësi, duke u shprehur se kjo ka ardhur ñ*për shkak të pasaktësisë së konstatuar në propozim*ò. Nuk thuhet se për çfarë pasaktësie bëhet fjalë, apo çfarë gabimi material është konkretisht. • Me shkresën nr. 17024 prot., datë 12.09.2019, ñPropozimin për anulim të aktit të nëpunësit M.P dhe korrigjimin e aktit të A.B dhe nxjerrjen e akteve të reja, në kuadër të ristrukturimitò, pasi është konstatuar se Komisioni i Ristrukturimit, propozon ta rikthejë në pozicionin e mëparshëm nëpunësin, pasi është transferuar me Vendimin nr. 11348 prot., datë 06.06.2019, pasi struktura e pozicionit që ka mbajtur në strukturën e mëparshme nuk ka ndryshuar dhe pozicioni i mëparshëm i nëpunësit ka ndryshuar vetëm emërtesën. • Shkresa nr. 16286/2 prot., datë 19.09.2019, ñPropozim për anulim të aktitò për 10 punonjës; Në këtë shkresë, KR konstaton se në Vendimin nr. 11348 prot., datë 06.06.2019, vetë KR nuk ka përmbushur kushtin e pikës 1 të Udhëzimit nr. 1, date 01.03.2016, për sa i takon ndryshimeve thelbësore të pozicioneve që kanë mbajtur nëpunësit e sipërpërmendur, ndërkohë që pika 1 e Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, citon: ñ*Jo më vonë se dy ditë pas hyrjes në fuqi të aktit që ka miratuar mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, nëpunësi më i lartë civil në institucionin në të cilin është/janë nëpunësi/t i/të emëruar në pritje për transferim, i kërkon njësisë përgjegjëse (DAP), nxjerrjen e aktit për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit*ò. <u>Nuk është e qartë pse është referuar kjo pikë e Udhëzimit për të argumentuar anulimin e akteve.</u> Gjithashtu, janë transferuar dy

	nëpunës, për nevoja të punës, siç shprehet KR ñ*me qëllim përmbushjen e objektivave të njësisë, nëpërmjet sigurimit të burimeve njerëzore të nevojshme*ò. KR e mbyll këtë shkresë duke cituar se ñ*Pasi mori në shqyrtim të gjitha ndryshimet e strukturës dhe organigramës (duke iu referuar Vendimit nr. 11348 prot., datë 06.06.2019), KR konstaton zbatim të ligjshmërisë në kryerjen e transferimeve për shkak të ristrukturimit për pjesën tjetër të nëpunësve civilë*ò, duke lënë të kuptohet që ka bërë një kontroll të zbatimit të ligjshmërisë së transferimeve sipas Vendimit të Drejtorit të DAP, edhe pse kjo nuk është kompetencë e KR me asnjë bazë ligjore.
Kriteri:	Ligji 152/2013 ñPër nëpunësin civilò; Udhëzimi nr. 1 i Departamentit të Administratës Publike, datë 01.03.2016 ñPër krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimitò.
Ndikimi/Efekti	Komisioni i Ristrukturimit në përgjithësi dhe DAP që udhëheq këtë komision në veçanti, nuk kanë kryer siç duhet rolin e tyre në procesin e ristrukturimit, duke mos argumentuar vendimet e marra, shpeshherë duke i anuluar ato, në mungesë transparence e llogaridhënie, të pabazuara dhe pa dokumentuara dhe në disa raste edhe në shkelje të afateve të parashikuara.
Rëndësia	E lartë

2.3. Verifikimi i kryerjes me përpikmëri të rolit mbikëqyrës të DAP në ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore që lidhen me këtë proces.

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit 297/1, datë 26.02.2021, mbi verifikimin e kryerjes me përpikmëri të rolit mbikëqyrës të DAP në ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore që lidhen me këtë proces u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Baza ligjore mbi rolit mbikëqyrës të DAP në ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore:
-Ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative
- Kodi i Procedurës Civile
-Ligji 152/2013 ñPër nëpunësin civilò i ndryshuar
-VKM nr. 673, datë 22.11.2017 ñPër riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò
-Urdhri 5151/2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò,
-Ligji nr. 44/2015 ñKodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisëò
-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore sipas shqyrtimit të rasteve specifike.
-Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò.
-Urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019 i Kryeministrit ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò
-Urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò
- Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñPër disa ndryshime në Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit ñPër miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendroreò
Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, të ndryshuar, neni 66/1, Departamenti i Administratës Publike është institucioni i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil. Në

zbatim të ligjit të sipërcituar, si dhe Vendimit nr. 943, datë 09.10.2013 të Këshillit të Ministrave ñPër përcaktimin e fushës së përgjegjësisë së Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publikeò, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ka nxjerrë Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 òPër zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nga institucionëet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civilò, që përcakton rregulla të detajuara, procedurën, si dhe modaltitet e kryerjes së veprimtarisë administrative në funksion të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Sipas Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015, Kreu II, njësia e BNJ të njësisë debitorë (DPT në këtë rast) duhet të krijojë bazën e të dhënave gjyqësore, e cila duhet të përmbajë t ëgjithë elementët e parashikuar në këtë urdhër. Kjo bazë të dhënadh duhet të përditësohet dhe i vihen në dispozicion DAP-it brenda 2 ditëve pune nga momenti i përditësimit. **DAP-i ka për detyrë të monitorojë plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësore.**

Sa i takon ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, **është përsëri DAP që mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve të formës së prere**, sipas Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, Kreu III, pika 3, parag. nr. 2,

Sipas Kreut IV të Urdhrit nr. 5151/2015, pranë çdo njësie debitore Institucioni (Institucioni që mbart një detyrim të caktuar, sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë), ngrihet një Komision i Posaçëm (KP), me përbërjen si vijon:

1. Sekretarin e Përgjithshëm në institucionin e njësisë debitore;
2. Përfaqësuesin e njësisë debitore në institucionin përkatës për çështjet juridike;
3. Përfaqësuesin e njësisë debitore në institucionin përkatës për çështjet financiare/buxhetore;
4. Përfaqësuesin e njësisë debitore në institucionin përkatës për çështjet e burimeve njerëzore, që kryen edhe rolin e sekretariatit teknik të KP-së.

Komisioni i Posaçëm, sipas Urdhrit 5151/2015, vëzhgohet nga përfaqësues i DAP, i cili ky i fundit duhet të vihet në dijeni për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, brenda dy ditëve pune nga depozitimi i kërkesës për ekzekutim.

Në detyrat e Drejtorisë së Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore përfshihet edhe mbikëqyrja e veprimtarisë së Komisioneve të Posaçëme. Drejtoria e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore ndahet në dy sektorë, respektivisht Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore dhe Sektori i Integritetit dhe Mbikëqyrjes.

Sektori i Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, ndër të tjera ka si objektiv edhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Komisioneve të Posaçëm, të ngritura nëpër të gjitha institucionet e administratës shtetërore. Për rrjedhojë, të gjitha kërkesat zyrtare me shkrim, për caktimin e përfaqësuesit të DAP, në cilësinë e mbikëqyrësit vëzhgues, në Komisionet e Posaçëm, përcillen nga titullari i institucionit pranë Drejtorit të Drejtorisë së Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore.

Pas administrimit të kërkesave për pjesëmarrje në Komisionet e Posaçëm (zyrtarisht me shkrim apo përmes komunikimit elektronik), Drejtori i Drejtorisë së Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore përzgjedh nga radhët e nëpunësve të Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, përfaqësuesin e DAP që ngarkohet me cilësinë e vëzhguesit apo mbikëqyrësit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm.

Në përputhje me procedurën e mësipërme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka depozituar pranë DAP-it kërkesën nr. 16017 prot., datë 27.08.2019 për caktimin e përfaqësuesit të DAP në Komisionin e Posaçëm të ngritur pranë DPT-së. Në përgjigje të kësaj kërkese, DAP ka nxjerrë shkresën nr. 5003/1 prot., datë 30.08.2019, duke i njoftuar DPT-së nëpunësin e autorizuar për këtë veprimtari administrative. Në vijim të kësaj korrespondence, nga ana e DPT-së është njoftuar mbledhja e Komisionit të Posaçëm për në datën 17.09.2019, dokumentuar me procesverbalin respektiv në DPT.

<u>Pas kësaj mbledhjeje DPT-ja nuk ka depozituar apo njoftuar mbledhje të radhës së Komisionit të Posaçëm.</u>

Por nga komunikimi i Grupit të auditimit të DAP me grupin e auditimit në DPT rezulton që Komisioni i Posaçëm është mbledhur edhe gjatë vitit 2020 pa informuar DAP dhe si rrjedhojë edhe pa përfaqësuesin e DAP-it, në kundërshtim me Urdhrin nr.5151 datës 28.10.2015, Kreu IV,

pika 2, ku parashikohet se Komisioni i Posaçëm thirret nga Kryetari **brenda dy ditëve pune** nga depozitimi i kërkesës së kreditori, ose përmbaruesit , **duke vënë në dijeni DAP-in.**

Që nga data 27.08.2019 e në vazhdim, DAP nuk ka marrë pjesë në Komisionet e Posaçme edhe pse këto janë krijuar dhe kanë lënë edhe akt-rekomandime. Konkretisht:
Pas administrimit të kërkesave për pjesëmarrje në Komisionet e Posaçëme (zyrtarisht me shkrim apo përmes komunikimit elektronik), Drejtori i Drejtorisë së Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore në DAP përzgjedh nga radhët e nëpunësve të Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore përfaqësuesin e DAP që ngarkohet me cilësinë e vëzhguesit apo mbikëqyrësit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm sipas Urdhrit nr.5151 datës 28.10.2015, Kreu IV në të cilin theksohet se *Komisioni i Posaçëm vëzhgohet nga përfaqësuesi i DAP-it*
Në përputhje me procedurën e mësipërme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka depozituar pranë DAP-it kërkesën nr. 16017 prot., datë 27.08.2019 për caktimin e përfaqësuesit të DAP në Komisionin e Posaçëm të ngritur pranë DPT-së. Në përgjigje të kësaj kërkese, DAP ka nxjerrë shkresën nr. 5003/1 prot., datë 30.08.2019, duke i njoftuar DPT-së nëpunësin e autorizuar për këtë veprimtari administrative. Në vijim të kësaj korrespondence, nga ana e DPT-së është njoftuar mbledhja e Komisionit të Posaçëm për në datën 17.09.2019, dokumentuar me procesverbalin respektiv në DPT.
Pas kësaj mbledhjeje DPT-ja nuk ka depozituar apo njoftuar mbledhje të radhës së Komisionit të Posaçëm.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Komisioni i Posaçëm është krijuar edhe pas datës 17.09.2019, por pa informuar DAP dhe si rrjedhojë edhe pa përfaqësuesin e DAP-it në kundërshtim kjo me Urdhrit nr.5151 datës 28.10.2015, Kreu IV theksohet se Komisioni i Posaçëm vëzhgohet nga përfaqësuesi i DAP-it
Konkretisht Krijimi i Komisionit të Posaçëm pa praninë e përfaqësuesit të DAP

Viti 2020:
Procesverbalet

Nr.	12530	prot,	datë	03.07.2020
Nr.	13627	prot,	datë	17.07.2020
Nr.	16557	prot,	datë	25.08.2020
Nr.	22334	prot,	datë	19.11.2020
Nr.	23750	prot,	datë	15.12.2020
Nr.			prot, datë	10.12.2020

Viti 2021:
Procesverbalet

Nr.	19513/3	prot,	datë	28.01.2021
Nr.	24226/3	prot,	datë	11.02.2021

Nr. 23325/4 prot, datë 09.03.2021

Nga këto procesverbale shihet se Komisioni Posaçëm është krijuar dhe ka nxjerrë Akt-Rekomandime pa praninë e përfaqësuesit të DAP. Duhet theksuar që Departamenti i Administratës Publike është vënë në dijeni për këto Akt-Rekomandime, pra për krijimin e Komisionit të Posaçëm pa praninë e Përfaqësuesit te DAP-it, kjo në kundërshtim me Urdhrin 5151/2015, Kreu IV pika1.Por edhe pse janë vënë në dijeni për krijimin e KP pa praninë e përfaqësuesit të DAP, nuk ka patur ndonjë reagim nga ky institucion për respektimin e Urdhrit 5151/2015, Kreu IV pika 1.

Lidhur me mënyrën e kryerjes së rolit mbikëqyrës të DAP-it, në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, pas punës së Komisionit të Posaçëm, të gjitha veprimet administrative duhet të kryhen sipas Kreut V të Urdhrit nr.5151/2015.

Konkretisht, veprimet që DAP duhet të realizojë renditen si më poshtë:

a) DAP duhet të shqyrtojë akt-rekomandimet e dërguara nga Komisionet e Posaçëm brenda 15 ditëve punë dhe sipas rastit vendos **pranimin/mospranimin** e akteve të Komisionit të Posaçëm. Konkretisht:

5. Kur DAP pranon akt-rekomandimin e KP-së, që përmban propozimin për sistemim të gjyqfituesit, brenda 3 ditëve punë nga **pranimi**, duhet të nxjerrë aktin e emërimit në pozicionin e propozuar në shërbimin civil;
6. Kur DAP konstaton mangësi gjatë shqyrtimit të akt-rekomandimit, brenda 3 ditëve pune nga shqyrtimi i tij, duhet të vendosë **mospranimin** e tij dhe nxjerr aktin e emërimit;

b) Nëse DAP vërteton pamundësi objektive të sistemimit në një pozicion të rregullt të shërbimit civil në njësinë debitore ose institucion të varësisë së tij DAP duhet:

- brenda 15 ditëve pune duhet të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të gjyqfituesit, në një institucion tjetër, në një pozicion tjetër të rregullt të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, sipas kritereve të veçanta apo të ngjashme që i plotëson gjyqfituesi;
- në rastet e pamundësisë së sistemimit të gjyqfituesit sipas paragrafit më lart, DAP shqyrton mundësinë e pozicionimit të gjyqfituesit në një pozicion më të ulët në shërbimit civil;

c) Procedura që DAP duhet të ndjekë sipas pikës 2, gërma ñaò është si vijon:

7. DAP brenda dy ditëve punë duhet ti përcjell zyrtarisht institucionit tjetër të shërbimit civil propozimin për sistemimin e gjyqfituesit në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, në përputhje me kriteret e veçanta apo të ngjashme me pozicionin e punës nga është larguar

d) Kur vërtetohet mundësia e sistemimit në punë e gjyqfituesit sipas njërës prej alternativave të mësipërme, DAP brenda 3 ditëve punë duhet të njoftojë me shkrim gjyqfituesin dhe i kërkon pëlqimin me shkrim (pëlqimi duhet të jepet për tre ditë pune), vetëm për rastet kur sistemimi do të kryhet në një pozicion më të ulët. Në rastet kur gjyqfituesi nuk jep pëlqimin për sistemim në një pozicion të një kategorie më të ulët, ai qëndron në listën e pritjes.

Kur në përfundim të këtij procesi DAP vëren pamundësinë objektive të gjyqfituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori, apo të një kategorie më të ulët e regjistron gjyqfituesin në listë pritjeje. DAP administron ñListën e pritjesò, në të cilën përfshihen të gjithë nëpunësit civilë gjyqfitues, objektivisht të pamundur për tâu sistemuar në një pozicion të rregullt në shërbimin civil. DAP mban në konsideratë faktet e reja të lindura pas regjistrimit të gjyqfituesit në listë pritje në çdo rast, kur krijohen pozicione të lira të punës në shërbimin civil, në njësitë debitore, shqyrton mundësinë e sistemimit të gjyqfituesit të mbetur në listë pritje, në vendet e reja vakante. Nëse DAP vëren se, gjyqfituesi i mbetur në listë pritje mund të sistemohet në një nga vendet e mbetura vakante, nxjerr aktin e emërimit në një pozicion të shërbimit civil. Gjithashtu, DAP mund të procedojë edhe me emërimin e përkohshëm të gjyqfituesve të mbetur në listë-pritje, sipas parashikimeve të Kreut V të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar.

Sipas informacionit të marre nga Drejtoria e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, gjatë vitit 2019, **procese gjyqësore** mbas procesit të ristrukturimit, në zbatim të urdhrit nr. 20, datë 11.03.2019 për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 673, datë 22.11.2017 ñPër Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionitò, ka patur vetëm **dy**: zj. A. H. dhe z. A. D., të dy Specialistë në sektorin e Pajisjeve Fiskale në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit në DPT dhe kaluar në Specialistë të pajisjeve fiskale pranë AKSHI. Për të dy proceset gjyqësore është rrëzuar padia në shkallë të parë.

Të dhënat në tabelën e mëposhtme

Procese gjyqësore mbasprocesit të ristrukturimit, në zbatim të urdhrit nr. 20, datë 11.03.2019 për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qëndrore, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 673, datë 22.11.2017 "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit"				
Nr.	**Procese Gjyqësore 2019**	**Pozicioni ku ka qene paditesi perpara ristrukturimit**	**Pozicioni ku ka shkuar pas ristrukturimit**	**Statusi i gjykimit**
1	A.H.	Specialiste në Sektorin e Pajisjeve Fiskale, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	Specialistit të Pajisjeve Fiskale pranë AKSHI	Rrëzuar padia në Shkallë të Parë
2	A. D.	Specialist në Sektorin e Pajisjeve Fiskale, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	Specialistit të Pajisjeve Fiskale pranë AKSHI	Rrëzuar padia në Shkallë të Parë

Burimi: DAP

Nga verifikimi i te dhënave te DAP konstatojmë se, në data bazën e të dhënave që na u vu në dispozicion, nuk ka informacion mbi gjendjen juridike te pozicionit te punës, pas largimit të nëpunësve në fjalë, sipas kërkesave te urdhrit 5151/2015, ku në bazën e të dhënave gjyqësore të plotësuara nga njësia debitorë (DPT) duhet të shprehet gjendja juridike e pozicionit të punës pas largimit të punonjësit (dhe jo pozicioni ku ka qene punonjësi para dhe pas ristrukturimit) si: ñpozicioni nuk ekzistonò, ñi bashkuar me pozicione të ngjashmeò, ñndryshim kritereshò si dhe ñshkaku ligjor për të cilin është zënë vendi i punësò. Këto të dhëna duhet të përditësohen dhe në këtë formë tôi vihen në dispozicion DAP-it brenda dy ditëve pune, nga momenti i përditësimit. DAP më pas monitoron plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësorëe.

Nga verifikimi i proceseve gjyqësore në vijim të procesit të ristrukturimit, në zbatim të Urdhrit nr. 24, datë 24.02.2020 ñPër ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendroreò, bazuar në Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", rezultoi se **nga ristrukturimi i trete** kanë nisur**9** procese gjyqësore, nga të cilat:
- 2 vendime me ekzekutim të përkohshëm në favor të 2 punonjësve (E. D., A. C.)
- 2 vendime të shkallës së parë, në favor të 2 punonjësve (S. S., Xh.T.)
- 3 punonjës të rikthyer në punë me vendime te Komisionit të Ristrukturimit, pas fillimit të procedurave gyqësore (E.P., A. M., M. A.)
- 2 padi të rrëzuara në shkallë të parë (R. K., J.B.), cështjet janë apeluar

1. Për punonjësen E. D. rezultoi se:

- *para ristrukturimit, mbante pozicionin si Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.*
- *pas ristrukturimit pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Qendror)*

Paditësi E. D. ka kërkuar: 1.Shfuqizimin e aktit administrativ, vendim nr. 2830/165 datë 23.07.2020 të Departamentit të Administratës Publike me anë të të cilët është vendosur transferimi i përhershëm i Paditësit, njoftuar me shkresën nr.14686/1, datë 30.07.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë dhe shkresën nr.18609/1 prot, datë 11.08.2020 të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë; dhe 2. Kthimin në pozicionin e mëparshëm.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 2831 datë 09.11.2020, protokolluar ne DAP me shkresën nr. 6164 prot, datë 23.11.2020 ka vendosur :
-Pranimin e kërkesë padisë së paditeses Estela Dura.
-Shfuqizimin e aktit administrativ vendim nr. 2830/165, date 23.07.2020, me lëndë "Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit" i Departamentit të Administratës Publike, njoftuar me shkresën nr. 14686/1, datë 30.07.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë dhe shkresën nr. 18609/1 prot. datë 11.08.2020 të Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë.
-Detyrimin e palës së paditur Departamenti i Administratës Publike të transferojë paditëse Estela Duraj në pozicionin Përgjegjës në një nga drejtoritë e Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë, të krijuara pas ristrukturimit.
-Shpenzimet gjyqësore dhe ato për vënien në ekzekutim të vendimit në ngarkim të palëve të paditura solidarisht .
-Bazuar në nenin 317 të Kodi Procedurave Civile ky vendimet jepet me ekzekutim të përkohshëm, përbën titull ekzekutiv dhe duhet të ekzekutohet menjëherë nga përmbarimi gjyqësor.
-Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Për këtë punonjëse ,në përfundim rezultoi se, është pranuar padia në Shkallë të Parë dhe është dhënë vendimi me ekzekutim të përkohshëm në shkallë të parë. Ndaj vendimit, DAP ka ushtruar të drejtën e ankimit të veçantë për vendimin me ekzekutim të përkohshëm (Ankimimi nr. 6342 prot, datë 01.12.2020)dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të themelit. Aktualisht, çështja është në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
Ky vendim është ekzekutuar nga DAP, sipas vendimit me ekzekutim të përkohshëm të dhënë nga gjykata.

2. Për punonjësin A. C. rezultoi se:

- *para ristrukturimit mbante pozicionin si Drejtor i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë.*
- *Pas ristrukturimit, kaloi si Drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave*

Paditësi A. C. i është drejtuar gjykatës dhe ka kërkuarshfuqizimin e aktit administrativ, vendimin nr. 2830/332 prot., date 23.07.2020, lëshuar nga Departamenti i Administratës Publike ñTransferim për shkak të ristrukturimit të institucionitò.
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 2691 datë 30.10.2020, protokolluar në DAP me shkresën nr. 5743 prot, datë 11.11.2020 ***ka vendosur:***
1.Pranimin e kërkesë- padisë.
2. Shfuqizimin e vendimit ñPër transferim për shkak të ristrukturimit të institucionitò, nr. 2830/332 prot., datë 23.07.2020 të lëshuar nga Departamenti i Administratës Publike.
3. Detyrimin e palëve të paditura të kthejnë dhe të sistemojnë paditësin A. C. në Pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.
4.Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.
5. Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe bëhet i ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbarimor në mënyrë të menjëhershme si vendim me ekzekutim të përkohshëm (neni nr. 317, Kodi Procedurës Civile).
DAP ka ankimuar çështjen, me shkresën nr. 5743/2 prot, datë 23.11.2020

Në përfundim rezultoi se, për këtë punonjës, është pranuar padia në Shkallë të Parë dhe dhënë vendimi me ekzekutim të përkohshëm *në shkallë të parë. Ndaj vendimit, DAP ka ushtruar të drejtën e ankimit të veçantë për vendimin me ekzekutim të përkohshëm dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të themelit. Aktualisht, çështja është në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.*
Ky vendim është ekzekutuar nga DAP, sipas vendimit me ekzekutim të përkohshëm të dhënë nga gjykata.

3. Për punonjësin R. K. rezultoi se:

- *para ristrukturimit, mbante pozicionin si Inspektor i Dytë, në Sektorin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, kategoria e pagës IV-a.*
- *Pas ristrukturimit, si Inspektor i Dytë, në Sektorin e Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Jugor), ne Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier, kategoria e pagës IV-a .*

Momentalisht është i liruar nga detyra pasi nuk ka pranuar transferimin.

Paditësi R. K. ka kërkuar:1. Shfuqizimin, anulimin e aktit administrativ, urdhër i Departamentit të Administratës Publike nr. 2830/456 prot., datë 22.07.2020 ñPër transferim të përhershëm në detyrë, për shkak të ristrukturimitò; 2. Shfuqizimin, anulimin e aktit administrativ, urdhër i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 14422/1 prot., datë 27.07.2020 ñPër transferim të përhershëm në detyrë, për shkak të ristrukturimitò; 3. Vazhdimin e marrëdhënieve të punës dhe pagesës të paditësit Roland Karalliu në pozicionin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të barasvlershëm në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër; dhe 4. Marrjen e masës së sigurimit të padisë: ñPezullimin e zbatimit të akteve administrativeò, Urdhër i Departamentit të Administratës Publike nr. 2830/456 prot., datë 22.07.2020 ñPër transferim të përhershëm në detyrë, për shkak të ristrukturimitò dhe Urdhër i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 14422/1 prot., datë 27.07.2020 ñPër transferim të përhershëm në detyrë, për shkak të ristrukturimitò.

Gjykata Administrative e Shkallës Parë Gjirokastër me vendimin nr. 423 (85-2020-987), datë 7.12.2020 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Paditësika apeluar çështjen dhe cështja është në proces.

4. Për punonjësin ***Xh. T. rezultoi se:***

- *para ristrukturimit mbante pozicionin si Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë*
- *Pas ristrukturimit, si Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit Analizës për Masat Shtrënguese në Drejtorinë e Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore te Papaguara, ne Dr e Tatimaguesve të Mëdhenj.*

Paditësi Xh. T. ka kërkuar: 1. Shfuqizimin e aktit administrativ vendimi nr. 2830/80 prot., datë 15.07.2020 të Departamentit të Administratës Publike, 2. Shfuqizimi i aktit nr. 13788/1 prot., datë 20.07.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, 3. Detyrimin e palëve të paditura, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të rikthejë paditësin në pozicionin e mëparshëm të punës, Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë., dhe 4. Detyrimin e palëve të paditura të paguajnë shpenzimet gjyqësore.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 3406, datë 18.12.2020, ka vendosur:
-Pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë.
-Shfuqizimin e vendimit nr. 2830/80 prot., datë 15.07.2020, të Departamentit të Administratës Publike dhe shkresës nr. 13788/1 prot., datë 20.07.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

-Detyrimin e palëve së paditura, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, që të rikthejnë paditësin në pozicionin e mëparshëm të punës, përgjegjës të sektorit të kontrollit tatimor, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, kategoria III-b.
-Rrëzimin e padisë për kërkimin e dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.
-Rrëzimin e padisë për palën e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, për mungesë të legjitimimit pasiv.
-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurve.
-Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbarimor gjyqësor.
-Ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor të ekzekutojë plotësisht detyrimin nga dita që vendimi të marrë formë të prerë.
-Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
-U shpall më datë 18.12.2020.
Pranuar padia në Shkallë të Parë. Ndaj vendimit DAP ka ushtruar të drejtën e ankimit. Aktualisht, çështja është në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

5. Për punonjësin E. P. rezultoi se:

- *para ristrukturimit Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve*
- *Pas ristrukturimit Përgjegjës, në Sektorin e Thirrjeve (Call Center), në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.*

Pranuar padia në Shkallë të Parë pjesërisht.
Paditësi E. P. është rikthyer ne pozicionin e mëparshëm si Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve nga Komisioni i Ristrukturimit.

Paditësi Erion Prifta ka kërkuar:
1. Shfuqizimin e akteve administrative (Shkresës nr. 2830/17, datë 15.07.2020 të Departamentit të Administratës Publike me lëndë ñTransferim për shkak të ristrukturimit të institucionitò dhe Shkresës nr. 13636/1 prot., datë 20.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve ñPër transferimin e përhershëm të z. E. P.ò
2. Sistemimi në një pozicion pune të lirë të së njëjtës kategori pune që ka përfituar me akt emërimin e statusit të nëpunësit civil si ñDrejtor Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeveò me kategori page III-a;
3. Pagimin e diferencës së pagës deri në rikthimin në pozicionin e punës të barasvlershëm.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. vendimi80-2020-3302, datë 10/12/2020 ka vendosur:
-Pranimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi E. P..
-Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e përgjithshme e Tatimeve që ti paguaj paditësit E. P. diferencën e pagës midis vendit te punës pas transferimit nga ajo qe ka përfituar para transferimit, për periudhën nga data 24.07.2020 deri ne datën 15.10.2020.
-Shpenzimet gjyqësore të parapaguara nga paditësi, në masën 3.000 (tre mijë) lekë, lihen në ngarkim palës së paditur DPT.
-Ky vendim është titull ekzekutiv në zbatim të nenit 510/a të Kodi Procedurave Civile, dhe është drejtpërdrejt i ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbarimor shtetëror/privat, nga data që ky vendim merr formë të prerë.
-Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Administrative të Apelit Tiranë, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
-U shpall në Tiranë sot me datë 10.12.2020.
Paditësi E. P. është rikthyer ne pozicionin e mëparshëm si "Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve" me vendim nga Komisioni i Ristrukturimit.

6. Për punonjësen S. S. rezultoi se:

1. *para ristrukturimit mbante pozicionin si Inspektor i Parë, në Sektorin e Hartimit dhe Ndjekjes së Buxhetit, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, kategoria e pagës III-b*
2. *Pas ristrukturimit, si Specialist, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, kategoria e pagës IV-a.*

Paditësi S. S. ka kërkuar:
1. Shfuqizimin e aktit me nr. 3922 prot., datë 26.08.2020 të Departamentit të Administratës Publike;
2. Shfuqizimin e aktit nr. 13678/1 prot., datë 20.07.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve marrë njoftim më datë 23.07.2020;
3. Shfuqizimin e aktit me nr. 2830/55, datë 15.07.2020 ñTransferim për shkak të ristrukturimit të institucionitò, marrë njoftim më datë 21.07.2020;
4. Zbatimin e vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil Tiranë me nr. 176, datë 20.09.2013, si dhe Vendim të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me nr. 3037, datë 11.09.2018;
5. Detyrimi i palëve të paditura sistemojnë paditësin në një pozicion të njëjtë dhe kategori page të njëjtë me atë që ka vendosur vendimi i Komisionit të Shërbimit Civil Tiranë me nr. 3037, datë 11.09.2018 ose deri në sistemimin sipas vendimeve të mësipërme të më sistemojnë me të njëjtën kategori page III-b;

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 59 datë 19.02.2021 vendosi:
- Pranimin pjesërisht të kërkesë ï padisë së paditëses S. S..
- Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 2830/55 prot., datë 20.07.2020 të palës së paditur Departamenti i Administratës Publike ñPër transferimin për shkak të ristrukturimit të institucionitò të paditëses S. S..
- Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 13678/1 prot., datë 20.07.2020 të palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
- Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 3922 prot., datë 26.08.2020 të palës së paditur Departamenti i Administratës Publike.
- Detyrimin e palëve të paditura të sisitemojë paditësen S. S., në një pozicion tjetër të së njëjtës kategori dhe pagë me atë që ka patur përpara daljes së vendimit të transferimit dhe pagimin e diferencës së pagës nga momenti i transferimit deri në sistemimin në pozicionin tjetër.

Vendimi ***nr. 59 datë 19.02.2021, protokolluar në DAP me shkresën nr.*** 275, datë 19.02.2021
Ankimimi nr. 275/1 prot, datë 02.3.2021

DAP ka ankimuar çështjen, shkresë nr. 275/1, datë 02.03.2021. Çështja është në proces.
Në përfundim rezultoi se, është pranuar padia në Shkallë të Parë. Ndaj vendimit DAP ka ushtruar të drejtën e ankimit. Aktualisht, çështja është në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

7. Për punonjësin A. M.rezultoi se:
- *para ristrukturimit mbante pozicionin si Përgjegjës Sektori në Qendrën e Thirjeve në DRT Tiranë, nivel page III-a/1*
- *Pas ristrukturimit, si Përgjegjës në Sektorin e Riskut në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, nivel page III-b.*

Paditësi A. M.ka kërkuar: Konstatimin e paligjshmërisë së transferimit të nëpunësit publik dhe rregullimin e pasojave financiare, duke kryer pagesën e diferencës së pagës që rrjedh nga transferimi (ndryshuar nga III-a/1- në III-b) për përudhen 04.08.2020 deri më 14.10.2020.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin 80-2020-3286, datë 09/12/2020 vendosi:
-Pranimin e pjesshëm të padisë.

-Detyrimin e palës së paditur Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve për ti paguar paditësit, pagesën e diferencës së pagës që rrjedh nga transferimi, (diferenca kategoria III-a/1 në kategorinë III-b), për periudhën prej datës 04.08.2020 deri në datë 14.10.2020.
-Ky vendim gjyqësor është i ekzekutueshëm nga Zyra Përmbarimore.
-Ngarkohet Zyra Përmbarimore, që të ekzekutojë plotësisht këtë detyrim.
-Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.
-U shpall sot më datë 09.12.2020, Tiranë.
Paditësi A. M.është rikthyer ne pozicionin e mëparshëm si "Përgjegjës Sektori në Qendrën e Thirjeve në DRT Tiranë" me vendim të Komisionit të Ristrukturimit nr. 10945, date 25.09.2020.

8. Prë punonjësen J. B.rezultoi se:

- *para ristrukturimit, mbante pozicionin si Inspektor i Pare, ne Sektorin Hartimit dhe Ndjekjes se Buxhetit, ne Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, ne DPT, kategoria e pagës III-b.*
- *Pas ristrukturimit, si Specialist, ne Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, ne DPT, kategoria e pagës IV-a.*

Paditësi J. B.ka kërkuar:
1. Shfuqizimin e aktit me nr. 2830/56 prot., datë 15.07.2020 të Departamentit të Administratës Publike;
2. Shfuqizimin e aktit nr. 13677/1 prot., datë 20.07.2020 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
3. Shfuqizimin e aktit me nr. 3923 prot., datë 26.08.2020, të palës së paditur Departamenti i Administratës Publike;
4. Rregullimin e pasojave financiare dhe pagesën e diferencës së pagës për gjithë periudhën e zbatimit të shkresave objekt ankimi.
5. Detyrimi i palëve të paditura të më sistemojnë në një pozicion të njëjtë dhe kategori page të njëjtë me atë që kam pasur përpara ristrukturimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me vendimin 80-2020-2927, datë 12/11/2020 *vendosi mospranimin e padisë*

9. Prë punonjësin M. A. *rezultoi se:*

1. *para ristrukturimit, mbante pozicionin si Inspektor i parë te Drejtoria e Auditimit të Brendshëm*
2. *Pas ristrukturimit, si Inspektor te Sektori i Auditimit të Këshillimit, Sigurisë së Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit*

Paditësi M. A. ka kërkuar:
1. Shfuqizimin e aktit administrative të Departamentit të Administratës Publike ñVendim nr 2830/777 prot., datë 07.10.2020 ñPër transferimin e përhershëm të M. A.ò
2. Sigurimin e padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ ñVendim nr 2830/777 prot., datë 07.10.2020 ñPër transferimin e përhershëm të M. A.ò, derisa gjykata të vendosë lidhur me ligjshmërinë apo paligjshmërinë e këtij akti.
3. Detyrimin e pales së paditur për të më rikthyer në pozicionin që kam patur para miratimit të aktit administrative të Departamentit të Administratës Publike Vendim nr 2830/777 prot., datë 07.10.2020 ñPër transferimin e përhershëm të M. A.ò.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 80-2020-3434 datë 18/12/2020 vendosi, pushimin e çështjes në Shkallë të Parë.
Paditësi M. A. është rikthyer ne pozicionin e mëparshëm si "Inspektor i parë te Drejtoria e Auditimit të Brendshëm" me vendimin nr. 10945, datë 25.09.2020 të Komisionit të Ristrukturimit

Të dhënat në tabelën e mëposhtme

Procese gjyqësore mbas procesit të ristrukturimit, në zbatim të Urdhrit nr. 24, datë 24.02.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore", bazuar në Urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"

Nr.	**Procese Gjyqësore 2020**	**Pozicioni ku ka qene paditesi perpara ristrukturimit**	**Pozicioni ku ka shkuar pas ristrukturimit**	**Statusi i gjykimit**	**Komente**
1	E. D.	Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë	Përgjegjësit të Sektorit të Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Qendror)	Pranuar padia në Shkallë të Parë dhe dhënë vendimi me ekzekutim të përkohshëm në shkallë të parë. Ndaj vendimit, DAP ka ushtruar të drejtën e ankimit të veçantë për vendimin me ekzekutim të përkohshëm dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të themelit. Aktualisht, çështjet janë në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.	Ekzekutuar nga DAP, sipas vendimit me ekzekutim të përkohshëm të dhënë nga gjykata.
2	R. K.	Inspektor i Dytë, në Sektorin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, kategoria e pagës IV-a.	Inspektor i Dytë, në Sektorin e Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Jugor), ne Drejtorine Rajonale Tatimore Fier, kategoria e pagës IV-a .	Rrëzuar padia në Shkallë të Parë	
3	Xh. T.	Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë	Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit Analizës për Masat Shtrënguese në Drejtorine e Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore te Papaguara, ne Dr e Tatimaguesve te Medhenj	Pranuar padia në Shkallë të Parë. Ndaj vendimit DAP ka ushtruar të drejtën e ankimit . Aktualisht, çështja është në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.	Nuk është njoftuar data e gjyqit nga gjykata

4	A. C.	Drejtor i Kontrollit Tatimor pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, Tiranë	Drejtor në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave	Pranuar padia në Shkallë të Parë dhe dhënë vendimi me ekzekutim të përkohshëm në shkallë të parë. Ndaj vendimit, DAP ka ushtruar të drejtën e ankimit të veçantë për vendimin me ekzekutim të përkohshëm dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit të themelit. Aktualisht, çështjet janë në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.	Ekzekutuar nga DAP, sipas vendimit me ekzekutim të përkohshëm të dhënë nga gjykata.
5	E. P.	Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve	Përgjegjës, në Sektorin e Thirrjeve (Call Center), në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.	Pranuar padia në Shkallë të Parë pjesërisht, pasi ka hequr dorë nga kthimi në detyrë dhe ka kërkuar diferenën e pagës si rezultat i aktit të transferimit. DAP nuk ka patur detyrim për zbatim vendimi pasi diferenca e pagës i është ngarkuar institucionit ku është i punësuar	DAP nuk ka detyrime
6	S. S.	Inspektor i Parë, në Sektorin e Hartimit dhe Ndjekjes së Buxhetit, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	Specialist, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, kategoria e pagës IV-a.	Pranuar padia në Shkallë të Parë. Ndaj vendimit DAP ka ushtruar të drejtën e ankimit. Aktualisht, çështja është në gjykim pranë Gjykatës Administrative të Apelit.	Nuk është njoftuar data e gjyqit nga gjykata
7	A. M.	Përgjegjës Sektori në Qendrën e Thirjeve në DRT Tiranë	Përgjegjës në Sektorin e Riskut në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj	Pranuar padia në Shkallë të Parë pjesërisht, pasi ka saktësuar objektin e padisë vetëm për dhënien e diferencës së pagës si rezultat i aktit të transferimit. DAP nuk ka patur detyrim për zbatim vendimi pasi diferenca e pagës i është ngarkuar institucionit ku është i punësuar	DAP nuk ka detyrime
8	J. B.	Inspekor i Pare, ne Sektorin Hartimit dhe Ndjekjes se Buxhetit, ne Drejtorine e Finances dhe Buxhetit, ne	Specialist, ne Drejtorine e Finances dhe Buxhetit, ne DPT, kategoria e pages IV-a.	Mospranim padie në Shkallë të Parë	

		DPT, kategoria e pages III-b.			
9	M. A.	Inspektor i parë te Drejtoria e Auditimit të Brendshem	Inspektor te Sektori i Auditimit të Keshillimit, Sigurisë së Cilësisë, Planifikimit dhe Raportimit -3	Pushuar gjykimi në Shkallë të Parë	

Burimi: DAP, përpunuar nga grupi i audituesve.

Nese i kryqëzojmë të dhënat mbi vendimet gjyqësore, **të marra** nga DAP, me ato të marra nga DPT vërejmë se ka disa mospërputhje, konkretisht në databazën e DAP nuk figurojnë 2 punonjës: Eduart Meni dhe Ahmet Idrizi; ndërsa në databazën e DPT nuk figurojnë 3 punonjës: M. A., A. H. dhe A.D.

Nr	DPT	DAP
1	A. M.	A. M.
2	E. M.	-
3	A. I.	-
4	A. C.	A. C.
5	E. D.	E. D.
6	J. B.	J. B.
7	E. P.	E. P.
8	R. K.	R. K.
9	Xh. T.	Xh. T.
10	S. S.	S. S.
11	-	M. A.
12	-	A. H.
13	-	A. D.

Për sa është trajtuar në këtë Akt-Konstatim, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 297/8 prot., datë 26.04.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- *Në zbatim të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, neni 66/1, Departamenti i Administratës Publike është institucioni i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në institucionet e administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil. Në Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015, Kreu I, pika 2 dhe Kreu II, pika 3, paragrafi nr. 2, rezulton se, DAP mbikëqyr zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në administratën shtetërore dhe monitoron plotësimin e bazës së të dhënave gjyqësore nga këto institucione. Ndërkohë, në Kreun I, pika 3, paragrafi nr. 1, të urdhrit në fjalë, parashikohet se, njësi debitore është institucioni i administratës shtetërore që mbart një detyrim të caktuar sipas një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Veprimtaria administrative e KP-së ndiqet dhe mbikëqyret prej përfaqësuesit të DAP.*

- *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka depozituar pranë DAP-it kërkesën nr. 16017 prot., datë 27.08.2019 për caktimin e përfaqësuesit të DAP në Komisionin e Posaçëm të*

ngritur pranë DPT-së. Në përgjigje të kësaj kërkese, DAP ka nxjerrë shkresën nr. 5003/1 prot., datë 30.08.2019, duke i njoftuar DPT-së nëpunësin e autorizuar për këtë veprimtari administrative. Në vijim të kësaj korrespondence, nga ana e DPT-së është njoftuar mbledhja e KP-së për në datën 17.09.2019, dokumentuar me procesverbalin respektiv. Pas kësaj mbledhjeje DPT-ja nuk ka depozituar apo njoftuar mbledhje të radhës së KP-së, si një detyrim i përcaktuar në Urdhrin nr. 5151/2015. Nga sa më lart veprimet administrative të kryera nga Departamenti i Administratës Publike kushtëzohen nga veprimtaria administrative e Komisioneve të Posaçme, të ngritura pranë institucioneve gjyqhumbëse/debitore të administratës shtetërore

- *Lidhur me* ***mënyrën e kryerjes së rolit mbikëqyrës të DAP-it, në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore,*** *sjellim në vëmendjen tuaj se, të gjitha veprimet administrative që duhet të kryhen parashikohen në Kreun V të Urdhrit nr. 5151/2015. DAP në rolin e mbikëqyrësit të zbatimit të vendimeve gjyqësore, në mënyrë periodike, kërkon nga institucionet e administratës shtetërore përditësimin e të dhënave të gjyqfituesve në platformën e bashkëpunimit ëëë.administrata.al. Arsyeja e ngritjes së kësaj platforme është administrimi i një informacioni të plotë, për çdo gjyqfitues, si dhe monitorimi i procedurave administrative të institucioneve për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë. DAP, nëpërmjet personit të kontaktit kërkon përditësim të vazhdueshëm të të dhënave sipas rubrikave respektive në këtë platformë, marrë në konsideratë faktin që DAP nuk është palë ndërgjyqëse në çdo proces gjyqësor dhe nuk ka informacion të plotë në lidhje me gjyqfituesit e institucioneve të administratës shtetërore. DAP-i, me çdo formë komunikimi me institucionet e administratës shtetërore, kërkon në mënyrë të vazhdueshme ngritjet e Komisioneve të Posaçme, shqyrtimin e mundësive të sistemimit të gjyqfituesve, sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara në Urdhrin nr. 5151/2015. Nëpërmjet përfaqësuesve të tij, DAP i orienton institucionet në cilësinë e palës debitore, për kryerjen, sipas akteve nënligjore, të procedurave administrative për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, sipas kritereve të përgjithshme e të posaçme që gëzon gjyqfituesi.*

- *Në lidhje me ankesën e trajtuar në Akt-Konstatimin nr. 4, në observacionin e subjektit thuhet:Sipas Kreut IV të urdhrit në fjalë, Komisioni i Posaçëm shqyrton tërësinë e rrethanave të faktit që lidhen me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke përfshirë këtu vendimin e formës së prerë, të dhënat e gjyqfituesit, si arsimi, përvoja, certifikatat, vendbanimi, vendet vakante në adminisratën tatimore, së bashku me kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të tyre, etj. Pasi shqyrton rrethanat e faktit, KP-ja krahason kriteret e vendeve të lira në raport me dosjen e gjyqfituesit, me qëllim që ta sistemojë atë në një nga pozicionet e rregullta të shërbimit civil. Pasi vlerëson sistemimin e gjyqfituesit në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, KP-ja i propozon gjyqfituesit pozicionin e lirë. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, KP-ja përcjell akt-rekomandimin pranë Departamentit të Administratës Publike, që njësia përgjegjëse të procedojë me veprimet sipas Kreut V të Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015, duke nxjerrë aktin e emërimit apo kthimin pas të akt-rekomandimit. Gjithashtu, me shkresën nr. 2195/1 prot., datë 08.04.2021, DAP-i ka sqaruar zyrtarisht z. Xhebexhia, duke mbajtur për dijeni Kontrollin e Lartë të Shtetit, DPT-në dhe përmbaruesin gjyqësor se, "Komisioni i Posaçëm ka përcjellë pranë Departamentit të Administratës Publike akt–rekomandimin në pozicionin Inspektor i Dytë në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës, kategoria e pagës IV-a, pozicion i barazvlefshëm me pozicionin e mbajtur përpara largimit nga shërbimi civil. Bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, Komisioni i Posaçëm i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka propozuar sistemimin e z. Xhebexhia në një pozicion pune të kategorisë ekzekutive, duke gjetur kështu një zgjidhje të përshtatshme, në referim të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e cila në paragrafin nr. 37 të Vendimit nr. 63/2017 ka arsyetuar ndër të tjera "se i takon palës debitore të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së palës kreditore. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësi objektive për të*

mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë"

- *Në observacion theksohet "Sjellim në vëmendjen tuaj se, ankesa e z. M. Xh., lidhur me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 469, datë 25.06.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër, të lënë në fuqi me Vendimin nr. 701, datë 07.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, mban datën 30.03.2021, është protokolluar në institucion më datë 01.04.2021 dhe nuk përfshihet në periudhën e auditimit të përputhshmërisë të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me programin e auditimit me nr. 297/1 prot., datë 26.02.2021. Sipas këtij programi, periudha e auditimit përcaktohet nga data 01.01.2019- 31.12.2020, ndërkohë që ankesa e gjyqfituesit shtrihet jashtë periudhës së auditimit, respektivisht në muajt mars - prill të vitit 2021. Po ashtu, edhe me shkresën nr. 297/3 prot., datë 29.03.2021 të KLSH-së me lëndë: "Njoftim për ndryshim program auditimi", drejtuar DAP-it, megjithëse ka ndryshuar afati i përfundimit të auditimit nga data 30.03.2021, në datën 16.04.2021, nuk rezulton që të ketë ndryshuar periudha e auditimit apo tematika e tij".Si rezultat, vlersojmë se ankesa e z. Xhebexhia nuk mund të ishte pjesë e veprimtarisë administrative të këtij Grupi Auditimi, e t`i bashkëlidhej rezultateve të akt-konstatimit nr. 4, datë 16.04.2021.*

Qendrimi i grupit të auditimit:

- *Sikurse edhe citohet në observacion, roli i DAP është një rol mbikëqyrës. Nga auditimi dhe dokumentacioni i servirur nga subjekti u konstatua theksohet se pas datës 17.09.2019, DPT-ja nuk ka depozituar apo njoftuar mbledhje të radhës së KP-së, si një detyrim i përcaktuar në Urdhrin nr. 5151/2015.*
- *Gjithashtu theksohet se DAP nuk është palë ndërgjyqëse në çdo proces gjyqësor dhe nuk ka informacion të plotë në lidhje me gjyqfituesit e institucioneve të administratës shtetërore, ndërkohë që sipas Urdhrit nr. 5151, DAP duhet të mbikëqyr procesin ndërsa institucioni debitor duhet ta njoftoje DAP-in brenda afateve te parashikuar per cdo përditësim tëstatusit te vendimeve.Administrata tatimore mban përgjegjësipërmos njoftimin nëkohe, por edhe DAP përmos aplikimin e mekanizmave per te përmbushur detyrat e parashikuara.*
- *Në rastin e ankesës së trajtuar në Akt-Konstatimin nr.4, Grupi i auditimit mendon se mund të ishte bërë një sistemim më i hershëm me qëllim minimizimin e efektit financiar negativ në dëm të buxhetin e shtetit. Për këtë , observacioni mund të merret parasysh pjesërisht*
- *Përsa i përket pretendimit të DAP për periudhën e shtrirjes së auditimit që është 01.01.2019-31.12.2020 dhe datës së protokollimit të ankesës që është 01.04.2021, vëmë në dijeni se vendimi gjyqësor të formës së prerë nr. 469, datë 25.06.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër, i lënë në fuqi me Vendimin nr. 701, datë 07.03.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për gjyqfituesin M. Xh., është brenda periudhës së auditimit.*

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.4, datë 16.04.2021

Për sa është trajtuar në materialin e grupit të auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 297/11 prot., datë 30.08.2021, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:
Pretendimi i subjektit:

1. *Në vijim të këtij argumenti sqarojmë se, Vendimi nr. 833, datë 28.10.2020 i Këshillit të Ministrave ka përcaktuar rregulla të detajuara për hedhjen, plotësimin dhe përditësimin e të dhënave në platformën e bashkëpunimit ëëë.administrata.al, mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë, ku respektivisht pika 13, e Kreut III, të tij përcakton se: "Platforma e bashkëpunimit "ëëë.administrata.al" është mjeti me anë të të cilit institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore raportojnë periodikisht të dhënat për llogaritjen e indikatorëve bazë të menaxhimit të burimeve njerëzore", ndërsa pika 6, e Kreut IV, të tij, parashikon se: "Institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin të përdorin platformën e bashkëpunimit "ëëë.administrata.al" për sa është përcaktuar në pikat 12 e 13, të kreut III, të këtij vendimi".Gjithashtu, nëpërmjet shkresës nr. 4260/1 prot., datë 29.07.2021, Departamenti i*

Administratës Publike, i ka rikujtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve përmbushjen e detyrimit të përditësimit të vazhdueshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në platformën e bashkëpunimit ëëë.administrata.gov.al, si dhe ka informuar këtë institucion se, personi i kontaktit në Departamentin e Administratës Publike, në dispozicion për çdo paqartësi apo problematikë është znj. L. K, me detyrë Specialiste në Sektorin e Ankesave Administrative dhe Gjyqësore, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore.

2. *Lidhur me rastin e ankesës së gjyqfituesit z. M. Xh., me anë të shkresës nr. 8457 prot., datë 11.05.2021, ka informuar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve mbi faktet dhe rrethanat e reja të ndodhura mbas marrjes së vendimit të formës së prerë, konkretisht ndryshimi i vendbanimit të gjyqfituesit nga qyteti i Kukësit në Tiranë. Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. 8457/1 prot., datë 25.06.2021 ka propozuar sistemimin e këtij gjyqfituesit në pozicionin "Inspektor i Parë, në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë". Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 3862/1 prot., datë 09.07.2021 ka vendosur transferimin e z. M. Xh., në pozicionin Inspektor i Parë, në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, duke përmbushur në mënyrë përfundimtare detyrimin që rrjedh nga vendimi nr. 701, datë 07.03.2019 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për t`a sistemuar këtë gjyqfitues në pozicionin që ka patur si dhe brenda të njëjtës kategori e klasë page. Për sa më sipër, edhe ky konstatim i grupit të auditimit rezulton që të jetë përmbushur nga DPT në bashkëpunim me DAP-in.*

Qendrimi i grupit të auditimit:
1. *Në observacione nuk paraqitet asnjë dokumentacion plotësues ose bazë ligjore që nuk është marrë parasysh nga grupi i auditimit në material.*
Nga observacionet e subjektit, trajtohet shpesh Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e hollësishme, për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit", ku institucionet e administratës shtetërore duhet të raportojnë në mënyrë të detajuar të dhënat mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë përmes përmes platformës së bashkëpunimit ëëë.administrata.gov.al,.
Por siç edhe përmendet në observacion Vendimit nr. 833 datë 28.10.2020 kur periudha objekt auditimi është 01.01.2019 – 31.12.2020.
Vlen të përmendet që në auditim janë trajtuar proceset gjyqësore të ardhura si pasojë e ristrukturimit në periudhën objekt auditimi. Pra auditimi kryer është për periudhën para dhe pas daljes së Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e hollësishme, për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit" ku detyron institucionet e administratës shtetërore të raportojnë në mënyrë të detajuar të dhënat mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë.
Nga auditimi kryer është konstatuar që si para por edhe pas daljes së Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e hollësishme, për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit" DAP nuk ka ngritur dhe si pasojë as ka implementuar mekanizmat e nevojshëm, në mënyrë që të përmbushë detyrimin për të monitoruar plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësore nga njësia debitore, duke pritur vetëm informacionin nga njësia debitore, por pa e kërkuar dhe verifikuar informacionin në mënyrë aktive, pasi kemi konstatuar mungesë informacioni të DAP-it për gjyqfituesit për raste kur DAP nuk ka qenë palë në proces",
Gjithashtu Grup i auditimitthekson se mbi raportimin mbi proceset gjyqësore përgjeqësia është e DPT-së, por kërkohet një rol më aktiv monitorues nga ana e DAP, sidomos për ato procese kur DAP nuk është palë ndërgjyqëse.
Sa më sipër, observacioni nuk merret parasysh.

2. *Për sa i përket ankesës sëgjyqfituesit z. M. Xh., sipas observimeve, por pa dokumentacion shkresor bashkangjitur, observacioni merret pjesërisht në konsideratë.*

Titulli i gjetjes 1: Roli i DAP në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore si

	pasojë e ristrukturimit Nga auditimi rezultoi se, nga **9** procese gjyqësore të nisura si pasojë e ristrukturimit të tretë: - 3 procese janë nderprerë dhe punonjësit janë rikthyer në pozicionin e mëparshëm me vendim te Komisionit të Ristrukturimit, çfarë tregon edhe njëherë vendimmarrjen e gabuar te këtij Komisioni; - 2 procese janë finalizuar me vendim te përkohshme ku edhe këtu 2 punonjesit-padites janë rikthyer në punë; - 2 procese kanë përfunduar në shkallë të parë, në favor të nëpunësve-paditës, dhe - vetëm 2 padi rezultojnë të jenë rrëzuar (edhe këto janë në proces apelimi). Sa më sipër tregojnë për vendimmarrje të paargumentuara ligjërisht, të cilat e vendosin institucionin përpara riskut të krijimit të detyrimeve për ekzekutime të vendimeve gjyqësore Gjithashtu rezultoi se, referuar data bazës së vendimeve gjyqësore të administruara nga DAP, si pasojë e ristrukturimeve në administratën tatimore, kanë nisur 11 procese gjyqësore , për punonjës me status të nëpunësit civil, nga të cilat **2** nga ristrukturimi i parë dhe **9** nga ristrukturimi i 3-te. Nëse i referohemi te dhënave nga DPT, në fakt kanë nisur gjithsej 10 procese (nga të cilat dy janë për gjykim në shkallë të parë dhe 8 në shkallë të dytë), dhe jo 11, sikundër konfirmon DAP.
Situata:	Duke krahasuar të dhënat e marra nga DAP me ato nga DPT[22] mbi vendimet gjyqësore, vërejmë se ka disa mospërputhje, konkretisht në data bazën e DAP nuk figurojnë 2 punonjës: E. M. (per gjykim ne shkallë të parë) dhe A. I. (pushim i cështjes në shkallë të dytë); ndërsa në data bazën e DPT nuk figurojnë 3 punonjës: M. A. (Pushuar gjykimi në Shkallë të Parë), A. H (Rrëzuar padia në Shkallë të Parë) dhe A. D. (Rrëzuar padia në Shkallë të Parë). Në vijim të sa më sipër, nga verifikimi i te dhënave te DAP konstatojmë se, në data bazën e vendimeve gjyqësore nuk ka informacion **<u>mbi gjendjen juridike te pozicionit te punës</u>**, pas largimit të nëpunësve në fjale, sipas kërkesave te urdhrit 5151/2015, ku në bazën e të dhënave gjyqësore të plotësuara nga njësia debitorë (DPT) duhet të shprehet gjendja juridike e pozicionit të punës pas largimit të punonjësit (***dhe jo pozicioni ku ka qene punonjësi para dhe pas ristrukturimit)*** sipas statusit: ñpozicioni nuk ekzistonò, ñi bashkuar me pozicione të ngjashmeò, ñndryshim kritereshò si dhe ñshkaku ligjor për të cilin është zënë vendi i punësò. Këto të dhëna duhet të përditësohen dhe në këtë formë duhet tõ vihen në dispozicion DAP-it brenda dy ditëve pune, nga momenti i përditësimit. <u>DAP më pas monitoron plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësorëe.</u> Nga auditimi nuk na rezultoi nëse DAP në rolin e mbikëqyrësit të zbatimit të vendimeve gjyqësore, në mënyrë periodike, të ketë kërkuar nga DPT përditësimin e të dhënave të gjyqfituesve në platformën e bashkëpunimit sipas të gjithë kritereve që kërkon Urdhri 5151, date 28.10.2015.
Kriteri:	Urdhri nr. 5151, date 28.10.2015
Ndikimi/Efekti	Vendimmarrje e paargumentuar plotësisht; mungesa e mbikëqyrjes nga DAP
Rëndësia	E mesme
Rekomandime	-Në çdo rast, DPT të njoftojë DAP brenda ditës nga depozitimi i kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit/përfaqësuesit

[22] Nga grupi i auditimit qe auditoi ne DPT, mbështetur mbi programin e auditimit nr. 298/1prot, date 02.03.2021

ligjor/përmbaruesit, për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Gjithashtu DPT të marrë masa për përditësimin e të dhënave për vendimet gjyqësore dhe brenda dy ditëve pune nga cdo përditësim, të bëjë me dije DAP.

-DAP të ngrejë të gjithë mekanizmat e nevojshëm, në mënyrë që të përmbushë detyrimin për të monitoruar plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësore nga Njësia debitorë që të përfshijë informacion **mbi gjendjen juridike te pozicionit te punës**, pas largimit të punonjësit sipas statusit: ñpozicioni nuk ekzistonò, ñi bashkuar me pozicione të ngjashmeò, ñndryshim kritereshò si dhe ñshkaku ligjor për të cilin është zënë vendi i punësò dhe të tjera informacione që dikton kuadri rregullator në fuqi.

Titulli i gjetje 2: Mungesa e pjesëmarrjes së DAP në Komisionin e Posaçëm

Situata:

Nga auditimi rezultoi se v**eprimtaria administrative e Komisionit të Posaçëm, nuk është ndjekur dhe vëzhguar nga DAP në të gjitha rastet, në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit 5151/2015 "**Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civilò**,** pasi ngadata 27.08.2019 e në vazhdim, DAP nuk është njoftuar nga DPT për mbledhjet e komisionit të Posaçëm, edhe pse rezultoi se këto komisione kanë vepruar duke lënë edhe akt-rekomandimet përkatëse. Pas administrimit të kërkesave për pjesëmarrje në Komisionet e Posaçme (zyrtarisht me shkrim apo përmes komunikimit elektronik), Drejtori i Drejtorisë së Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative e Gjyqësore në DAP përzgjedh nga radhët e nëpunësve të Sektorit të Ankesave Administrative dhe Gjyqësore përfaqësuesin e DAP që ngarkohet me cilësinë e vëzhguesit apo mbikëqyrësit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm sipas Urdhrit nr.5151 datës 28.10.2015, Kreu IV në të cilin theksohet se *Komisioni i Posaçëm vëzhgohet nga përfaqësuesi i DAP-it*

Në përputhje me procedurën e mësipërme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) ka depozituar pranë DAP-it kërkesën nr. 16017 prot., datë 27.08.2019 për caktimin e përfaqësuesit të DAP në Komisionin e Posaçëm të ngritur pranë DPT-së. Në përgjigje të kësaj kërkese, DAP ka nxjerrë shkresën nr. 5003/1 prot., datë 30.08.2019, duke i njoftuar DPT-së nëpunësin e autorizuar për këtë veprimtari administrative. Në vijim të kësaj korrespondence, nga ana e DPT-së është njoftuar mbledhja e Komisionit të Posaçëm për në datën 17.09.2019, dokumentuar me procesverbalin respektiv në DPT. ***Pas kësaj mbledhjeje DPT-ja nuk ka depozituar apo njoftuar mbledhje të radhës së Komisionit të Posaçëm***.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se Komisioni i Posaçëm është krijuar edhe pas datës 17.09.2019, por pa informuar DAP dhe si rrjedhojë edhe pa përfaqësuesin e DAP-it. Konkretisht, rezultojnë 6 procesverbale te mbledhjeve te Komisionit të Posaçëm pa praninë e përfaqësuesit të DAP[23] për vitin 2020, dhe 3, për vitin 2021[24].

[23] Viti 2020:Procesverbalet
Nr. 12530 prot, datë 03.07.2020
Nr. 13627 prot, datë 17.07.2020
Nr. 16557 prot, datë 25.08.2020
Nr. 22334 prot, datë 19.11.2020
Nr. 23224 prot, datë 10.12.2020
Nr. 23750 prot, datë 15.12.2020

[24] Viti 2021: Procesverbale

	Nisur nga sa me sipër konkludojmë se, shqyrtimi i fakteve të lindura pas marrjes së vendimeve të formës së prerë, nëpërmjet Komisionit të Posaçëm përkatës, pas datës 27.08.2019, është një proces jo i plotë, për sa kohë nuk është vëzhguar nga DAP.
Kriteri:	Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 ñPër zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civilò
Ndikimi/Efekti	Procesi i cenuar; i realizuar pa një hallke kontrolli (mbikëqyrjen e DAP)
Shkaku	Mos njoftimi i DAP nga ana e DPT, mbi mbledhjet e Komisionit të Posaçëm
Rëndësia	E lartë
Rekomandime	Komisioni i Posaçëm, në çdo rast, veçanërisht për rastet e proceseve gjyqësore si pasojë e ristrukturimeve-objekt i këtij auditimi, brenda dy ditëve pune nga depozitimi i kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit/përfaqësuesit ligjor të tij/të përmbaruesit gjyqësor, për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, duhet të njoftoje DAP-in, i cili ka për detyrë më pas të vëzhgoje Komisionin e Posaçëm.

2.4 TË TJERA GJATË AUDITIMIT

Me shkresën nr 412 prot., datë 01.04.2021, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr.412, prot., date 02.04.2021, është administruar akesa z. M. Xh., ish punonjës në Drejtorine rajonale Tatimore, Kukës I cili ka ka qënë i emëruar në pozicionin si ñInspektor I Parë në Drejtorinë e Kontrollitò në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Kukës.

Me anë të vendimit nr.691, datë 13.10.2017, Komisioni Disiplinor pranë Drejtorisë së Përgjithme të Tatimeve merr vendimin për largimin e z. M. Xh..

Z. M. Xh. padit Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore dhe fiton Titullin Ekzekutiv me Vendimin nr.469, datë 25.06.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ku vendos

1. Rikthimin e Paditësit z. M. Xh. në pozicionin e mëparshëm të punës si ñInspektor I Parë në Drejtorinë e Kontrollitò në Drejtorine Rajonale Tatimore, Kukës ose në një detyrë të barazvlefshme me të.
2. Detyrimin e Palës së Paditur (Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve) për ti paguar pagën bruto që nga data 01.11.2017 e deri në datën e rikthimit të tij në punë.

Ky vendim I sipërcituar ka hyrë në fuqi më datë 07.03.2019 pasi Gjykata Administrative e Apelit, Tiranëme anë të vendimit nr.701, datë 07.03.2019 ka lënë në fuqi vendimin nr.469, datë 25.06.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër, pra

3. Rikthimin e Paditësit z. M. Xh. në pozicionin e mëparshëm të punës si ñInspektor i Parë në Drejtorinë e Kontrollitò në Drejtorine Rajonale Tatimore, Kukës ose në një detyrë të barazvlefshme me të.
4. Detyrimin e Palës së Paditur (Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve) për ti paguar pagën bruto që nga data 01.11.2017 e deri në datën e rikthimit të tij në punë.

Ky vendim është një Titullin Ekzekutiv, prandaj është I ekzekutueshëm nga Përmbaruesi gjyqësor që nga dita që Vendimi merr formë të prerë.

Sipas dokumentacionit të servirur edhe nga Departamenti i Administratës Publike vendiñInspektor I Parë në Drejtorinë e Kontrollitò në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Kukës, ka qenë vend vacant që me largimin e Gjyqfituesit z. M. Xh. dhe vazhdon të jetë një vend vacant edhe në këto momente.

Sipas shkresës nr.2970 prot., datë 23.10.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si dhe Departamenti i Administratës Publike, Drejtoria Rajonale Tatimore, Kukës kërkon plotësimin e vendeve vakante.

Nr.19513/3prot, datë 28.01.2021
Nr. 24226/3 prot, datë 11.02.2021
Nr 23325/4 prot, datë 09.03.2021

Në shkresë sqarohet se pas ristrukturimeve struktura e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Kukës përbëhet nga 29 punonjës. Por theksohet se në përbërje të sajë ka vetëm 21 punonjës. Gjithashtu theksohet se ëto vakanca janë krijuar për arsye të largimit të punonjësve që nga viti 2013 e në vijim në sector të ndryshëm.
Sipas shkresës shihet që edhe pozicioni ñInspektor I Parë në Drejtorinë e Kontrollitò është një vënd vacant.
Por Gjyqfituesi është në pritje të sistemimit në Administratën Tatimore, edhe pse sipas vendimit nr.701, datë 07.03.2019, detyron e Palën e Paditur (Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve) për ti paguar pagën bruto që nga data 01.11.2017 e deri në datën e rikthimit të tij në punë. Pra paguhet edhe pse pozicioni i vendosur sipas vendimit nr.701, datë 07.03.2019, rikthimin e paditësit z. M. Xh. në pozicionin e mëparshëm të punës si ñInspektor i Parë në Drejtorinë e Kontrollitò në Drejtorine Rajonale Tatimore, Kukës ose në një detyrë të barazvlefshme me të, ka qenë pozicion vacant ndërkohë që gjyqfituesi ka vazhduar të paguhej nga Buxheti i Shtetit një Gjyqfitues që mund të ishte emëruar në pozicionin e shpallur në vendimin nr.701, datë 07.03.2019.

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET
A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Administrata Tatimore Qendrore, në bazë të urdhrave të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr. 126 datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"*, gjatë periudhës janar 2019 - dhjetor 2020, ka pësuar 3 herë ndryshime në strukturë dhe organikë, respektivisht: ristrukturimi i parë është bërë me urdhrin nr. 49, datë **27.02.2019**, ristrukturimi i dytë është bërë me urdhrin nr. 86, datë **03.05.2019**, ristrukturimi i tretë është bërë me urdhrin nr. 33, datë **12.02.2020**. Nga auditimi mbi respektimin e procedurave të ndjekura për këto ndryshime strukturore e organizative, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 893, datë 17.12.2014 ñ*Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm*ò u konstatuan se DAP ka dhënë miratimet për këto ndryshime në mungesë të informacionit justifikues për domosdoshmërinë dhe objektivitetin e këtyre ndryshimeve dhe në mungesë të informacionit për kostot e llogaritura dhe efektet financiare që do të vinin nga këto ndryshime. Konkretisht:
1. Gjatë procesit (hapat e ndjekura për ristrukturimin e parë) u konstatua se mungojnë:
- Mendimet nga MFE për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara[25].
- Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi[26].
- Analiza sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara[27];
- Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit, referuar kriterit të parashikuar në pikën 33/d të VKM nr. 893, datë 17.12.2014[28].
2. Për ristrukturimin e dytë, u konstatua se mungon:
- Analiza sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara në kundërshtim me pikën 33/ç të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014;
3. Për ristrukturimin e tretë, u konstatua se mungojnë:
- Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi[29].
Në kushtet kur kemi konstatuar se disa nga rekomandimet e DAP qëndrojnë bazuar në VKM nr.187 datë 08.03.2017 (lidhja 6/8) por, ***DPT nuk i ka marrë në konsideratë*** dhe ka vijuar me miratimin e organigramës sikundër e ka propozuar vetë, roli i DAP në këtë proces ka qenë jo

[25] Sipas pikës 33/b të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[26] Sipas pikës 33/c të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[27] Sipas pikës 33/ç të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[28] Sipas pikës 33/d të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014
[8]Sipas pikës 33/c të VKM nr. nr. 893, datë 17.12.2014

reagues. Për sa më sipër, gjykojmë se nevojitej dakordësimi midis DAP dhe DPT për kategorinë e pagave të ATQ, sipas lidhjes 6/8, siç përcakton ***pika 36 e VKM nr. 893 datë 17.12.2014***, e citon se: ñNë rast se ka qëndrime të kundërta ndërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike dhe, sipas rastit, tôi reflektojë ose të argumentojë mosreflektimin e tyre. Në rast se vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave organizon një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneveò. (*trajtuar më hollësisht në faqet 16-24 të Raportit*)

1.1. Rekomandimi: Për të gjitha rastet në vijim, Departamenti i Administratës Publike nuk duhet të marrë në shqyrtim propozime për ndryshimin e strukturës, bashkëlidhur të cilave mungojnë të dhënat si:
- Mendime për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara;
- Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;
- Analizën sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara;
- Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit.

1.2. Rekomandimi: Për të gjitha rastet në vijim, nëse ka qëndrime të kundërta ndërmjet DAP dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e DAP dhe tôi reflektojë ose të argumentojë mos reflektimin e tyre. Në rast se vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, DAP të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave për të organizuar një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, **komunikimet shkresore mes DAP dhe MFE-së për çështje të ristrukturimit (**referuar këtu shkresës nr. 2386/1 prot., datë 30.04.2019 dhe shkresës nr. 2495/1 prot., datë 03.05.2019),edhe pse kanë lidhje organike ndërmjet tyre **nuk ndjekin të njëjtin numër protokolli,**në kundërshtim me nenin 19, pika 1, e ñNormave teknikо-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò, hartuar në mbështetje të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 ñPër arkivatò, në pikën 1 të të cilit kërkohet që: ñ*Dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre marrin në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1) një numër rendor të veçantë. Dokumenti i parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, merr numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të, evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës. Nuk lejohet evidencimi në një numër i dy ose më shumë praktikave të përafërta që janë të pavarura ndërmjet tyre sipas objektit"*. (*trajtuar më hollësisht në faqet 16-24 të Raportit*)

2.1 Rekomandimi: Në të gjitha rastet në vijim, për dokumentet që formojnë një praktikë dhe që kanë lidhje organike ndërmjet tyre, njësia përgjegjëse për protokollimin e shkresave në DAP, duhet që për dokumentin e parë që krijohet nga vetë organi apo që vjen në adresë të tij, tôi japë një numër rendor të plotë, ndërsa dokumentet e tjera që kanë lidhje me të, të evidencohen me të njëjtin numër e progresivisht me fraksion deri në mbylljen e praktikës.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi për ndjekjen e procedurave për shpalljen e vakancave nga DAP, për plotësimin e strukturës së ATQ, në përputhje me kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò, konstatohet se organika e punonjësve me status të nëpunësit civil të ATQ, sipas strukturës së vjetër (para janarit të vitit 2019) ka qenë me 1569 punonjës. Në fakt deri në

janar të vitit 2019, numri i punonjësve në organikë ka qenë i plotësuar me 1400 punonjës, pra me 169 punonjës më pak, ose me 169 pozicione pune vakante.
Në ristrukturimin e parë, miratuar me urdhrin nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore"*, struktura dhe organika e re e miratuar, bëhet 1512 pozicione, nga 1569 që ishin përpara këtij ristrukturimi.
Në ristrukturimin e dytë, miratuar me urdhrin nr. 86, datë 03.05.2019 të Kryeministrit *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* struktura dhe organika e re, u bë 1512 pozicione pune, numër i njëjtë ky me pozicionet e strukturës së mëparshme, por me ndryshime në emërtesa dhe riorganizime të drejtorive dhe sektorëve.
Në Dhjetor 2019,pas ristrukturimit të dytë, numri total i punonjësve në strukturën plan ishte 1512, në diferencë me strukturën fakt, prej 156 pozicione vakante, në punonjës me status nëpunësi civil, ose 13 pozicione **më** pak nga sa kishte **në** fillim **të** vitit 2019 dhe përpara ristrukturimit të parë. Pavarësisht numrit të konsiderueshëm të vakancave, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e DPT ka pasqyruar në sistemin HRMIS dhe publikuar në platformën administrata.al, në periudhën 04 Nëntor ï 17 Dhjetor të vitit 2019, vetëm 12 pozicione vakante, të shpallura më pas nga DAP (nga 156 vakanca që ka gjithsej), duke mos përmbushur detyrat që i ngarkon Lidhja 3 e VKM nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò.
Nga ana tjetër, konstatojmë se DAP nuk ka përmbushur detyrat që i ngarkon Lidhja 3 e VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, *"Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*ò, ku ndër të tjera citohet: Pika 1. a) *DAP është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë së pandërprerë dhe mirëfunksionimin e Regjistrit Qendror të Personelit. b) Mbikëqyr dhe monitoron veprimet që kryhen në Regjistrin Qendror të Personelit në përgjithësi.*
Regjistri Qëndror i Personelit (RQP) dhe platforma e bashkëpunimit ñadministrata.alò shërbejnë si burim informacioni apo mjet kontrolli për DAP-in, por edhe për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për realizimin e funksioneve të tyre lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe në kushtet e mungesës së një informacioni të tillë, edhe detyrat funksionale të këtyre institucioneve në lidhje me këtë çështje, rrezikojnë të cënohen.
Në vijim, rezultoi se në muajin **Janar 2020**, paraqiten **137 pozicione vakante** në punonjës me status të nëpunësit civil, ndërsa numri i strukturës plan është i njëjtë me atë të muajit dhjetor 2019 (1512 punonjës, ndërsa 1341 është numri i strukturës fakt).
Në ristrukturimin e tretë,miratuar me urdhrin nr. 33, datë 12.02.2020 të Kryeministrit ñ*Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* struktura dhe organika e re e miratuar bëhet gjithsej 1450 pozicione, nga 1512 që ishin në strukturën e mëparshme. Ndërsa në**Dhjetor 2020,** rezultuan gjithsej **186 pozicione vakante** me status nëpunësi civil (ose 49 vakanca më shumë krahasuar me janar 2020).(*trajtuar më hollësisht në faqet 26-32 të Raportit*)

3.1 Rekomandimi: DAP të ushtrojë të gjitha kompetencat që i njeh ligji në rolin e administratorit të përgjithshëm të Regjistrit Qendror të Personelit (RQP), për të mbikëqyrur dhe monitoruar përmes mekanizmave të raportimit, veprimet që kryhen në RQP në përgjithësi, si dhe ndërveprimin me burimet e të dhënave që përdoren në platformë; gjithashtu për të menaxhuar modulet për ndjekjen e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore (proceset e rekrutimit, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të përshkrimeve të punës, të vlerësimit të rezultateve në punë, si dhe të çështjeve gjyqësore dhe të vendimeve gjyqësore të formës së prerë) në platformën e bashkëpunimit ñadministrata.alò.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për të tre ristrukturimet e kryera në ATQ në periudhën 2019-2020, MFE ka përcjellë shkresa DAP-it për mendime, propozime *"Për disa ndryshime në urdhrin nr.126 datë 02.08.2016, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore",* duke i bashkëngjitur projekt-urdhrin për ndryshimin e

strukturës organizative të ATQ dhe relacionin me arsyet e nevojës për këtë ndryshim. DAP-i, në të gjitha korrespondencat me MFE, ka kthyer përgjigje pasi ka shqyrtuar propozimin për ndryshimin e strukturës të ATQ dhe ka sugjeruar rishikimin e praktikës në dy pikëpamje: a) sa i takon hartimit dhe propozimit të aktit, i cili duhet të përmbajë projektstrukturën me skemat hierarkike organizative vertikale dhe horizontale dhe numrin e përgjithshëm të personelit të ATQ; dhe b) nga pikëpamja teknike. Në këto korrespondenca, në asnjë rast nuk rezulton të përmendet krijimi i hapësirave për gjyqfituesit, as nga DPT dhe as nga DAP, me qëllim menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të cilat rrezikojnë të përdoren për likuidimin e vendimeve gjyqësore për largimet e padrejta nga puna. (*trajtuar më hollësisht në faqet 16-24 të Raportit*)

4.1 Rekomandimi: Në kushtet kur,DAP ndër të tjera, ka detyrimin edhe të mbikëqyrjes së procesit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, sipas urdhrit nr. 5151 datë 28.10.2015 ñ*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil",* rekomandojmë që, me qëllim marrjen e masave për menaxhimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, gjatë procedurave të ristrukturimit, DAP dhe institucionet e tjera të përfshira, të vlerësojnë edhe alternativat që mundësojnë rikthimin në detyrë të nëpunësve civil gjyqfitues.

Deri më 31.12.2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se:

- **Në Ristrukturimin e Parë**: Komisioni i Ristrukturimit (KR) të Administratës Tatimore Qendrore, me Vendimin nr. 7525 prot., datë 09.04.2019, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë, në kuadër të ristrukturimit, i ka propozuar DAP-it, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, transferimin e përhershëm të 43 nëpunësve civilë, brenda administratës tatimore, në pozicione vakante.

Në propozimin e KR, përveç ri pozicionimit direkt të nëpunësve civilë në pozicione pune sipas strukturës së re, të cilët kanë të njëjtin përshkrim pune të njëjtë ose të ngjashëm me atë ku janë aktualisht nëpunësit, ose lëvizjeve në zbatim të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, për transferimin e nëpunësve në strukturat e AKSHI-t, vihen re disa transferime ku ka ndryshime në pozicion, drejtori/ sektorë ose nivel page.

Nga auditimi janë konstatuar **6** raste të transferimeve të nëpunësve civilë, duke pësuar ndryshime në sektorë/ drejtori, pozicion pune e nivel page, ku konkretisht janë **5** nëpunës të transferuar nga sektori/zyra e IT-së në sektorë të tjerë, duke kaluar nga pozicioni i punës specialist, në Inspektorë, çka ka rezultuar në rritje të nivelit të pagës për punonjësit dhe qëndrim brenda shërbimit civil. Ndërkohë nga i njëjti sektor/ zyrë, pjesë e Administratës Tatimore, shkrirja e sektorit të IT bëri që 43 nëpunës të transferohen pranë AKSHI-t, duke përfunduar marrëdhëniet e punës në shërbim civil. **Në Vendim nuk ka asnjë praktikë bashkëlidhur, për të dokumentuar ku u bazua Komisioni për të përzgjedhur brenda të njëjtit sektor/ zyrë, nëpunësit që do të transferoheshin brenda institucionit, dhe atyre që u transferuan te AKSHI, të cilëve iu ndërpre marrëdhënia e punës në shërbim civil,** edhe psenë Vendim citohet se Komisioni i Ristrukturimit e mori vendimin pasi mori në shqyrtim përshkrimet e punës dhe kriteret e veçanta të stafit aktual, si dhe përshkrimet e punës dhe kriteret e veçanta për pozicionet e ristrukturuara. Për këto Vendime të marra nga ana e KR, ka patur 4 ankime nga nëpunës, të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil, si dhe ka 2 procese gjyqësore.

- Në Ristrukturimin e Dytë: Me Urdhrin nr. 32, datë 10.05.2019, nr. 2585/1 prot., datë **10.05.2019**, Drejtori i DAP ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit.

Me Vendimin nr. 11348 prot., datë **06.06.2019**, KR i propozon DAP-it transferimin e 150 nëpunësve, pas ndryshimeve të ardhura si pasojë e ristrukturimit. Përveç transferimeve të nëpunësve vetëm prej ndryshimeve në emërtesa dhe riorganizime të drejtorive dhe sektorëve, vihen re disa lëvizje që kanë rezultuar në ndryshim të pozicioneve, drejtorive/ sektorëve ose nivelit të pagës për disa nëpunës.

Me shkresën nr. 11348/1 prot., datë **08.07.2019**, KR ka sjellë shkresën me lëndë ñKorrigjim i gabimeve materiale në propozimin e KR nr. 11348 prot., datë 06.06.2019ò, ku vendos korrigjimin e gabimit material, duke cituar ñ*për shkak të pasaktësisë së konstatuar në propozim*ò. Bashkëlidhur nuk ka asnjë praktikë shoqëruese, ku KR është bazuar për të marrë Vendimin e sipërcituar.
Me Urdhrin nr. 62, datë **30.08.2019**, Drejtori i DAP urdhëron ndryshimin e Komisionit të Ristrukturimit, pas ndryshimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.
Që nga ky moment, janë dërguar dy shkresa nga Komisioni i Ristrukturimit, ku kërkohet anulimi ose ndryshimi i akteve të dala më parë.
Në njërën nga këto shkresa, Komisioni i Ristrukturimit i referohet vetes si ñ*Komisioni i Ri i Ristrukturimit, i ngritur me Urdhrin nr. 62, datë 30.08.2019*ò. Urdhri në fjalë, ishte ndryshim i Urdhrit nr. 32, datë 10.05.2019 dhe ndryshoi vetëm njërin prej anëtarëve, Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve. Sipas Udhëzimit nr.1, të Departamentit të Administratës Publike, datë 01.03.2016 ñPër krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimitò, Komisioni i Ristrukturimit krijohet me hyrjen në fuqi, të Aktit që ka miratuar mbylljen apo ristrukturimin e institucionit, në këtë rast Urdhri nr. 86, datë 03.05.2019 i Kryeministrit.

- Në Ristrukturimin e Tretë: Me Urdhrin nr. 24, datë 24.02.2020, nr. 1133/1 prot., datë 24.02.2020, i ndryshuar, Drejtori i DAP ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit.
Me Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020, Komisioni i Ristrukturimit i propozon Departamentit të Administratës Publike transferimin e nëpunësve civilë, ku vihen re edhe transferime të paargumentuara në sektorë/ drejtori, pozicion ose nivel page të ndryshuar. Gjithashtu, vihet re se në DPT janë transferuar nëpunës nga DTM, DRT Tiranë ose DRT Lezhë, në disa raste duke u ngritur dhe në nivel page. Nëpunës të tjerë nga DRT në fjalë janë transferuar në Drejtorinë specifike në Rajonin Qendror ose Verior, pa ndryshuar nivel page. <u>Nuk jepet asnjë shpjegim pse janë përzgjedhur këta nëpunës për këtë transferim. Asnjë nga ndryshimet e sipërcituar nuk është i argumentuar nga Komisioni i Ristrukturimit.</u>
Në vijimësi, pranë DAP janë administruar një numër prej 73 ankesash, në lidhje me aktet e transferimit, të marra në Vendimin nr. 2380/1 prot., datë 15.07.2020.
Me Urdhrin nr. 58, datë 17.08.2020, nr. 1133/5 prot., datë 17.08.2020, Drejtori i DAP, ndryshon anëtarin e KR, pas ndryshimit të Sekretarit të Përgjithshëm të MFE.
Pas kësaj, me Vendimin nr. 10945/4 prot., datë 25.09.2020, **KR vendos t'i propozojë DAPanulimin** e 32 akteve të transferimit, si dhe tâ propozojë **36 akte transferimi të tjera**. Bashkëlidhur propozimit të KR, është një relacion arsyetues për vendimin e marrë.
Nga kjo rezulton që KR nuk e ka kryer përzgjedhjen sipas sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e nëpunësve brenda së njëjtës njësie që do tâ nënshtroheshin transferimit, para se të dilte në Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020. Në fakt, KR ka patur detyrimin që tâ verifikonte këto kritere para se të dilte në Vendimin nr. 10945/1 prot., datë 01.07.2020 dhe Drejtori i DAP duhet tâ verifikonte përpara përcjelljes së Vendimin nr. 2830/1 prot., të datës 15.07.2020.
Gjatë këtij procesi, Komisioni i Ristrukturimit ka dalë me 5 vendime të njëpasnjëshme.
Disa nga vendimet përgjatë këtij procesi ristrukturimi, në veçanti vendimi i parë i datës 01.07.2020, që ka patur edhe numrin më të madh të transferimeve, është bërë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, **pasi (a) janë transferuar nëpunës, pozicionet e të cilëve nuk janë prekur nga ristrukturimi**, **(b) janë kryer transferime pa patur parasysh kriteret e pozicioneve të punës**, si dhe **(c) pa kryer sistemin e pikëzimit.**
<u>Për vendimet e transferimit të marra gjatë procesit të ristrukturimit të vitit 2020, ka 9 procese gjyqësore në zhvillim, të cilat mbartin riskun e krijimit të detyrimeve si pasojë e vendimeve gjyqësore me impakt në buxhetin e shtetit.</u>

Në përfundim rezultoi se, për të tre proceset e ristrukturimit, subjekt i këtij auditimi, grupit të auditimit i janë vënë në dispozicion vetëm vendimet për secilin nëpunës, të cilëve nuk i është bashkëlidhur praktika mbi bazën e së cilës është marrë edhe vendimi, në kundërshtim me **pikën 17**, te udhëzimit ku parashikohet se: ñ*Komisioni i Ristrukturimit duhet ta shoqërojë vendimin e*

*propozimit për transferimin e nëpunësit/ve në një nga pozicionet e lira dhe vendimin për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi*ò, me konkretisht:.

- Nga auditimi rezultoi se, në transferimet e propozuara dhe të miratuara janë konstatuar transferime të nëpunësve nëpër sektorë e drejtori të tjera, edhe në rastet kur pozicioni i tyre i mëparshëm ka vijuar normalisht, në kundërshtim me nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin civilò.
- Komisioni nuk ka paraqitur një relacion, ku të evidentohen vakancat ekzistuese në institucionin DPT, apo nuk ka gjurmë të ketë kërkuar nga DAP informacion mbi vakanca të mundshme, me qëllimin kryesor sistemimin e çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, në kundërshtim me pikën 4, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar
- Në Vendimin (propozimin) e KR për **transferimin e nëpunësve** ose Vendimet individuale **për përfundimin e marrëdhënieve të punës** në shërbimin civil, Komisioni përdor si argument faktin se: ñ*Në strukturën dhe organikën e re të Administratës Tatimore Qendrore nuk parashikohet asnjë pozicion i dedikuar për teknologjinë e informacionit*.ò; Në fakt, rezultoi se në vendim **nuk** përmenden përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuara ose kriteret specifike, në kundërshtim me piken 6, të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar dhe KR niset vetëm nga emërtimi i drejtorisë/ sektorit, për të konkluduar se, pas ristrukturimit, nuk parashikohet asnjë pozicion i dedikuar për teknologjinë e informacionit, edhe pse mes personave të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil me këtë arsyetim, ka pasur ekonomistë e inxhinierë, me role specifike brenda Drejtorisë së Analizës dhe IT apo Sektorit të Analizës dhe IT (në varësi të rajonit), që pas ristrukturimit u riemëruan Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, dhe që kishte në përbërje të saj jo vetëm nëpunës të specializuar në teknologjinë e informacionit.
  Grupit të auditimit nuki është vënë në dispozicion:
  - asnjë dokumentacion vërtetues për verifikimin e përshkrimeve të punës, si kritere të veçanta të evidentuara dhe lista me grupe të veçanta me grupet e pozicioneve bazuar në këto kritere, sikundër dikton pika 8, hapi 1 (përveç dy rasteve gjatë Ristrukturimit të tretë);
  - asnjë dokumentacion vërtetues që vendimet e marra janë bazuar në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit, sipas parashikimit të Udhëzimit (përveç dy rasteve gjatë Ristrukturimit të Tretë);
  - asnjë dokumentacion vërtetues për kryerjen e krahasimit dhe vlerësimit të informacionit të mësipërm, mbi të cilat KR është mbështetur për marrjen e vendimeve mbi transferimin ose përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve. (*trajtuar më hollësisht në faqet 38-65 të Raportit*)

5.1. Rekomandimi : DAP, me anë të përfaqësuesit të tij në Komisionin e Ristrukturimit, në çdo rast duhet të garantojë kryerjen e të gjitha hallkave të kontrollit përgjatë procesit të ristrukturimit, sipas parashikimeve në Ligjin 152/2013 dhe në Udhëzimin nr. 01.03.2016, si dhe të dokumentojë çdo hallkë të procesit, për të qenë transparent në vendimmarrje:
- duke mos kryer transferime në njësi që nuk preken nga proceset e ristrukturimit;
- duke hartuar një relacion paraprak të njësive që preken nga ristrukturimi, përshkrimet e punës, përcaktimin e vakancave që ka institucioni dhe atyre që pritet të krijohen;
- duke përdorur Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemin e Pikëzimit sa herë të ketë lëvizje brenda një sektori ose një drejtorie;
- duke dokumentuar çdo Vendim, me praktikën mbi bazën e të cilit është marrë ai.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, sa i përket afateve të procesit të ristrukturimit, sipas parashikimit në Udhëzimin nr. 1, datë 01.03.2016, ky proces ka përfunduar në datën 30.10.2019, pra më shumë se 5 muaj pas hyrjes në fuqi të aktit. Gjatë kësaj periudhe, Komisioni i Ristrukturimit, ka dalë në mënyrë të vazhdueshme me 4 vendime drejtuar DAP, duke kundërshtuar veten në disa raste, trajtuar më hollësisht në raport.
Nga auditimi është konstatuar se, në disa raste, në momentin që një prej anëtarëve të tjerë të Komisionit ndryshohej gjatë procesit, Vendimet e marra deri në atë moment nga Komisioni

ktheheshin për rivlerësim, e shpeshherë anuloheshin e ndryshonin, duke mos dhënë garanci për vendimet e marra nga ai Komision.
Në përfundim konkludojmë se, Komisioni i Ristrukturimit në përgjithësi, dhe DAP që udhëheq këtë komision në veçanti, nuk kanë kryer siç duhet rolin e tyre në procesin e ristrukturimit, duke mos argumentuar vendimet e marra, shpeshherë duke i anuluar ato, në mungesë transparence e llogaridhënie, të pabazuara dhe pa dokumentuara dhe në disa raste edhe në shkelje të afateve të parashikuara. (*trajtuar më hollësisht në faqet 38-65 të Raportit*)

6.1. Rekomandimi: DAP, si institucioni që kryeson Komisionin e Ristrukturimit (Kryetari i Komisionit është përfaqësues i DAP) duhet të luajë një rol më aktiv në mbarëvajtjen e proceseve të ristrukturimit, dhe jo thjesht rol formal duke konfirmuar çdo propozim apo ndryshim të anëtarëve të tjerë. DAP duhet të garantojë zbatimin rigoroz të Ligjit 152/2013 ñPër shërbimin civilò dhe Udhëzimit 1.3.2016, në çdo proces ristrukturimi.
Duke marrë parasysh rëndësinë e institucionit që po i nënshtrohet procesit të ristrukturimit, si dhe statusin e anëtarëve të tjerë të Komisionit të Ristrukturimit, DAP duhet të konsiderojë të përfaqësohet nga nivel më i lartë drejtues për të garantuar fuqizimin e rolit të DAP në Komisionin e Ristrukturimit dhe në proceset e ristrukturimit në përgjithësi.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi rezultoi se, nga **9** procese gjyqësore të nisura si pasojë e ristrukturimit të tretë:
- 3 procese janë ndërprerë dhe punonjësit janë rikthyer në pozicionin e mëparshëm me vendim te Komisionit të Ristrukturimit, çfarë tregon edhe njëherë vendimmarrjen e gabuar te këtij Komisioni;
- 2 procese janë finalizuar me vendim te përkohshëm ku edhe këtu 2 punonjësit paditës janë rikthyer në punë;
- 2 procese kanë përfunduar në shkallë të parë, në favor të nëpunësve-paditës, dhe vetëm 2 padi rezultojnë të jenë rrëzuar (edhe këto janë në proces apelimi).

Sa më sipër tregojnë për vendimmarrje të paargumentuara ligjërisht, të cilat e vendosin institucionin përpara riskut të krijimit të detyrimeve për ekzekutime të vendimeve gjyqësore
Gjithashtu rezultoi se, referuar databazës së vendimeve gjyqësore të administruara nga DAP, si pasojë e ristrukturimeve në administratën tatimore, kanë nisur 11 procese gjyqësore, për punonjës me status të nëpunësit civil, nga të cilat **2** nga ristrukturimi i parë dhe **9** nga ristrukturimi i tretë. Nëse i referohemi te dhënave nga DPT, në fakt kanë nisur gjithsej 10 procese (nga të cilat dy janë për gjykim në shkallë të parë dhe 8 në shkallë të dytë), dhe jo 11, sikundër konfirmon DAP.
Duke krahasuar të dhënat e marra nga DAP me ato nga DPT[30] mbi vendimet gjyqësore, vërejmë se ka disa mospërputhje, konkretisht në databazën e DAP nuk figurojnë 2 punonjës: E. M. (për gjykim ne shkallë të parë) dhe A. I. (pushim i çështjes në shkallë të dytë); ndërsa në databazën e DPT nuk figurojnë 3 punonjës: M. A. (Pushuar gjykimi në Shkallë të Parë), A. H. (Rrëzuar padia në Shkallë të Parë) dhe A. D. (Rrëzuar padia në Shkallë të Parë).
Në vijim të sa më sipër, nga verifikimi i te dhënave te DAP konstatojmë se, në databazën e vendimeve gjyqësore nuk ka informacion **<u>mbi gjendjen juridike te pozicionit te punës</u>**, pas largimit të nëpunësve në fjalë, sipas kërkesave te urdhrit 5151/2015, ku në bazën e të dhënave gjyqësore të plotësuara nga njësia debitorë (DPT) duhet të shprehet gjendja juridike e pozicionit të punës pas largimit të punonjësit (***dhe jo pozicioni ku ka qene punonjësi para dhe pas ristrukturimit)*** sipas statusit: ñ*pozicioni nuk ekzistonò*, ñ*i bashkuar me pozicione të ngjashmeò*, ñ*ndryshim kriteresh*ò si dhe ñ*shkaku ligjor për të cilin është zënë vendi i punës*ò. Këto të dhëna duhet të përditësohen dhe në këtë formë duhet tëã vihen në dispozicion DAP-it brenda dy ditëve pune, nga momenti i përditësimit. <u>DAP më pas monitoron plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësore.</u>
Nga auditimi nuk rezultoi se DAP, në rolin e mbikëqyrësit të zbatimit të vendimeve gjyqësore, në mënyrë periodike, të ketë kërkuar nga DPT përditësimin e të dhënave të gjyqfituesve në

[30] Nga grupi I auditimit qe auditoi ne DPT, mbështetur mbi programin e auditimit nr. 298/1prot, date 02.03.2021

platformën e bashkëpunimit sipas të gjithë kritereve që kërkon Urdhri 5151, date 28.10.2015. (*trajtuar më hollësisht në faqet 71-83 të Raportit*)

7.1. Rekomandimi: DAP të marrë masa për ngritjene të gjithë mekanizmavetë nevojshëm, në mënyrë që të përmbushë detyrimin <u>për të monitoruar</u> plotësimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave gjyqësore, duke kërkuar nga Njësia debitorë përfshirjen e informacionit**<u>mbi gjendjen juridike të pozicionit të punës</u>**, pas largimit të punonjësit sipas statusit: ñ*pozicioni nuk ekzistonò*, ñ*i bashkuar me pozicione të ngjashmeò*, ñ*ndryshim kriteresh*ò si dhe ñ*shkaku ligjor për të cilin është zënë vendi i punës*ò dhe të tjera informacione që dikton kuadri rregullator në fuqi. Kjo me qëllim analizimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të çdo rasti, në mënyrë që të shmanget krijimi i detyrimeve të prapambetura me efekte negative ne buxhet, si pasojë e vendimmarrjeve të gabuara për largime të padrejta të punonjësve nga puna.

Në vijimësi

7.2. Rekomandimi: DAP tëi kërkojë DPT-së që të njoftohet për çdo rast, që nga momenti i depozitimit të kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit/përfaqësuesit ligjor/përmbaruesit, për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Gjithashtu DPT të marrë masa për përditësimin e të dhënave për vendimet gjyqësore dhe <u>brenda dy ditëve pune nga çdo përditësim, të bëjë me dije DAP.</u>

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se veprimtaria administrative e Komisionit të Posaçëm, nuk është ndjekur dhe vëzhguar nga DAP për raste që i takojnë periudhës 2019-2020, në kundërshtim me kërkesat e Urdhrit 5151/2015 **"***Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e Administratës Shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të Ligjit për Shërbimin Civilò***,** pasi ngadata 27.08.2019 e në vazhdim, DAP nuk është njoftuar nga DPT për mbledhjet e Komisionit të Posaçëm, edhe pse rezultoi se këto komisione kanë vepruar duke lënë edhe akt-rekomandimet përkatëse. Pas administrimit të kërkesave për pjesëmarrje në Komisionet e Posaçme në zbatim, Kreu IV të Urdhrit nr.5151 datës 28.10.2015, DAP përzgjedh nga radhët nëpunësve të saj vëzhguesit apo mbikëqyrësit e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm.

